Rruga Arbërit

GAZETË E PAVARUR. NR. 8 (40). GUSHT 2009. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO

Big Market

Laprakë, Tiranë

Tel: +355 4 22 50 480

Cel. 068 20 36 394

INVESTIME

Bulqizë, nisin punimet në Rrugën e Arbërit

Kompania turke TAT Group- Devel. Center i kërkon kryeministrit të ndërtojë Rrugën me koncension

FAQE 2

KULTURË

"Sikur të vdekurit të dëgjonin"

AKADEMIKU GËZIM ISMAILI ALPION PREZANTON NË TIRANË DRAMËN

FAQE 13

REPORTAZH

Një udhëtim buzë Korabit

Nga: **SHPËTIM CAMI** - FAQE 5

Zbulime të reja në Kalanë e Grazhdanit



Me një fond prej 30.000 dollarësh dhënë nga Ambasada e SH.B.A në Tiranë u mundësua rifillimi i gërmimeve arkeologjike në kalanë e Grazhdanit. Projekti synon kthimin e kalasë së Grazhdanit në një qendër të vizitueshme të turizmit arkeologjik, duke kryer hap pas hapi punimet e pastrimit dhe gërmimet arkeologjike në elementet më të rëndësishëm të arkitekturës së këtij qyteti, siç janë tri hyrjet, kullat, stadiumi etj., konservimin e mureve dhe të tri hyrjeve të tij, vendosjen e tabelave orientuese e shpjeguese në shqip dhe anglisht në vendet më të dukshme etj.

SPECIALE NË FAQET 3,8,9

ÇËSHTJE E DITËS

Masakër në pyjet e Steblevës

Nga: **MERSIN HOXHA***

Me anë të kësaj letre, ne, një grup i Shoqatës "Stebleva", i përbërë prej 13 vetësh, ju vemë në dijeni se në vendin e quajtur "Përroi i Govatave", midis piramidave kufitare 28 dhe 29 të kufirit me Maqedoninë, në parcelën 52/a, pyll në pronësi të banorëve të Steblevës, vend kufitar me komunën e Klenjës (Trebishtit) të rrethit të Bulqizës, po ndodhin prerje masive të këtij pylli, pjesë e parkut Kombëtar "Shebenik-Jabllanicë".

Kjo masakër pyjore na ka shqetësuar edhe më parë, por tani ajo po bëhet shumë shqetësuese pasi janë dëmtuar në masë 100 copë fidanë ahu me trashësi 18-20 cm në një sipërfaqe prej 39 hektarësh. Dëmtuesit dhe keqbërësit që mbështeten në mënyrë të heshtur edhe nga drejtues të Ndërmarrjes pyjore të Bulqizës, kanë depërtuar edhe në territorin e Republikës së Maqedonisë, gjë që mund të shkaktojë edhe precedent ndërkombëtar.

Pas shumë raportimeve të banorëve, shqetësimeve të vazhdueshme, me datë 24 gusht 2009 kapëm në flagrancë një kamion të tipit "IFA" me targë PG 0390 B me shofer A.S. nga Dibra. As shoferi dhe as shoqëruesit të ardhur nga Bulqiza nuk kishin asnjë dokument. Policia kufitare e Steblevës (Librazhdit) e njoftuar nëpërmjet numrit 129 erdhi menjëherë në ngjarje dhe bëri procedimet e nevojshme.

(Vijon në faqen 4)

PIKËPAMJE E RE e Prof. asoc. dr. Adem Bunguri

Ja nga vjen emri "Dibër"

Lidhur me këtë problem mendojmë se jemi afër të vërtetës, në se i referohemi emrit të qytetit ***Dioboros*** të guidës së Hieroklit[23]. Ky qytet i provincës së parë maqedonase, i lokalizuar në ***Doirani*** të Maqedonisë egjeane, mendojmë se mund të identifikohet në rrënojat e kalasë së Grazhdanit. Nga emri ***Dioboros*** i këtij qyteti, rrjedh lirisht në pikëpamje fonetike trajta e sotme e emrit ***Dibër.*** Në bazë të rregullave të zhvillimit fonetik të gjuhës shqipe rezulton i pranueshëm shëndrimi i diftongut **"io" - "i"**, i zanores **"o" - "ë"** si dhe rënja e mbaresës greke **"os"** për të pranuar barazimin fonetik ***Dioboros = Dibër*** . Për këtë supozim përveç ngjashmërisë fonetike mbështetemi edhe në supozimin e njohur se në periudhën romake *"Grazhdani duhet të ketë qenë qendra e të dy Dibrave"* [24].

INTERVISTË

Studentja që u dashurua me pedagogun e saj

Me pedagogen e psikologjisë **EDLIRA HAXHIYMERI** - FAQE 7

AKTUALITET

Fida: Shumë investime përkundër krizës financiare

Kryetari i Komunës së Dibrës së Madhe analizon investimet - FAQE 4

PORTRET

Inxhinieri pa diplomë Zabit Muda...

Nga: **ABDURAHIM ASHIKU** - FAQE 10

Kompania turke TAT Group-Devel.Center i kërkon kryeministrit të ndërtojë Rrugën e Arbërit me koncension

Rruga Arbërit nr. 40
e ditës



Gjurma e rrugës së Arbërit në Planin e Bardhë. Foto: Bujar Karoshi

Nisin punimet në segmentin e dytë të Rrugës së Arbërit

Kryeministri Berisha mori pjesë sot në inaugurimin e fillimit të punimeve për ndërtimin e Lotit 1 dhe 2 të rrugës së Arbrit, që përfshin segmentin dalje Ura e Vashës- Bulqizë.

Loti 1 i segmentit dalje Ura e Vashës - Bulqizë, realizohet me investim të buxhetit të shtetit, me vlerë 838 621 133.9 lekë. Ky lot ka një gjatësi 3.9 km dhe gjerësia e rrugës, duke përfshirë edhe pjesën e bankinës, është 11 m.

Edhe Loti 2 i segmentit dalje Ura e Vashës - Bulqizë, i rrugës së Arbrit realizohet me investim të buxhetit të shtetit, me vlerë 748 248 264 lekë. Ky lot ka gjatësi rreth 3.8 km dhe gjerësia e rrugës në total është 11 metra. Rruga kalon në anën e djathtë të përroit Zalli i Planit të Bardhë dhe të fshatit në këtë zonë.

Projekti i ndërtimit të këtyre dy loteve përfshin ndërtimin e një rruge me të gjitha parametrat bashkëkohor të një rruge funksionale europiane.

Kryeministri e vlerësoi këtë rrugë shumë të rëndësishme për zhvillimin e vendit, duke e konsideruar atë si rruga e kombit shqiptar, rruga e bashkimit të shqiptarëve me kombe të tjera të rajonit. Kjo rrugë, theksoi Kryeministri, afron Peshkopinë, Bulqizën me Tiranën me një kohë 2 herë më të shkurtër se sa koha që u duhet sot, si dhe afron Shkupin me Tiranën, me rreth 100 kilometra.

Kryeministri shprehu mirënjohjen për qindra e mijëra qytetarë të Maqedonisë, me origjinë shqiptare apo maqedonase, që kanë zgjedhur këtë verë Shqipërinë, si vendin për pushimet e tyre. "Dua t'i garantoj ata se, verën tjetër, do të gjejnë kushte edhe më të mira këtu dhe se, në krye të dy viteve, ata do të vijnë në Tiranë dhe do të zbresin drejt brigjeve të Shqipërisë, në rrugën më të re të Ballkanit, në rrugën e Arbrit, në kohën më të shkurtër", vijoi Kryeministri.

Më tej, Kryeministri theksoi vendosmërinë e qeverisë që në katër vitet në vijim të realizojë ndryshimin e madh të Shqipërisë. "Ne besojmë se vetëm një Shqipëri me infrastrukturë moderne, një Shqipëri e cila lufton për një klimë biznesi, një Shqipëri që instalon revolucionin industrial dhe e zhvillon atë me shpejtësi, do të mund të punësojë shqiptarët. Në këto katër vite, ne jemi të vendosur të punësojmë mbi 160 mijë qytetarë shqiptarë", u shpreh Kryeministri. "Rruga e Arbrit është rruga e Shqipërisë evropiane, korridori i kombit është korridori i Shqipërisë evropiane. Ju garantoj se në 2 vjet kjo rrugë do të kapë Tiranën dhe ju do të zbrisni në Tiranë në një kohë prej 40 deri në 60 minuta", tha Kryeministri Berisha.

Më pas, kryeministri mori pjesë në inagurimin e punimeve të lotit të parë të rrugës Maqellarë - Peshkopi.

Kryeministri Berisha mori pjesë në inaugurimin e fillimit të punimeve për sistemim asfaltimin e rrugës Ura e Cerenecit – Peshkopi (Maqellarë – Peshkopi) loti 2. Kjo rrugë fillon në Maqellarë dhe lidhet me rrugën e Arbrit, përmes segmentit Ura e Cerenecit – Bllatë.

"Duke përshëndetur çdo dibrane dhe dibranë, kudo që ndodhen sot, unë shpreh kënaqësinë time, se sot inaugurojmë fillimin e punimeve të rrugës së Arbrit drejt Peshkopisë, pra segmentin e saj drejt Peshkopisë, një premtim elektoral ky i qeverisë sime. Unë po vij nga Bulqiza. Aty inauguruam një segment tjetër të kësaj rruge, që është gjithashtu një rrugë e një rëndësie shumë të madhe për Peshkopinë, Bulqizën, Matin, por edhe për mbarë kombin shqiptar. Rruga e Arbrit është shndërrimi në realitet i një ëndrre të banorëve të këtyre zonave, të të gjithë shqiptarëve të trevave të tjera, të lidhura shpirtërisht dhe pazgjidhshmërisht me Dibrën, me Tiranën dhe mbarë Shqipërinë", tha ai..

Më pas kryeministri shtoi: "Rruga e Arbrit shumëfishon marrëdhëniet tregtare dhe marrëdhëniet e gjithanshme me Maqedoninë mike, bën që gjithë portet e Shqipërisë të bëhen gjithnjë e më të përzgjedhur e më të përshtatshme, për Maqedoninë dhe për Bullgarinë perëndimore. Rruga e Arbrit do të jetë rruga e fluksit të madh turistik".

"Një rrugë tjetër është në ndërtim e sipër dhe kjo është rruga që lidh Peshkopinë me Kukësin. Në të vërtetë, kjo rrugë lidh Peshkopinë me tregun e Kosovës, lidh Peshkopinë me Prizrenin, me Prishtinën, pra hap një perspektivë të madhe zhvillimi për qarkun e Peshkopisë. Me përfundimin e kësaj rruge dhe në rrugës së Arbrit, Peshkopia do të ketë lidhjet më moderne më Tiranën, Prishtinën, Shkupin".

"Kushdo që vjen në Dibër, kushdo që lexon për dibranet e dibranët, frymëzohet nga shpirti i tyre punëtor. Ju nuk lini pëllëmbë tokë pa punuar, pa e qëndisur me mundin dhe djersën tuaj. Të paktë janë ata që bëjnë përpjekjet tuaja për një jetë më të mirë, ashtu siç i bëni ju. Unë ju garantoj se në katër vitet që vijnë, qeveria ime do të mbështesë më shumë se kurrë këto përpjekje, ne do të ndërtojmë dhe rindërtojmë të gjithë sistemin vaditës të tokave tuaja, do të ndërtojmë dhe rindërtojmë të gjithë sistemin e ujësjellës - kanalizimeve në zonat tuaja, do të financojmë çdo dru frutorë të mbjellë nga ju, do të subvencionojmë çdo përpjekje për përpunimin e prodhimeve të mrekullueshme tuaja. Do të ngremë të gjithë infrastrukturën e duhur në mënyrë që ju të kapni me këto prodhime, tregun e Tiranës, Prishtinës dhe Shkupit.

Unë kam bindjen se Peshkopia e katër viteve që vijnë do të jetë një Peshkopi krejtësisht tjetër. Së bashku, në çdo fshat të këtij rrethi, do të luftojmë varfërinë. Fermerët e Peshkopisë duhet ta dinë se ata kurrë nuk do të ndihen të braktisur, sepse ne kudo do të ndërtojmë infrastrukturën moderne. Ne respektojmë plotësisht zgjedhjen e tyre për lëvizje të lirë, apo përpjekjet e tyre për të ndërtuar jetën aty ku ata e gjykojnë më të mirë për ta. Sikundër, nuk do të ketë të braktisur, nuk do të ketë të lënë mënjanë apo të harruar. Kudo që ata të ndodhen, në Zall- Reç, në Lurë e në çdo territor tjetër të këtij vendi.

Së shpejti do të nisë ndërtimi i rrugës që bashkon Peshkopinë me Librazhdin. Në këtë mënyrë, ne urbanizojmë këtë rreth të mrekullueshëm, në këtë mënyrë ne bëjmë që ju të kapni tregun dhe të rrisni prodhimet tuaja"..

Përvec investimeve me buxhetin e shtetit, nje pjesë e rrugës së Arbërit mund të jepet me koncension. Kryeministri Berisha priti në fillim të muajit gusht presidentin e kompanisë turke TAT Group-Devel.Center, Dr Mehmet Tatlici. Në këtë takim, kompania turke prezantoi projekt propozimet për investime në fushën e energjisë së rinovueshme, në transportin rrugor dhe në turizëm. Investitorët turq parashikojnë që për projektet e energjisë së rinovueshme të investojnë në rajonin Tepelenë- Sarandë. Ndërkohë që kërkojnë të marrin me koncension ndërtimin e Rrugës së Arbërit si dhe ndërtimin e rrugës Tiranë-Elbasan.

Korresp. "Rruga e Arbërit"

Peshkopi, hapet filiali i Universitetit të Durrësit

Këshilli i Ministrave miratoi këtë muaj vendimin për hapjen në qytetin e Peshkopisë të filialeve dhe programeve të studimeve të Fakulteteve të Ekonomisë, të Administrimit, të Edukimit dhe të shkollës së lartë profesionale të Universitetit "Aleksander Moisiu" në Durrës.

Sipas vendimit të qeverisë, Filiali i Fakultetit të Ekonomisë dhe të Administrimit do të ofrojë programet e studimit të ciklit të parë, në "Shkenca të Administrimit", me profil "Financë-Kontabilitet"; "Shkenca të Administrimit", me profil "Financë-Bankë"; "Shkenca të Administrimit", me profil "Menaxhim marketing"; "Shkenca të Administrimit", me profil "Administrim biznesi".

Filiali i Fakultetit të Edukimit do të ofrojë programet e studimit, të ciklit të parë, në "Matematikë-Fizikë"; "Matematikë-Informatikë"; "Informatikë-Anglisht"; "Gjuhë-Letërsi-Anglisht"; "Biologji-Kimi"; "Psikologji-Sociologji"; "Procese formimi".

Filiali i Shkollës së Lartë Profesionale do të ofrojë programet e studimit,

> Universiteti do të ofrojë studime në degët të ndryshme të Fakultetit të Ekonomisë dhe të Administrimit, Fakultetit të Edukimit dhe Shkollës së Lartë Profesionale.

në "Infermieri të Përgjithshme"; "Drejtësi", me profil "Asistencë ligjore"; "Informatikë", me profil "Rrjete kompjuterike".

Në përfundim të secilës degë do të lëshohet "Diplomë e nivelit të parë (DNP)"

Programet e studimit të ciklit të parë, në filialet e Fakultetit të Ekonomisë e të Administrimit dhe të Edukimit, në qytetin e Peshkopisë, realizohen me 180 kredite ECTS dhe kohëzgjatja normale e tyre është tri vite akademike.

Programet e studimit të ciklit të parë, në filialin e Shkollës së Lartë Profesionale, realizohen me 120 kredite ECTS dhe kohëzgjatja normale e tyre është dy vite akademike.

Këto programe studimi, sipas vendimit të Këshillit të ministrave, do ta fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.

Vendimi i këshillit të ministrave ka përcaktuar edhe kuotat e pranimit për secilën degë dhe tarifat vjetore të shkollimit.

Kryeministri u shpreh se ky vendim përbën një zhvillim jashtëzakonisht të rëndësishem për jetën universitare të vendit, në mënyrë të veçantë për të rinjtë e zonave përreth. "Ky universitet është një ndihmë e madhe për këtë zonë. Të rinjtë e gjimnazeve të Peshkopisë, Bulqizës, Matit, por edhe të gjithë Shqipërisë, do të kenë mundësinë të ndjekin studimet e larta në degë të Universitetit të Durrësit në Peshkopi".

Nga ana tjetër, Kryeministri tha se do të ishte me vlerë hapja e degëve të Universitetit Bujqësor në këtë zonë, apo edhe të një shkolle të mesme bujqësore, në mënyrë që të rritet gjithnjë e më shumë kualifikimi i fermerëve shqiptarë.

Një vendim i tille arsimor duket se nuk ka mundur që t'i qëndrojë larg politizimit të çeshtjes. Kjo për faktin se çelja e këtyre degëve të studimit në qytetin e Peshkopisë është lidhur jo vetëm me zhvillimin e saj, por edhe më gjerë, me atë rajonal.

Kryeministri u shpreh se investimet e bëra në qytetin e Peshkopisë e kanë shndërruar atë nga një rajon i mbyllur, në një nga rajonet më të hapura të vendit. "Peshkopia, me ndërtimin e rrugës së Arbërit dhe rrugës qe lidh Peshkopinë me Kukësin, krijon hapësira shumë të mëdha për tregun.

Tirana arrihet në një periudhe kohore rreth 1 orë. Prishtina arrihet edhe ajo në një kohë të shkurtër, po kështu edhe Shkupi. Pra, nga një rajon i mbyllur, shndërrohet në një nga rajonet më të hapura të vendit", theksoi kreu i ekzekutivit gjatë prezantimit të këtij vendimi të miratuar nga qeveria që drejton.

Korresp. "Rruga e Arbërit"

Posta e Rruga Arbërit


Gazetë e pavarur.
Nr. 8 (40). 1- 31 Gusht 2009

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Redaksia u kujton bashkëpunëtorëve të saj, zotërinjve Isa Halilaj, Mahmud Hysa, Xhafer Martini, Qeram Cibaku, Rexhep Ndreu, Haki Kola, Xhelal Roçi, Beqir Sina, Odise Plaku, Kujtim Boriçi, etj, se shkrimet e tyre, për arsye vendi nuk janë botuar në këtë numër.
Ato do të botohen në numrat e ardhshëm të gazetës "Rruga e Arbërit".

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.
Shkrimet priten në redaksi deri më **datë 20** të muajit.
Gjithashtu, ju kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.
Gazeta publikohet falas në internet me datë 7 të muajit pasardhës

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!



DREJTOR:
Rakip Suli

Këshilli Botues:
Musa Riçku
Shaqir Skarra
Bujar Karoshi

Bashkëpunuan në këtë numër:
Adem BUNGURI
Rexhep TORTE,
Mersin HOXHA
Abdurahim ASHIKU
Shpëtim CAMI
Rexhep NDREU
Fejzulla GJABRI
Selman MEZIU
Hysen UKA
Viron KONA
G.BARA
etj.

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë



1.Pamje e përgjithshme e kalasë së Grazhdanit me linjën

Zbulime të reja në Kalanë e Grazhdanit

Nga:
Prof. asoc. dr. ADEM BUNGURI

Falë një granti prej 30.000 $ dhënë nga ambasada e SH.B.A në Tiranë, si dhe e një fondi shumë më të vogël të Institutit Arkeologjik, u mundësua rifillimi i gërmimeve arkeologjike në kalanë e Grazhdanit. Ato u kryen gjatë periudhës 16 qershor-31 korrik 2009, në kuadrin e një projekti afatgjatë për rivolarizimin e këtij monumenti. Projekti synon kthimin e kalasë në Grazhdanit në një qendër të vizitueshme të turizmit arkeologjik, duke kryer hap pas hapi punimet e pastrimit dhe gërmimet arkeologjike në elementët më të rëndësishëm të arkitekturës së këtij qyteti, siç janë tri hyrjet, kullat, stadiumi etj, konservimin e mureve dhe të tri hyrjeve të tij, vendosjen e tabelave orientuese e shpjeguese në shqip dhe anglisht në vendet më të dukshme etj.

Në perspektivë ai synon përmirësimin cilësor të statusit juridik të kalasë së Grazhdanit, status që përveç mbrojtjes së fuqishme ligjore, përfshin edhe krijimin e një sektori të veçantë të drejtorisë rajonale të Institutit të Monumenteve të Kulturës së Dibrës, që do të kujdeset për mirëmbajtjen gjithëvjetore të saj, si dhe përzgjedhjen e një ciceroni, që do të merret me shpjegimet e nevojshme, prerjet e biletave hyrëse, administrimin e vizitave dhe të ardhurave etj. Ndërmarja e një projekti të tillë, ishte një domosdoshmëri, pasi në kontekstin e prioriteteve të zhvillimeve të sotme të turizmit arkeologjik, Shqipëria lindore, ku gjendet ky monument, ishte një njollë krejtësisht e bardhë. Në fakt, duhet thënë se një projekt i ngjashëm studimor, kishte nisur që në vitet 2000-2004, me synim pastrimin e mureve rrethuese dhe korrigjimin e planimetrisë ekzistuese të kalasë së Grazhdanit, i cili qe ndërprerë për arsye financiare. Por u desh vënia e kalasë së Grazhdanit në prioritetet e punës së Institutit të Monumenteve të Kulturës gjatë vitit 2008, që ky projekt i ri të fillonte, për të zhdukur paradoksin midis rëndësisë së madhe të kalasë së Grazhdanit dhe mungesës së mjaftueshme të vëmendjes ndaj saj. Projekti drejtohet nga prof. asoc. dr. Luan Përzhita dhe prof. asoc. dr. Adem Bunguri, me pjesëmarrjen edhe të topografit Pëllumb Naipi. Që në fillim duam të falënderojmë të gjithë komunitetin e Grazhdanit për kulturën, mirëkuptimin dhe ndihmën e dhënë në realizimin e fazës së parë të këtij projekti, dhe në veçanti punëtorët fizikë e studentët që punuan për kryerjen e tij. Gjithashtu falënderojmë drejtorin e drejtorisë rajonale të monumenteve Peshkopi, z. Ardian Suka, kryetarin e komunës së Maqellarës z. Bardhyl Agolli, kryeplakun e fshatit Grazhdan, z. Asllan Isaku për përkrahjen e këtij projekti. Falenderojmë me këtë rast edhe pronarët e parcelave bujqësore ku kemi kryer gërmime, përkatësisht z. Telat Osmani (hyrja lindore dhe të kisha), z. Destan Aga, z. Haxhi Llaka, dhe z. Rami Osmani (stadiumi). Një falënderim i veçantë shkon për bijtë të këtij fshati, juristin e njohur z. Kujtim Osmani dhe biznesmenin po ashtu shumë të njohur z. Zaim Korsi, për interesimin e tyre të veçantë për mbarëvajtjen e këtij projekti. Dhe më në fund, shprehim mirënjohjen tonë për ambasadën e SH. B. A në Tiranë, për drejtorinë e Institutit të Monumenteve të Kulturës dhe të Institutit Arkeologjik, si dhe për strukturat përkatëse të qeverisë, që e kanë mbështetur dhe do ta mbështesin këtë projekt afatgjatë.

POZICIONI GJEO-TOPOGRAFIK

Kalaja e Grazhdanit ndodhet në veri të pellgut të Dibrës, thuajse në mesin e rrugës që lidh qytetin e Peshkopisë dhe atë të Dibrës, përkatësisht në distancat lineare jugore dhe veriore 11 dhe 10 km. Ajo është vendosur në fushën e fshatit homonim, në perëndim të malit të Deshatit, midis përroit të Kamenicës në veri dhe atij të Bresnicës në jug. Muri lindor i kalasë kalon disa metra në lindje të rrugës nacionale, ndërsa ai perëndimor i afrohet bregut të djathtë të Drinit të Zi deri afër 2 km. Kalaja e Grazhdanit shtrihet në të gjithë këtë hapësirë, midis kuotave 550 – 593m, në një terren fushor në lindje dhe të pjerrët në perëndim. Ajo ka një pozitë të rëndësishme strategjike në kontroll të rrugës së Drinit të Zi, që e lidh atë me dy arteriet më të rëndësishme transballkanike të periudhës romake : via Egnatian në Jug dhe atë Lissus – Naissus në veri. Rëndësia e kësaj pozite rritet edhe nga fakti se ajo ndodhet në pikëtakimin e provincave të Epirit të Ri, Macedonia Secunda, Prevalitanisë dhe Dardanisë.

Kalaja e Grazhdanit është monumenti më i madh sipërfaqësor i rajonit të Dibrës dhe castrumi më i madh në Shqipëri e ndër më të mëdhatë në rajon. Për përmasat e saj ballkanike e mesdhetare dhe pozitën qendrore në luginën e Drinit të Zi, ajo ka tërhequr prej kohësh vëmendjen e studiuesve. Nga sa dimë, kjo kala përmendet për herë të parë nga gjeologu dhe gjeografi francez A. Boué. Sipas tij, Grazhdani zinte një vend qendror në sistemin rrugor ndërkrahinor. Ai shënon gjatësinë në orë këmbësore të *„rrugës së karvaneve „* që lidhte kalanë e Grazhdanit me Styberën, Ohrin, Shkodrën dhe Prizrenin.

J. G. Hahn mund të konsiderohet si studiuesi i parë serioz i kalasë së Grazhdanit. Që në vitin 1863 ai shënonte se territori kur është ndërtuar kjo kala njihet me emrin ***"shehër"*** dhe mendon se aty duhet të ketë patur një ***"qytet të rëndësishëm dhe të lashtë",*** i cili ishte rrënuar përdhunisht dhe nuk ishte rindërtuar përsëri në të njëjtin vend. Ai na njofton gjithashtu se në kohën e tij shiheshin pa vështirësi muret e banesave të brendshme të qytetit[1].

Shënime interesante mbi këtë kala, ka lënë edhe konsulli rus në Shkodër, I. S. Jastrebov. Sipas tij, kalaja e Grazhdanit nuk ka qenë as qytet e as kala, por ***"një koloni e vjetër romake, një municip ose një karavansaraj (stacion rrugor) në rrugën Egnatia për në veri".*** Ai mendon se në periudhën romake ***"Grazhdani duhet të ketë qenë qendra e të dy Dibrave",*** por beson se ***" si çdo qytet romak ishte rrënuar plotësisht nga Atila"*** [2].

Nga intelektualët vendas të para Luftës së Dytë Botërore, përmendim shkrimtarin H. Stërmilli që e viziton këtë kala dhe e konsideron atë si fortifikim mesjetar ***"të periudhës skënderiane plot ngadhnjime"*** [3].

Në vjeshtën e vitit 1950, kalaja e Grazhdanit vizitohet nga prof. H. Ceka e ing. J. Adami dhe datohet si ndërtim i periudhës së vonë antike. Prof. H. Ceka, na njofton mbi zbulimin e një bazamenti kolone (me lartësi 0.60 m), si dhe mbi ekzistencën e gjurmëve të një kishe pranë murit lindor të kalasë[4]. Falë informacionit të tyre, kalaja do të shpallet monument kulture me datë 15.01. 1963, me vendimin nr. 6 të Rektoratit të Universitetit të Tiranës, krahas kalasë së Petralbës (Guri i Bardhë) dhe asaj të Stelushit. (Qafë Murrë).

Në mesin e viteve '70 të shek. XX, A. Baçe bën planimetrinë e parë të kalasë së Grazhdanit, dhe jep të dhënat përkatëse lidhur me madhësinë dhe sistemin fortifikues të saj[5]. Në dhjetor 1982, gjatë punimeve për zgjerimin e rrugës nacionale, në segementin që ajo kalon brenda kalasë së Grazhdanit, u zbulua një varrezë mesjetare dhe një trakt muri kuadratik, ndërsa në shtator 1983 u bë këtu një gërmim i vogël sondazhi. Gërmimet u kryen në periudhën 22-29.10.1983 nën drejtimin e D. Komatës, me pjesëmarrjen e arkeologëve Gj. Saraçi e A. Bunguri dhe skicografit Y. Pupli.

Në vitet 1986 – 1990, në kalanë e Grazhdanit u kryen punime të pastrimit të mureve nga Instituti i Monumenteve të Kulturës. Me këtë rast, u pastruan nga dherat dhe shkurret plotësisht muret e anës lindore e jugore dhe pjesërisht ato të anës perëndimore[6]. Në vitet 2000-2004 në këtë kala janë kryer gërmime në trasenë e murit dhe të dy hyrjeve kryesore të saj, për saktësimin e planimetrisë ekzistuese[7].

Në vitet 70 – 80 të shekullit të kaluar bëhen përpjekje për lokalizimin në këtë kala të qyteteve ilire të Draudakut[8], Uskanës[9], apo qytetit të periudhës romake të Dobërit[10], ndërkohë që studiuesit pranojnë si kohë të ndërtimit të mureve të saj rrethuese periudhën e vonë antike. Mendime për këtë kala kanë shprehur studiuesit H. Sadikaj, S. Anamali, Gj. Karaiskaj, K. Frashëri, I. Kaca etj. Mungesa e gërmimeve kishte krijuar një kontradiktë në mendimin arkeologjik nga mospërputhja në kohë e mureve rrethuese të kalasë dhe qytetit të supozuar apo castrumit të mbrojtur prej tyre, e cila po zgjidhet gradualisht nga gërmimet e reja që po kryhen në këtë kala.

Më poshtë, për interesin e madh të lexueseve tanë, do të paraqesim në mënyrë të përmbledhur informacionin e derisotëm arkeologjik mbi këtë monument të rëndësishëm sipërfaqësor arkeologjik me vlera mesdhetare e ballkanike, i cili u pasurua ndjeshëm nga gërmimet e këtij viti, sipas periudhave kronologjike të përfaqësuara. *(fig. 1-pamje e përgjithshme, fig. 2-planimetria, fig. 3-pamje e gërmimeve të reja).*


1. PERIUDHA QYTETARE ILIRE (SHEK. IV-I PARA KR.)

Periudha qytetare ilire (shek. IV-I p. Kr), është periudha më e hershme e jetës, e cila njihet ende shumë pak, vetëm nga rrethina e kalasë. Objekte të kësaj periudhe janë gjetur në fshatrat Grazhdan dhe Herbel të kësaj rrethine, që përfaqësojnë vendbanime ilire me karakter fshatar të shek. III-II para Kr. Fjala është një pitos masiv të zbuluar në vitin 1989 gjatë punimeve bujqësore në oborrin e shtëpisë së z. Besim Aga dhe të restauruar mjeshtërisht nga skicografi Y. Pupli, si dhe disa enë të tavolinës të zbuluara në Çukë të Herbelit, këto të fundit importe të Apollonisë, të ardhura deri këtu nëpërmjet arteries rrugore të Drinit të Zi. Pitosi me lartësi 1.40m, diametrin e trupit 1.20m dhe atë të grykës 0.75m është ndër më të mëdhenjtë e zbuluar në Shqipëri. Kostoja e tij ka qenë e lartë, çka dëshmohet nga restaurimi i tij antik dhe funksioni i tij si depozitë familjare drithërash *(fig. 4-pitosi).*

2. PERIUDHA E HERSHME PERANDORAKE (SHEK. I-III PAS KR)

Në periudhën e hershme perandorake (shek. I-III pas Kr.) rruga e Drinit të Zi, përfaqësonte degëzimin verior të via Egnatias, të cilën e bashkonte me magistralen tjetër transball-

(Vijon në faqen 8)



2 Planimetria



3 - Pamje e përgjithshme e hyrjes Lindore

Rruga Arbërit nr. 40
mjedis

Federatat Rajonale të Pyjeve dhe Kullotave Komunale
i kërkojnë qeverisë hartimin e një legjislacion
të shpejtë për të ndaluar masakrën mbi pyjet

ÇËSHTJE E DITËS

Masakër në pyjet e Steblevës

(Vijon nga faqja 1)

Nga ana e Drejtorit të Ndërmarrjes Pyjore Bajram Sallaku pretendohet se ky pyll nuk është pronë e Steblevës, por e Bulqizës, por e marrë në ruajtje. Sipas tij nuk është as pjesë e Parkut Kombëtar. Nga ana e Ndërmarrjes Pyjore të Librazhdit pretendohet se është pjesë e Bulqizës dhe duhet të ruhet e trajtohet nga Ndërmarrja Pyjore Bulqizë, e cila ka gjetur më të udhës të bëjë rolin e shurdhit dhe të qorrit para kësaj masakre pyjore.

Banorët e Steblevës Emin Murati, Rifat Agushi, Hasan Kormaku, Bajram Agushi, Shefqet Agushi, Dalip Murati, Xheladin Murati dhe Emrulla Feta kanë tapitë e vitit 1937 si dhe tapitë sipas ligjit 7501 për këtë pyll.

I nderuar Zoti Kryeministër !

Ju lutemi, me autoritetin që ju jep kushtetuta dhe ligjet e Republikës së Shqipërisë të ndërhyni sa më shpejt që të jetë e mundur që të saktësohet ndarja territoriale midis komunës së Trebishtit (Bulqizë) dhe asaj të Steblevës (Fushë-Studnës), Librazhd dhe të ndalet kjo masakër pyjore.

Me respekt
MERSIN HOXHA
Kryetar i Shoqatës "Stebleva"

Në vijim po japim personat, dëshmitarë okularë, që asistuan me datën 24 gusht në vendin e ngjarjes.

1. **Mersin Hoxha , kryetar i Shoqatës "Stebleva"**
2. **Rexhep Kurti, kryeplak i fshatit Steblevë**
3. **Bledar Tupi, inspektor pranë komunës Steblevë,**
4. **Trifon Cfarku, inxhinjer pyjesh**
5. **Ylli Gjini , nëpunës i komunës Steblevë,**
6. **Halil Kurti, banor i Steblevës**
7. **Abib Kormaku, banor i Steblevës**
8. **Sulejman Agushi, banor i Steblevës**
9. **Liradin Kurti, banor i Steblevës**
10. **Ferhat Lila, banor steblevas**
11. **Xheladin Ferhati, banor steblevas**
12. **Andrea Cfarku, banor steblevas**
13. **Abil Ferhati, banor steblevas**

Shënim i redaksisë:

Letra e mësipërme i është drejtuar Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, Shkëlqesisë së Tij Z. Sali Berisha, Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, z. Lufter Xhuveli dhe Ministrit të Brendshëm, z. Bujar Nishani. Titulli origjinal i letrës është "PRERJE MASIVE, NJË MASAKËR E VËRTETË NË PYJET E STEBLEVËS NË VENDIN E QUAJTUR "PËRROI I GOVATAVE".

Vetëm gjatë vitit 2008 u transferuan në pronësi të Komunave 685000 ha Pyje, Kullota dhe sipërfaqe inproduktive dhe në total 60 % e sipërfaqes totale të territorit të Shqipërisë. Duke i shtuar kësaj shifre dhe 340000 ha Pyje kanë qenë të transferuara në përdorim deri në vitin 2007 shifra shkon mbi 1000000 ha të transferuara në Njësitë e Qeverisjes Vendore.

Ne e përshëndesim hapin që mori K/Ministri i Shqipërisë për reformën më të madhe të ndërmarrë deri sot nga shteti shqiptar, sepse kjo reformë jemi të sigurtë që do të ketë shumë shpejt ndikimet e veta.

Të përfshish njerëzit në të drejtën dhe përgjegjësitë e mohuara ndër shekuj për të menaxhuar pyllin, ujin, kullotën dhe të gjithë resurset, do të thotë të integrosh vendin tënd drejt familjes Europiane.

Zoti Kryeminister! Ne menduam se kjo reformë do të kompletohej me ndryshime ligjore dhe instuticionale dhe rregulla loje të qarta, sepse kur ndyshojnë pronarët duhet të ndryshojnë dhe të drejtat dhe përgjegjësitë për të gjithë.

Në komunat që pyjet janë transferuar në pronësi mungojnë jo vetëm ekspertet për të menaxhuar pyjet, por dhe mbështetje të tjera. Në disa takime të realizuara me komunat gjate muajit Korrik dhe Gusht të gjithë pyesin: Si është ligji? A duhet të shkojë pylli te fermeri? Të gjithë shprehen se nuk kanë të drejtë të marrin eksperte, sepse i kanë strukturat e miratuara? Nuk kanë buxhete, etj.

Në takimin në Burrel, Drejtori i DSHP zoti Skënder Lata, për të shumtën herë ka theksuar se fshatarët i kanë marrë pyjet. Problem është si duhen legalizuar ato. Te njëjtën gjë ka deklaruar dhe ish drejtori i DSHP Dibër, z. Vullnet Tafa, dhe shefi i menaxhimit të Pyjeve të Bulqizës, z. Shkëlqim Hasa, kur thotë se rruga e vetme për të shpëtuar pyjet është privatizimi i shpejtë i tyre.

Ne mendojmë se vazhdimi i reformës së filluar ka hasur në shumë probleme madhore si ligjore por dhe institucionale.

Në fillimin e vitit punës (në Janar) Komuna duhet të planifikojë për pyjet në pronësi te saj ç'farë do të bëjë me pyjet e kullotat: si, sa e ç'farë bimësh medicinale do të grumbulloje; si, sa e ç'farë prodhimesh drusore do të shfrytëzojë; si, sa e ç'fare planifikimi për gjueti sportive do të bëjë; si, sa, e ç'farë kullote do të përdorë, etj..

Të gjitha këto pyetje kërkojnë përgjigje dhe këtë duhet ta japin strukturat e specializuara të sektorit pyjor që duhet të ishin transferuar në Komuna bashkë me pyllin e kullotën si dhe Ministria të kishte dhënë mbështetjen me trajnime intensive sipas porosisë që K/Ministi dha ne fillimin e punës për transferimin.

Por dhe kjo nuk është e mjaftueshme, sepse akoma ligji ka shume paqartësi që kërkon ndryshime themelore kur kanë ndryshuar pronarët dhe raporti me të drejtat.

Duke qenë pjesë e reformës së tokës, fshatarët menduan se Shteti po u plotësonte fermën bujqësore duke ju dhënë pasurinë e tyre, prandaj vazhduan ti mbrojnë pyjet sipas kufijve të vjetër tradicionalë. Ç'do kush në fshat e di që pyjet e dushkut janë pronë me gurë e kufi të fshatarëve deri tani nuk u legalizuan nga shteti këto prona dhe pse deri tani janë hartuar planet e menaxhimit dhe identifikuar përdoruesit realë të tokës.

Ne jemi të njoftuar ne takimet që kemi realizuar me Ministrinë e Mjedisit, madje janë të planifikuara dhe afatet kohore dhe buxhetet për marrjen e eksperteve dhe ndërtimin e një ligji të ri të parashikuar dhe nga projekti i ZHBN dhe i miratuar.

Na çuditi fakti kur Ministri i Mjedisit ju përgjigjet Shoqatave dhe Federatave



Pyjet në rrezik: Shpëtimi vjen nga privatizimi

Para disa ditësh, Federatat Rajonale të Pyjeve dhe Kullotave Komunalë të rretheve Elbasan, Korçë, Dibër, Kukës, Lezhe dhe Shkodër, i kanë drejtuar një letër Kryeministrit të Shqipërisë, për dijeni edhe Presidentit të Republikës, Kryetares së Parlamentit, Ministrit të Integrimit, Parlamentit Europian, Bankës Botërore, SIDA, SNV dhe partive politike në vend, lidhur me të ardhmen e pyjeve në vend si dhe procesin ligjor të administrimit dhe mirëmbajtjes së tyre.

Për një informacion më të saktë dhe të plotë për këtë problem, redaksia mendoi ta botojë të plotë letrën e Federatës së Pyjeve dhe Kullotave Komunalë. Gjithashtu, titulli i shkrimit është i redaksisë. Titulli në letrën origjinale është "Pyjet u transferuan tek komuna por reforma intituicionale dhe ligjore janë harruar nga Ministri ish Pronar i Pyjeve?"

nga 8 Rajone se nuk do të bënte të mundur me ligj që pylli të shkoje tek fermeri.

Këto llojë përgjigjesh i ngjajnë një diktature të re, sepse janë në kundërshtim jo vetëm me Kushtetutën dhe Ligjin (kodin civil) por dhe me një realitet që tashme ka ndodhur deri tani në më shumë se 100 Komuna të vendit.

Në rastin më të keq, kur Ministri nuk do të ndryshojë ligjin, dëmi më i madh i bëhet pyjeve, sepse duke qenë pronë pa zot pylli dhe kullota do të vazhdojnë të keqpërdoren nga te gjithë dhe në rrugë informale dhe këtë e dimë të gjithë shumë mirë çka ndodhe deri me sot kur çdo gjë po shkretohet pafundësisht.

Vetëm në një Qark, e bazuar nga studimet dhe Planet e Menaxhimit për 45750 familje nevojiten mesatarisht 228000 m3 vetëm dru zjarri për ngrohje, pa llogaritur nevojat e tjera për ndërtime.

Shteti raporton 10 % të sasisë. Por ky informalitet ndodh me kullotjen e prerjet në pyjet e reja e të vjetra në vrasjen masive të kafshëve e shpendëve të egra kudo e nga të gjithë.

Alarmi për të ndaluar vrasjet në gjueti erdhi para dy vitesh nga forumi i një Shoqate Gjuetaresh në DIBER: "Të ndalohet gjuetia për 3 vjet", një mesazh që ra në vesh të shurdhër dhe pse u bë debat në një konference me pjesëmarrje nga shumë struktura shtetrore dhe Shoqata të Shqipërisë.

Tani ky alarm duhet dhënë jo vetëm për ndalimin e vrasjeve për kafshët e shpendët, por dhe për mjedisin në tërësi, pyjet e kullotat kolektive e shtetërore që janë drejt shkatërrimit të plotë.

A duhet të vazhdojmë akoma me këtë informalitet ose shkurt të gënjejmë veten apo të vendosim rregulla dhe ligje për privatizimin; Komunën dhe DSHP drejtime teknike me kushte që t'i shërbejnë në radhë të parë pyllit, por dhe fermerit e shtetit për të marrë të ardhura nga përdorimi i planifikuar e i kontrolluar dhe në shume raste dhe i paguar.

Ne mendojmë se baza për këtë është ligji që duhet ndryshuar, ku të njihen pronarët e rinj dhe të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre që nga Komuna, DSHP, privati sasia e pyllit dhe rregullat për të gjithë pronarët. Në ligj duhet të vendoset sasia e pyllit që do ti njihet privatit sipas përdorimit tradicional, sepse aktualisht të gjithë fermerët sot nuk pranojnë tu jepet prona e tyre në përdorim prandaj ato nuk përgjigjen për detyrimet qe duhet të kenë sot dhe në të ardhmen.

Ne kemi kërkuar që ligji të njohë dhe përcaktojë një status të qartë për rolin e një aktori madhor që është komuniteti, përfaqësuar me një strukturë të quajtur shoqatë përdoruesish, që aktualisht janë rreth 140 të tilla në nivel komunash. Ata janë krijuar dhe përfaqësojne banorët që përdorin pyjet e kullotat, ujin dhe burimet e tjera në mjedis. Ato jo vetëm sot, por dhe në të ardhmen duhet të kenë një rol të rëndësishëm për të menaxhuar pyjet Komunalë.

Kaosi qe është krijuar nga vetë strukturat Shtetërore në rastin e Dibrës, por dhe në të gjithë Shqipërinë, porosia e strukturave ishte që të copëzohej pa kritere sipërfaqja e Komunave.

Komuna Tomin, Maqellarë dhe Kastriot me respektivisht me 10000, 12000 dhe 9000 banorë kanë aplikuar prej vitit 2005, me pëlqimin e DSHP, për të marrë në pronësi respektivisht të gjitha pyjet e kullotat në përdorim të tyre për faktin se me ato resurse që kanë nuk plotësojne as 50 % të nevojave të komuniteteve të tyre. Çudia për këto Komuna ishte se u ishte marrë tinëzisht firma drejtueseve të Komunave dhe sot ata kane riaplikuar për të marrë pronat. Të tilla riaplikime po bën dhe Melani, Kalaja e Dodës, Fushë - Çidhna Muhurri, Sllova, etj.

Për të gjitha këto ne ju kemi informuar zoti Kryeministër, por Ministria nuk veproi për të ndaluar veprime të tilla dhe tani vazhdon të mbaje peng ligjin dhe të drejtat e fshatarëve për pronat që i kanë të trashëguara tradicionalisht që në fakt Ministri me strukturat e veta nuk e di dhe s'ka nga ta dijne sepse aksidentalisht drejtojnë Pyjet Komunal të Shqipërisë. Tani duhet të veproni sa nuk është vonë?

Të nderuar VENDIM MARRES! PARLAMENTARE e DONATORE!

Ka mbi 5 vjet, 4 rezoluta dhe disa memo, ju kemi drejtuar gjithmonë kur kërkesat dhe vendimet janë marrë me shumicën e njerëzve që njohin e punojnë çdo ditë me bazën.

Në të gjitha rastet kërkesat tona dhe pse me vonese u futën në rrugën e zgjidhjes për vazhdimin e reformave.

Nuk harrohet kur një drejtues i lartë nga BB na tha para dy vitesh "Kjo reforme do të ndodhë por sa më shpejtë është më mirë"

Ne ju themi sot të nderuar Zoterijn, çdo zvarritje që ju i bëni kësaj reforme dhe ndryshimeve ligjore e institucionale do të ndikojnë dhe shkatërrojnë pasurinë më të madhe të Kombit dhe këtë po jua themi më shumë se tre herë për me shumë se tre vjet.

Të gjitha Rezolutat, Takimet, Kerkesat, Memot, propozimet dhe Kontributet tona ne i kemi të arshivuara dhe do t'ju kujtojme nder vite për shkatërrimet që po i bëni kësaj pasurie me ose pa dashje me veprimet e mosveprimet TUAJA.

Ne si përfaqësues të njerëzve të zgjedhur kemi të drejtë dhe detyrë të flasim për interesa madhore të mos ndalemi pavarësisht nga presionet qe na janë bërë dhe na bëhen sepse e dijmë shumë mirë se jemi në të drejtën tone, në rrugën e pakthyeshme të reformave pavarësisht nga zvarritjet e njerëzve që janë të papërgjegjshëm për këto reforma.

Kërkesat tona do të jenë të vazhdueshme dhe do të përshkallëzohen në protesta të fermerëve nga gjithë komunat në Tiranë.

Z.Kryeminister,

Ne kërkojme që nismat për vazhdimin e reformave në pyje të fillojë me një program të qartë veprimesh nga Qeveria e Ministria e Mjedisit, Drejtoria e Politikave Pyjore fokusuar në dy drejtime kryesore:

- Kuadri ligjor të sigurojë pronësinë e qartë për të gjithë strukturat që do të kenë pyjet (KOMUNA DSHP dhe për privatët). Në ligj të përcaktohet njohja e pronarëve tradicionalë për pyjet deri 1 ha, roli i strukturave menaxhuese për pyjet Komunal që janë SHPPK.
- Kriteret në menaxhim të qëndrueshëm dhe të ardhura nga përdorimi i pyjeve e kullotave komunale, bimët medicinale apo gjuetinë, duke kaluar në kompetencë të Njësive të Qeverisje Vendore tarifat e taksat për të gjitha produktet drusore apo jo drusore pyjore.
- Krijimin dhe funksionimin e shërbimit këshillimor për të asistuar Komunat dhe fermerët në menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotat komunale.

Ne ofrojmë mbështetjen tonë për konsultimin në të gjithë etapat e në të gjithë nivelet, si dhe jemi të gatshëm të marrim pjesë dhe të japim kontributin tonë në procesin e diskutimit të zhvillimit të reformave e Ligjit. Parlamenti shqiptar duhet ta dëgjojë këtë thirrje të komunitetit për t'i dhënë fund shkatërrimit të pyjeve. Ne shpresojmë dhe një herë në mbështetjen Tuaj për të vazhduar këtë reformë aq të rëndësishme për të ardhmen e pyjeve dhe për të zbutur varfërinë e zhvilluar zonat rurale të Shqipërisë.

Federatat rajonale të rretheve
Elbasan, Korçë, Dibër,
Kukës, Lezhë dhe Shkodër

reportazh

22 dhe 23 gusht 2009 u organizua në Peshkopi 65 vjetori i formimit të brigadës 18 sulmuese dhe festa e çlirimit të rrethit të Dibrës.

Një udhëtim buzë Korabit

Nga: **SHPËTIM CAMI**



FTESA

Po punoja në zyrë kur më telefonoi Dine Kaca, një aktivist i komitetit të veteranëve të Tiranës. "A je në zyrë?" - pyeti . "Po" - ju përgjigja. "Kam një ftesë për ty dhe desha të të takoja" - shtoi ai. "Je i mirëpritur" - i thashë.

Më njoftoi se me datë 22 dhe 23 gusht 2009, të shtunën dhe të dielën, organizohej në Peshkopi 65 vjetori i formimit të brigadës 18 sulmuese. 23 gushti është edhe festa e çlirimit të rrethit të Dibrës. U ndjeva shumë mirë. Këtë vit ishte 65 vjetori edhe i çlirimit. Komiteti i veteranëve më kishte ftuar edhe mua si djali i një partizani të brigadës 18 sulmuese. Babai ka ushtruar detyrën e zv/komandantit dhe të komisarit të kompanisë së parë dhe të dytë të batalionit të parë. "Ftesën dhe shallin do ta sjell nesër" – tha Dinja dhe u largua. E falënderova dhe i premtova se do të shkoja. Të nesërmen më solli ftesën dhe shallin e 65 vjetorit te formimit të brigadës.

SLLATINA

Të shtunën në mëngjes u nisa për në Peshkopi. I telefonova një miku tim, Hysen Uka. "Do të shkoj në Sllovë, i thashë, mund të vish me mua?" Ai u tregua i gatshëm. Më priti në Peshkopi dhe të dy udhëtuam për në fshatin Sllatinë tek lapidari i Brigadës 18 sulmuese. Rruga Peshkopi- Sllovë ishte në rikonstruksion dhe po punohej për zgjerimin e saj . Kjo është dhe rruga e re që lidh Dibrën me Kukësin pasi rruga e vjetër buzë Drinit do të përmbytej nga Hidrocentrali i Skavicës. Tek lapidari akoma nuk kishte asnjeri. Ne ishim të parët. Pas pak minutash erdhi Kryetari i Fshatit Sllatinë Idajet Shima. Pas tij erdhi veterani Osman Shima, po nga fshati Sllatinë. Ju kërkuam të na shoqëronin deri në fshatin Sllatinë pasi ishim kuriozë të shikonim fshatin. Pranuan me kënaqësi. Fshati ndodhej në anën perëndimore të vargmaleve të Korabit. Përballë në horizont dukeshin malet ku ndodhen liqenet e Lurës, ndërsa në luginë, lumi Drin zbriste i qetë drejt Kukësit. Një pamje madhështore. Me 30 qershor ishte festa e bjeshkëve. Të gjithë banorët e fshatit mblidheshin së bashku dhe udhëtonin me kuaj ose me këmbë deri në bjeshkë duke marrë edhe ushqime me vete. Në qendër të fshatit ndodhej shkolla dhe një lapidar pranë një plepi shekullor. Ju kushtohej 26 burrave të fshatit, të cilët u bënë pre e masakrës së pushtimit serb të këtij fshati më 29 tetor 1918. Ja çdo të thotë të jesh fshat kufitar. Ke fatin të përballesh i pari me pushtuesin. Ndër mënd më erdhi fshati im kufitar, i cili ka "më shumë dëshmorë se sa shtëpi". Shikoni seç ndodh sot në Mitrovicë , kufiri verior i Kosovës. Më tej ishte ndërtuar e re xhamia nga disa kontribues të këtij fshati. Bëmë disa foto dhe zbritëm përsëri tek Lapidari i Brigadës 18 –S vendosur në një kodër ku dukej nga të gjitha anët e rrugës. Nga kjo Kodër dukej përroi i Veleshicës, i cili bashkohej me lumin Drin pranë Skavicës. Ky përrua ishte dhe një pjesë e kufirit ndarës midis rrethit Dibër dhe rrethit Kukës. Meqë kishim kohë ju propozova të zbrisnim në fshatin Sllovë, aty pranë.

SLLOVA

Në qendër të fshatit ndodhej kryetari i komunës Ramazan Kaza, i cili kishte marrë të gjitha masat për pritje e përcjellje. Ishin njoftuar këshilltarët dhe kryetarët e fshatrave për të pritur në familjet e tyre veteranët dhe pasardhësit e tyre. Një gjest fisnik i kryetarit të Komunës, i cili kishte organizuar edhe një koktej për nder të pjesëmarrësve. Komuna jonë ka tre deputetë në parlament– tha një veteran dhe besoj se do të vijnë edhe sot këtu. Është dita e çlirimit – vazhdo ai.

Në qendër të fshatit Sllovë ndodhej Godina e Komunës, Shkolla e mesme e Bashkuar me rreth 33 mësues dhe Qëndra Shëndetësore. Pak më poshtë ndodhej një lapidar. Ishte i familjes Ndreu. Një labidar kushtuar tre brezave, Sufë Xhelili, Elez Isufi dhe Cen Elezi. Nga kjo familje ishte edhe Komandanti i parë i brigadës 18 sulmuese, Esat Ndreu. Pas tij Zoi Themeli dhe Petrit Dume që të tre të dënuar nga sistemi komunist. Në fshat, një nga familja kujdesej për vendin e të parëve dhe monumentin përkujtimor. Një traditë që duhet promovuar.

Në qendër të komunës ndodhej edhe lapidari i Çetës Partizane të Sllovës e formuar në shkurt të vitit 1943. Aty ishin gdhendur edhe emrat e 15 dëshmorëve të kësaj çete rënë në luftë me pushtuesit gjermanë më 24 nëntor 1943.

Pas ceremonisë së mirëseardhjes nga kryetari i komunës u ngjitëm përsëri tek Lapidari. Në fjalën e rastit, përfaqësuesi i komitetit të veteranëve Selim Pira, njohu të pranishmit me historinë e formimit dhe aktivitetin e kësaj brigade partizane formuar me 18 gusht 1944. Pasi fjalës së rastit dhe përshëndetjeve u erdhi radha fotove. Veteranët dhe pasardhësit së bashku dhe me grupe fiksonin këto momente të bukura.

BURIMI KURATIV I VLESHËS

Ndërsa autobuzët me veteranë dhe pasardhës u kthyen në Peshkopi, së bashku me Hysenin i kërkuam kryetarit të komunës të na jepte një shoqërues për të bërë një vizitë në fshatin Vleshë, njësi e kësaj komune. Me ne erdhën Rafman Gjoka, kryetar i këshillit të komunës, nga fshati Kalle dhe Petrit Çera, punonjës i komunës. Nga ky fshat e kanë origjinën dy deputetët aktual, Sadri Abazi (PS) dhe Sherefedin Shehu (PD). Ndaluam në fillim tek burimi i fshatit. Është ujë kurativ- tha Rafmani. Nga data 10 gusht deri më 10 shtator këtu vijnë me qindra banorë nga të gjitha fshatrat e zonës dhe kurojnë sëmundje reumatizmale. Mund ta provoni- tha ai. U zhveshëm dhe futëm këmbët në ujë. Mezi durohej por pak nga pak mësohesh dhe i mban më gjatë. Nga burimi, uji zbriste tek mulliri i fshatit por tani verës ata e përdornin për vaditje. Pasi bëmë disa foto tek burimi dhe mulliri u drejtuam për tek Teqeja e fshatit. Dibra në kontekstin historik – na tregoi Rafmanika 9 male, 7 teqe dhe 3 oxhakë. Njëra nga teqetë është kjo e Vleshës. Teqeja mbante emrin e Sheh Ibrahimit dhe një pjestar i këtij fisi kujdesej për mirëmbajtjen e saj.

NË TEJS, BUZË KORABIT

Ishte ora 19 00. Po ajo zona atje si quhet – e pyeta Rafmanin. Ajo është zona e Kalasë Dodës. Që këtu është rreth 40 minuta me makinë. A keni kohë të na shoqëroni. Dua të bëj një vizitë edhe atje – ju propozova. Pranuan me kënaqësi. Rafmani na mbante me muhabet gjithë kohës duke na treguar për zonën dhe politikën vendore. Nga Vlesha rruga vazhdonte për në Kukës por diku kishte një degëzim dhe u futëm në rrugën për në Radomirë. Kaluam Urën e Çernievës. Sipas legjendës, para 2 shekujsh, thuhej se ura gjatë natës ngrihej dhe nuk funksiononte ndërsa gjatë ditës ulej dhe shërbente për të kaluar banorët dhe kuajt. Rruga gjarpëronte drejt malit të Korabit. I bëra një foto malit të Gipsit përballë Radomirës dhe shkollës së fshatit dhe u ngjitëm për në Tejz. Aty buronte uji i ftohtë që dilte nga Korabi. Nga ky ujë furnizohej qyteti i Peshkopisë. Pothuajse ishte bërë natë. U ngjitëm tek një baxho qumështi. Pronari i saj ishte nga ky fshat por ishte bërë edhe banor i Tiranës dhe verës vinte grumbullonte qumështin e deleve për të bërë djathë. Provuam të gjithë djathë pa kripë dhe kos deleje. Në malin e Korabit kullotin 25 mijë dele - na tregoi zv/kryetari i komunës së Kalasë Dodës i cili ishte banorë i këtij fshati. Për mikëpritje pimë së bashku një kafe në lokalin pranë baxhove të qumështit. Freskia e Malit të Korabit na ledhatonte ballin. Ora shkoi 21.00. U nisëm për në Peshkopi pasi u përshëndetëm me vendasit së bashku me Hysenin, Rafmanin dhe Petritin. Ishte një udhëtim i mrekullueshëm.



Lapidari i tre brezave Ndreu



Pjesëmarrësit në 65 vjetorin e brigadës 18 sulmuese, 22.08.2009

DITA E ÇLIRIMIT

Në mëngjesin e së dielës, qyteti i Peshkopise ishte i qetë. Ndonëse dite feste, dita e Çlirimit nuk ndjehej. Veteranë dhe pasardhës me shallin në qafë shëtitnin nëpër qytet. Në orën 10.00 shkuam tek varrezat e dëshmorëve për tu bërë homazhe të rënëve në Luftën Nacional – Çlirimtare. Në emër të Komitetit te Veteraneve u vendosen disa kurora me lule. Çuditërisht asnjë subjekt politik i majtë apo i djathtë nuk ishte i pranishëm. As nga Bashkia e Peshkopisë. Fushata kishte gati dy muaj që kishte mbaruar dhe me sa duket akoma nuk ishin çlodhur. Diku në qendër të qytetit pranë ish-turizmit qëndronte busti i Halil Alisë. Mos vallë "gabuan" partizanët që e çliruan qytetin? Pas homazheve, në Qendrën Kulturore u zhvillua një sesion jubilar. Në fjalët e rastit kryetari i veteranëve të rrethit Dibër, Rexhep Cara dhe ish-përgjegjësi i rinisë së batalionit të tretë të brigadës 18 sulmuese, Hajri Hoxha njohën të pranishmit me aktivitetin e kësaj brigade partizane si dhe kontributin e saj për çlirimin e Dibrës, Kukësit dhe Kosovës deri me bashkimin e saj me Divizionin e parë sulmues me 25 prill 1945 në Gjirokastër. Ajo u formua me përbërjen e tre batalioneve, Dibër, Martanesh dhe Çermenikë dhe vullnetarëve nga disa krahina e fshatra të Shqipërisë.

Ja kisha detyrim babait dhe dëshmorëve të atdheut këtë udhëtim. Mirënjohje kontributit dhe sakrificës së tyre.



Te burimi i ujit të fshatit Vleshë



Labidari i fshatit Sllatinë dhe plepi

Rruga Arbërit nr. 40
aktualitet

NË PËRKUJTIM TË RILINDASVE DIBRANË

Bustet e Sait Najdenit dhe Josif Bagerit

Me nismë të Shoqatës së ish të Burgosurve dhe të Dëmtuarve Politikë Shqiptarë në Maqedoni-Dega në Dibër të Madhe, mbështetur nga pushteti vendor dhe financuar nga dibranët, këtyre ditëve u punuan busti i Said Najdenit (1864-1903) dhe i Josif Bagerit (1870-1915). Këto janë dy figurat dibrane të rilindjes dibrane dhe mbarëkombëtare, të cilët dallohen për nga patriotizmi dhe iluminizmi shqiptar.





Këto buste i punuan Fitim Sulo dhe Duro Ibrahimi, skulptorë nga Tirana.

Said Najdeni, alias Hoxhë Voka, është autor i abetares shqipe dhe i "Fe-rrëfenjëses së Muslimanëve", ka bërë një veprimtari të ngjeshur kombëtare dhe ka dhënë një kontribut të shquar për vetëdijësimin kombëtar të bashkëqytetarëve dhe bashkëkombasve përmes shkollës dhe diturisë kombëtare, për një vigjilencë dhe bashkim kombëtar, kundër gllabëruesve ballkanikë që synonin copëtimin e trojeve shqiptare.

Josif Bageri, poet, publicist dhe pronar i gazetës "Shqypeja e Shqypënis", me shkrimet e tij dallohet për nga ngjyra patriotike, dashuria ndaj gjuhës dhe shkollave shqipe dhe kundërshtimi ndaj robërisë. Bageri është patriot i shquar i shqiptarëve në Sofje të mbledhur në gjirin e Shoqërisë "Dëshira", që dalohej me programin për mësimin e gjuhës shqipe dhe përhapjen e diturisë te shqiptarët.

Siç na informoi Bashkim Mashkulli, kryetar i Degës së SHBDP-SH në Dibër të Madhe, këto buste do të inaugurohen në muajin shtator në qendër të qytetit.

R.TORTE



Punimet per palestren sportive te Gjimnazit

Fida: Shumë investime përkundër krizës financiare

Në bisedën që patëm me Argëtim Fidën, kryetarin e komunës Dibra e Madhe rreth investimeve që do të kryhen gjatë këtij viti në komunë, ai u përgjigj se: "Tashmë qytetarët e shikojnë se kanë filluar punimet për ndërtimin e palestrës sportive të Gjimnazit "Zdravko Çoçkovski" në Dibër të Madhe , si parakusht që në të ardhmen do të ndërtohet edhe objektit të ri të kësaj shkolle. Ne arritëm që nëpërmjet Ministrisë së Arsimit të Maqedonisë të sigurojmë fillimisht ndërtimin e palestrës sportive që do të jetë investim prej 500 mijë euro. Ministria nundësoi të gjitha lejet e nevojshme dhe tenderimin, ndërsa rregullimin e çështjes së truallit ndërtimor dhe të ndërtimitm i bëri pushteti vendor dhe fituese e tenderit është firma "Granit" e Shkupit. Punimet kanë filluar në përgatitjen e trasesë, punimet e dheut. Unë jam optimist që edhe dinamika e punimeve së shpejti do të rritet. Kjo palestër do të ketë deri 500 ulëse, terrene për futboll të vogël, hendboll, basketboll, volejboll, mundje dhe pajisjet e nevojshme të brendshme. Sipas përmasave i plotëson standartet e garave".

Më tej ai shtoi se, "Ndërkaq me Projektin e Donacionit Zviceran dhe pjesëmarrjen e komunës, aktualisht përfunduan tenderimet në shkollat, "Vllazrim-Bashkim", "Said Najdeni" dhe në Gjinmazin "Zdravko Çoçkovski" dhe në Entin për edukim parashkollor "Breshia". Këtu janë parashikuar mbi 130 mijë euro investime në rikonstruim e fasadave, oborreve, poligoneve të fëmijëve, ndërsa për Gjimnazin për gjimnazin financohet projekti teknik i realizimit të objektit. Tashmë ka përfunduar projekti i USAID-it në Shkollën "Said Najdeni" në vlerë prej 20 mijë euro, ku mori pjesë edhe komuna . Në këtë shkollë u montuan dy kaldaja të mëdha për nxemjen qëndrore me çka do të përmirësohen kushtet për ngrohejn e shkollës gjatë stinës së dimrit. Gjatë kësaj vere në shkolla do të investohen mbi 150 mijë euro dhe nëse do të kemi mjete mjete të mjaftueshme me siguri do ta bëjmë edhe në rikonstruksionin e paraleleve të ndara të Gjmnazit në fshatin Mogorçë".

"Në Dibër të Madhe paralelisht janë duke vazhduar punimet në objektin e ri Komunës dhe këtij viti do të investohen mbi 200 mijë euro, me shpresë që kah fundi i muajit shtator do t'i afrohemi përfundimit të këtij objekti. Jam optimist se kësaj vjeshte do të vendosemi në këtë objekt të ri".



Argëtim Fida, kryetar I komunës Dibra e Madhe

"Komuna Dibra e Madhe vjet i fitoi edhe dy projekte realizimi i të cilave do të bëhet gjatë këtij viti. Në fshatin Mogorçë do të investohen afër 135 mijë euro për ndërtimine një rezervoari dhe ujësjellësi të ri me kaptazhë të ri me 20 litra ujë/sek dhe rreth 100 mijë euro për rregullimin e shtratit të përroit të parë në Kosovrast të Poshtëm. Gati po përfundon ndërtimi karabina i ambulancës në fshatin Kosovrast i epërm që deri në përfundim do të investohen mbi 50 mijë euro".

"Për rrugën e Kojnarës me gjatësi prej 3. 3 km, me gjerësi 3, 5 metra, ku planifikohet edhe nga 1 metër anash me bankinat janë siguruar mjetet nga Banka Botërore mbi bazën e projektit të fituar të hartuar nga Komuna e Dibrës së Madhe. Tenderimi për ndërtimin e kësaj rruge është në procedurë e sipër dhe pas përfundimit të tij menjëherë do të fillojë edhe ndërtimi I kësaj rruge. ".

"Komuna Dibra e Madhe e fitoi tenderin te IPA Fondet dhe fitoi në konkursin, ku nga 34 komunave konkuruese u radhit e shtata. Kjo do të mundësojë ndërtimin një palestre sportive për qytetin që ka qenë me dekada ëndër e të rinjve dibranë, ku parashihet që velra e saj me TVSH do të arrijë 720 mijë euro. Kjo palestër do të ketë 1500 ulëse me çka njëherë e përgjithmonë do të zgjidhet problemi i mospasjes së ambienteve për të gjitha klubet sportive të qytetit, por kjo do të jetë multifunksionale edhe për spektakle të shoqërivëe të ndryshme kulturore e artistike në komunë.

Kjo palestër do të jetë me hapësira të brendshme 2000 metra katrorë dhe 4000 metra katrorë oborr dhe

Në bashkëpunim me komunat e Shqipërisë jemi angazhuar në aplikimet te IPA Fondet në fushën e bashkëpunimit ndërkufitar. Shpresoj që OJQ-të dhe ne si komuna komunat do të hartojmë projekte me cilësi, që janë kusht për të fituar gjatë aplikimit

gjelbrime".

"Edhe pse ky vit konsiderohet vit i krizës, investimet në komunën Dibra e madhe, falë angazhimit tim personal dhe të stafit të komunës, përgatitëm projekte cilësore me të cilët u fituan mjete edhe nga fondet e huaja, sepse buxheti shtetëror investiv këtë vit është mjaft i reduktuar. Mendojmë se deri në fund të vitit do ta kapërcejmë vlerën prej e 1 milion e gjysëm euro investime, që do të jetë viti më i fuqishëm investiv për komunën tonë nëse të gjitha punët kryen deri në fund të vitit".

"Komuna jonë aplikoi sërish për vitin e ardhshëm për Projektin Forumet në Bashkësi ku financuese është ambasada zvicerane dhe ne do të marrim pjesë me 32 mijë euro, ndërsa ambasada me 100 mijë euro. Në këto forume qytetarët do të vendosin se cilave projekte do tu jepet përparësi.

Në bashkëpunim me komunat e Shqipërisë jemi angazhuar në aplikimet te IPA Fondet në fushën e bashkëpunimit ndërkufitar. Shpresoj që OJQ-të dhe ne si komuna komunat do të hartojmë projekte me cilësi, që janë kusht për të fituar gjatë aplikimit".

"Përkundër vështirësive finaciare komuna jonë edhe në politikën sociale u angazhua që me Ministrinë për Punë e Politikë Sociale ta zbusë vobekësinë, duke punësuar 48 punëtorë sezonalë në afat prej gjashtë muajve, ku qeveria merr pjesë me 6000 ndërsa komuna me 2000 denarë. Këta punëtorë do të kryejnë punë publike në nivel të komunës, në mirëmbajtjen e drurendeve në hyrje të qytetit, pastrimin trotuareve e rrugëve'.

"Komuna jonë ishte nikoqire dhe fiinancuese e shënimit të 100-Vjetorit të Kongresit të Dibrës, e manifestimeve 'Vera kulturore-Dibra 2009 dhe e Festivalit "Teatri shqiptar në Maqedoni-2009" që do të mbahet në vjeshtën e këtij viti, tha në fund Argëtim Fida, kryetar i Dibrës së Madhe".

Rexhep TORTE

VEZHGIM

Dasma po - investime jo

Edhe kësaj vere në Dibër të Madhe erdhën shumë mërgimtarë për tu çmallur me prindërit, farefisin, miqtë dhe shokët. Gjatë këtyre pushimeve verore si çdo vit u organizuan qindra fejesa e dasma. Këto ceremoni dasmore janë vend dhe rast i volitshmë ku të rinjtë dhe të rejat dibrane njihen me njwri-tjetrin.

Në SHBA ka afër 15 mijë dibranë.D ibranë ka edhe në Kanada, në shtetet e tjera të Evropës e gjer në Australinë e largët. Mërgata dibrane atje ku punon e jeton ka biznese të suksesshme dhe pasuria e tyre vlerësohet në miliarda dollarë. Megjithatë investimi i dibranëve në vendlindje është të pothuajse zero. Kjo e rrit papunësinë dhe humb shpresën te të rinjtë që largohen nga vendlindja. Një nga tre shtwpi dibrane është e mbyllur me çelës dhe hapet vetëm kur mërgimtarët vijnë për pushime.

Mërgimtarët dibranë vetëm ia bëjnë qejfin vetes kur thonë se e duan vendlindjen, sepse financiarisht nuk investojnë për të ngritur ekonomi të vogla apo të mesme ku do të punësoheshin dibranët. Mërgata u tregua indiferente edhe gjatë periudhës së privatizimit. Asnjëri nuk vuri dorë ta blejë dhe ta aktivizojë ndonjërin nga objektet ekonomike të falimentuara. Dibranët që aktualisht jetojnë në Dibër të Madhe kërkojnë vetëm të kenë vende pune për ta krijojnë ardhmërinë e tyre në vendlindje.

Gjatë ceremonive dasmore kësaj vere u shpenzuan miliona euro, ndërsa për investime asnjë qindarkë. Paratë u derdhën për salltanete, stoli, muzikë dasmash. Po përmendim vetëm njërën nga dasmat e sivjetme. Kryedasmori u dha muzikantëve përveç 5000 dollarëve sa i kishte bërë pazar, u hodhi bakshish edhe 5000 dollarë tjera.

Mërgimtarët tashmë janë kthyer në vendet nga kanë ardhur dhe 20 gushti do t'i gjejë rrugët e Dibrës të zbrazëta, me shpresë se në të ardhmen do të gjendet çelësi magjik që mërgimtarët dibranë të vendosin të investojnë në vendlindjen e tyre.

Rexhep TORTE



intervistë

Me pedagogen e psikologjisë **EDLIRA HAXHIYMERI**:
Kam mall për rrugët, për bulevardin me blire, për pazarin, llixhat dhe gjithçka që më kujton fëmijërinë time dhe gjyshërit e mi

Studentja që u dashurua me pedagogun e saj



Ka lindur në Tiranë nga dy prindër dibranë Tahir dhe Nustrete Haxhiymeri. Tahiri si një pasardhës i familjes së Iljaz Pashë Dibrës (Qokut) ishte dhe mbeti si pedagogu që bëri më shumë për ato student dibranë që u shkolluan në Tiranë..Ndërsa nëna e saj Nustretja ishte bijë në fisin e njohur të shehlerëve. Edlira si një cucë dibrane që në fëmijëri e ka ndjerë dhe përjetuar ndjenjën e fortë të dashurisë që vetë prindërit i kanë ushqyer për vendlindjen . Përfytyrimi i saj për Dibrën ka qënë si qyteti më i bukur, më i pastër, më mikpritës dhe më me traditë se çdo qytet tjetër. Ky lloj vlerësimi shkonte deri atje se mendonte që jetonte në kryeqytet por kryeqendra e vendit duhej të ishte vendlidja e prindërve të saj Dibra.

Edlira është shkolluar në Tiranë. Studimet universitare i ka kryer për Gjuhë Angleze dhe është specializuar për Psikologji. Që nga viti 1987 është pedagoge ne fushën e Psikologjisë. Ka mbrojtur gradën "Doktore e Shkencave" dhe ka fituar titullin "Profesore e Asocuar". Aktualisht është pedagoge pranë Universitetit të Tiranës në fakultetin e Shkencave Sociale.

Prej vitesh punon si aktiviste e shoqërisë civile për të drejtat e grave dhe fëmijëve.

Është autore e shumë teksteve dhe studimeve mbi probleme sociale që shqetësojnë shoqërinë shqiptare sot.

Ka drejtuar shërbime në komunitet për grupe sociale në nevojë dhe është hartuese e disa projekteve për shërbime sociale.

Jep vazhdimisht kontribut në median e shkruar dhe atë elektronike për çështje të ndryshme sociale.

Është njëkohësisht bashkëpuntore pranë dy universiteteve të huaja, universitetit Clemson në shtetin e Karolinës së Jugut, në Amerikë dhe në universitetin e Europës Juglindore në Maqedoni.

Është e martuar dhe ka një djalë.

KA BOTUAR:

"Dhuna në familjen shqiptare"
"Sjellja njerzore dhe mjedisi social"
"Rolet dhe steriotipet gjinore"
" Mitet dhe realitetet e dhunës në familje"
" Dhuna ndaj fëmijëve dhe pasojat në zhvillimin e tyre".

Për tetë vite me radhë ka qenë përgjegjëse departamenti dhe 2 vjet zv rektore e Universitetit të Tiranës.

Kur jeni martuar dhe çfarë kujtoni pas kaq vitesh nga dita e dasmës suaj?

Jam martuar në 24 korrik të vitit 1983. Sapo kisha mbrojtur diplomën dhe isha gati për të filluar jetën. Dita e dasmës mbetet një nga ditët më të bukura të jetës sime. Kam qenë një nuse e thjeshtë, por besoj se simpatike. Të paktën kështu e vlerësoj pamjen time në fotografitë e dasmës edhe sot. Dasma ishte e vogël, por shumë e bukur. Prindërit ishin kujdesur për çdo gjë. Ata kishin ftuar rrethin e ngushtë familjar dhe miq e shokë të familjes. Megjithëse ishin kohë të vështira, mendoj se prindërit ja dolën të bënin një dasmë të këndshme.

Si jeni njohur me bashkeshortin dhe çfarë të pëlqeu tek ai?

Bashkëshorti im ishte pedagog në fakultetin ku unë isha studente. U njohëm që në vitin e parë të studimeve të mia. Ka qenë një zgjedhje e tij që më tërhoqi pas. Si në ditët e para të njohjes vazhdoj të vlerësoj dashurinë pa kufi që më fal, sinqeritetin, guximin, drejtësinë që në fakt është edhe refreni i jetës së tij. Nuk mund të lë pa përmendur edhe nervin prej 'tosku' që është lehtë i lexueshëm në karakterin e tij dhe që e bën të veçantë, të paktën për mua. Ai ka qënë një mbështetje dhe nxitje për arritjet e mia. Ndonjëherë vlerësoj se mbështetja e tij ka qënë domethënëse për mua.

A jeni grindur ndonjëherë dhe a mbani inate?

Ne debatojmë vazhdimisht. Asnjëri prej nesh nuk hap rrugë lehtë. Biem dakord me njëri tjetrin vetëm kur kemi argumenta të mjaftueshme. Kjo e bën jetën tonë vërtet interesante dhe na ka ndihmuar të mësojmë shumë nga njëri tjetri. Im shoq është rritur në një familje me shumë fëmijë dhe me një rreth të gjërë familjar. Babi i tij është ndarë herët nga jeta dhe atij i është dashur të kujdesej edhe për vëllezërit dhe motrat më të vogla. Kjo e ka pjekur para kohe por edhe e ka ndihmuar ta njohë më mirë jetën. Në këtë pikpamje, argumenti me të më ka ndihmuar të jem gjithmonë me këmbë në tokë. Përgjithësisht, nuk mbajmë inate me njëri tjetrin. Debati mbaron kur njëri prej nesh ka dhënë më shumë argumenta. Pas kësaj fillon mirëkuptimi. Më besoni, debatojmë shumë kur vjen puna për të mbrojtur vlerat e krahinave nga vijmë. Këtu mua më duhet të jem më luftarake pasi ndjej që Dibra nuk ka marrë asnjëherë atë që ka merituar dhe mua më pëlqen që im shoq, pas debateve të gjata, të pranojë që unë kam të drejtë. Në pozicion më të vështirë në këto raste më duket se është djali ynë që nuk di nga t'ja mbajë dhe e zgjidh duke thënë se të dy keni të drejtë.

E vogël dhe në adoleshencë, çfarë ëndërroje të bëheshe?

Në fakt ka qënë një ëndërr e prindërve të mi që të bëhesha mjeke. Jam rritur me këtë ndjesi, megjithëse brenda meje gjithnjë dëshiroja të isha mësuese. Ky ka qënë edhe roli që kam luajtur më shumë në fëmijërinë time. Sidoqoftë, mjeke apo mësuese, i lidhte puna me njerëzit. Arrita që në fund të kisha një profesion që i bashkon të dyja, ëndërrën e prindërve të mi dhe ëndërrën time. Kjo nuk ishte zgjedhja ime, por fati e deshi kështu. Jam e kënaqur dhe ndjehem krejt e plotësuar në profesionin tim. Nuk jam ndjerë asnjëherë keq. I jam përkushtuar profesionit. Jam përpjekur të bëj më të mirën dhe ai ma ka shpërblyer.

Çfarë kujton nga fëmijëria juaj? Po nga adoleshenca?

Fëmijëria ime ka qënë e bukur dhe e qetë. Jam rritur e mbushur me dashurinë dhe kujdesin e prindërve. Nga fëmijëria mbaj mend vizitat e përvitshme në Dibër. Nuk prisnim të mbaronte shkolla dhe të nisnim rrugën drejt gjyshit dhe gjysheve. Kalonim atje pjesën më të madhe të pushimeve verore. Kujdesi i gjysheve, njohjet dhe rrethi i gjërë i njerëzve që na rrethonin, vizitat tek llixhat, në Dri, por edhe në fshatrat përqark për të takuar miq e të afërm të të dy familjeve, i bënin pushimet verore të veçanta dhe na jepnin mundësinë të preknim nga afër realitetin për të cilin prindërit na flisnin vazhdimisht. Ndonjë çapkënllëk që bënim atje nuk ishte aq i dënueshëm sa në Tiranë dhe kjo na jepte më shumë liri e kënaqësi. Dita e kthimit ishte gjithnjë e vështirë. Gjyshja fillonte të qante bashkë me ne ndërsa ne përpiqeshim të fshiheshim që të mos na gjente gjyshi. Më kujtohet si tani një prag vjeshte kur ne duhet të niseshim për Tiranë dhe çdo ditë i luteshimit gjyshit të na jepte edhe një ditë më shumë. Më në fund, kur nuk kishte asnjë zgjidhje, ai u detyrua të thërriste për ndihmë fqinjin polic. Urdhri ishte i prerë: duhet të niseshim për në Tiranë sepse duhet të bëheshim gati për shkollë. Historia në kthim ishte krejt ndryshe. Ndërsa prindërit na pyesnin se si kishim kaluar, ne vetëm qanim. Na duhej pak kohë të ambjentoheshim me Tiranën dhe të rregullonim gjuhën, që për hir të së vërtetës, merrte nuancat e dialektit gjatë qëndrimit tek gjyshërit.

Gjatë adoleshencës kujtoj vitet e bukura të gjimnazit, shoqërinë, aktivitetet si dhe një dëshirë në rritje për të lexuar, në mënyrë të veçantë libra të ndaluar. Ka qënë kjo periudha që më ka mundësuar njohjen me të gjitha kryeveprat e letërsisë dhe që për fatin tim të mirë u thellua më tej me studimet universitare në Gjuhën Angleze.

Me pak fjalë, si do ta protretizoje portretin tënd?

Përgjithësisht jam e qetë, e vëmendshme dhe e kujdesshme. I dua dhe i respektoj njerëzit. Nuk dua të lëndoj askënd. I marr seriozisht punët dhe vlerësoj çdo arritje. Kam dëshirë të bëj shumë gjëra. Edhe kur gaboj, gjej forcë për të vazhduar. Di të them më fal. Vlerësoj njerëzit që bëjnë të njëjtën gjë. Nuk bindem lehtë. Jam e papërtuar për të bërë më të mirën. Jam tolerante dhe fal. Nuk jam hakmarrëse. Urrej pabesinë dhe mosmirënjohjen. Pëlqej dhe vlerësoj sinqeritetin. Jam këmbëngulëse në gjërat e mia. Më pëlqen të lexoj. I kushtoj vëmendje familjes dhe shtëpisë.

Si e gjetët veten në politikë dhe a jeni penduar për këtë?

Politika është një nga gjërat që dua të bëj. Angazhimi im në politikë ka ardhur natyrshëm bashkë me rritjen time profesionale. Avancimi në karrierën profesionale më bëri më të ndjeshme ndaj problemeve dhe realiteteve të vështira në shoqërinë tonë. Zgjidhja e shumë prej tyre varej nga politika. Me dëshirën për të kontribuar në përmirësimin e realitetit social në shoqërinë shqiptare u afrove në politikë. Besoja dhe vazhdoj të besoj se profesionistët e mirë janë edhe politikanë të mirë. Ata që kanë bërë diçka në jetë mund të kontribuojnë për të mirën e përgjithshme. Nuk mund të presim që vendin tonë të na e bëjnë të tjerët. Nuk mjafton të identifikosh probleme dhe të kritikosh të tjerët që nuk dinë të bëjnë më të mirën. E kam ndjerë si përgjegjësi për të dhënë kontributin tim në fushat që unë besoj se i njoh. Natyrisht që kjo nuk është e lehtë.

Fillimisht jam angazhuar si eksperte e më pas si kandidate për deputete në një nga zonat e Tiranës, si zv. Ministre e Arsimit, si Prefekte e Tiranës dhe më pas si Sekretare për Shoqërinë Civile dhe Shancet e Barabarta në Partinë Socialiste.

Pavarësisht nga problemet që krijohen nga politika, nuk jam penduar asnjëherë për angazhimin tim politik. Madje mund të them se ky angazhim më ka bërë më të fortë dhe më këmbëngulëse në mendimin se është përgjegjësi qytetare për të kontribuar në politikë. Nuk besoj se një intelektual do ta quante veten të realizuar në se nuk do të kishte dhënë një kontribut edhe në politikë, pavarësisht krahut politik.

Si grua, besoj se i kam shërbyer dhe do të vazhdoj t'i shërbej politikës edhe për të zbutur maskilitetitn ekstrem që e karakterizon politikën shqiptare sot.

Çfarë dini të gatuani nga ushqimi karakterisitk i Dibrës dhe çfarë nuk dini të gatuani?

Në fakt unë praktikoj gatimin dibran. Përgjithësisht, në mënyrën e gatimit kam imituar nënën time dhe gjyshet. Gatuaj birjanin (me jufka, me oriz apo me makarona) që e kam edhe si specialitetin e kuzhinës time. Për miqtë, në festa, veçanërisht për miqtë e huaj e përgatis dhe e servir me shumë kënaqësi. Supa dhe paçe janë gjithshtu gatime dibrane që i bëj me kënaqësi. Kima me vezë, qoftet me lëng, palacinkat, gjilnari, leshniku, byreku me kungull etj, jane disa nga gatimet që i përgatis shpesh. Nuk guxoj ende me sheqerparen.

Çfarë raportesh keni me Dibrën sot?

Në fakt, ndjej mall dhe jam nostalgjike për të. Sa herë kam mundësi, shkoj pa asnjë mëdyshje. Megjithëse, të afërmit dhe familjarët e mi janë larguar prej kohësh nga Dibra dhe pak të njohur më kanë mbetur ende atje, unë gjithmonë e shikoj atë si një qytet shumë të afërt dhe domethënës në konstitucionin tim personal. Kam mall për rrugët, për bulevardin me blire, për pazarin, llixhat dhe gjithçka që më kujton fëmijërinë time dhe gjyshërit e mi. Përpiqem të frekuentoj të gjitha aktivitetet e fisit dhe të jem e pranishme në të gjitha ndryshimet që pëson qyteti i Peshkopisë. Këdo që takoj dhe ka pak lidhje me Dibrën, e pranoj se jam pak lokaliste, filloj ta shikoj pozitivisht dhe me ndjesi të veçantë. Jam përpjekur që këtë ndjenjë timen për Dibrën dhe dibranët ta përcjell sado pak edhe tek im bir. Uroj që edhe ai një ditë të reflektojë të njëjtën dashuri dhe respekt për dibranët.

Sot familja shqiptare është shumë e trazuar; divorce, krime në familje, vetvrasje. Cilët mendoni se janë shkaktarët e këtyre problemeve në familjen tonë?

Familja shqiptare ashtu sikurse e gjithë shoqëria jonë ka përjetuar një ndryshim të madh që lidhet me nevojën për t'ju përshtatur një mënyre të re të jetesës dhe të mbijetesës. Në këto kushte shumë norma dhe vlera të konsoliduara prej vitesh u rrëzuan, u lëkundën ose e humbën përkohësisht ndikimin e tyre në jetën e familjes. Ajo që dikur njihej dhe vlerësohej si vlerë u shndërrua në antivlerë. Normat u shbënë. Njerëzit e kishin të vështirë t'ju përmbaheshin vlerave dhe normave të mëparshme. Në kushtet e një vakumi vlerash dhe normash, familja shqiptare përjetoi disa probleme. Emigracioni, ndarja e familjes, më pas divorci, kanë ushqyer xhelozinë, dhunën, krimin, krimin ndaj vetes, prostitucionin dhe trafikimin e detyruar të vajzave dhe fëmijëve etj.

Mungesa e informacionit për problemet e shfaqura; mungesa e politikave sociale në ndihmë të familjeve, nënave dhe individëve në nevojë; mungesa e një ekonomie të stabilizuar që krijon hapësira punësimi për shumë individë; ekzistenca e tregut të zi të punës; mungesa e shërbimeve sociale që i japin jetë politikave sociale në shërbim të shtresave në nevojë; politika tejet agresive mohuese dhe aspak pohuese e gjithë këtyre viteve; mungesa e një politike arsimore që bën prioritet edukimin qytetar të fëmijëve; tradita tejet patriarkale, jotolerante dhe jofleksibël e shumë të faktorë të tjerë janë arsyet e kësaj situate të trazuar në familjen shqiptare.

Tradicionalja dhe modernja në familje dhe shoqëri. A mendoni se jemi larguar paksa nga tradicionalja ne shqiptarët?

Unë besoj se tradicionalja dhe moderna bashkëjetojnë në familjen dhe shoqërinë tonë. Ato mbartin aspekte pozitive si dhe aspekte delikate, që unë nuk do t'i quaja negative. Çështja është se si ne i përdorim dhe i shfrytëzojmë të dy këto paradigma të jetës sonë.

Ajo që vërehet jo rrallë sot është frika se mos etiketohemi si tradicionalë. Për këtë arësye rendim pas modernes që nuk e njohim, nuk e kemi për edukatë dhe e bastardojmë atë. Në fakt, ne mund të përfitojnë si nga të qënit tradicionalë ashtu edhe nga të qënit modernë. Problemi është sa dhe si të jemi tradicionalë dhe modernë. Ku dhe kur të jemi të tillë? Për fat të keq, nuk ka receta që të na mësojnë për sjelljet tona tradicionale dhe moderne. Njeriu duhet të bëjë atë që ndjen dhe di të bëjë pa qënë ekstremistë dhe militantë të njërës apo tjetrës paradigmë. Gjithsecili duhet të ndërtojë një balancë të tijën për të dy paradigmat. Mënyra se si ndërtohet balanca varet shumë nga edukimi, emancipimi dhe mënçuria e gjithsecilit. Sa më të arsimuar të jemi, aq më të lehtë e kemi për të ndërtuar balanca të ekuilibruara që nuk ushqejnë ekstremizma dhe absurditete por nxisin dhe ushqejnë vlera të shëndetshme që sigurojnë jetesë harmonike.

***Çfarë duhet të marrin nga moderna dhe çfarë duhet të lënë nga tradicionalja të rinjtë*?**

Mesazhi im për adoleshentët dhe të rinjtë është i lidhur me arsimimin e tyre. Njerëzit e arsimuar i zgjidhin shumë më lehtë dhe pa kosto problemet e tyre. Sa më shumë shkollë e dije, aq më të fuqishëm bëhen ata në jetë. Njerëzit e arsimuar i vendosin lehtë ekuilibrat dhe kjo nuk ju merr kohë e energji pafund. Të paarsimuarit humbasin edhe gjithë jetën e tyre dhe nuk e gjejnë dot ekuilibrin e duhur. E përsëris, nuk ka recetë për përzgjedhjen midis tradicionales dhe modernes. Të dyja janë të rëndësishme. Ne nuk mund të bëjmë pa to. Tradicionalja përbën shtratin ku lind e rritet modernja. Modernja është tradicionalja e ditëve tona. Gjithsesili prej nesh jeton në një gërshetim të të dyjave. Masa e secilës prej tyre tek individi përbën individualitetin e njeriut. Ne dallojmë nga njëri tjetri edhe sepse kemi pesha të ndryshme të tradicionales dhe modernes brenda vetes.

Po ta ilustronim gërshetimin midis tradicionales dhe modernes tek shqiptari do të thosha se tradicionalja na bën të ndjehemi shqiptar, modernja na afrohen me Europën. E meqë ne duam të jemi shqiptarë në Europë, na duhen të dyja këto paradigma.

Bisedoi: Shaqir Skarra

Rruga Arbërit nr. 40

Castrumi i Grazhdanit, për përmasat shumë të mëdha të tij, mund të konsiderohet si një grand castrum, me funksione kryesisht ushtarake. Ajo ka sipërfaqe 34 ha ose 3.2 herë më të madhe se Skampini, 37 herë më të madhe se Paleokastra, 48.6 herë më të madhe se Bushati, 56.6 herë më të madhe se Vigu, dhe 2.27 herë më të madhe se Abritusi.

arkeologji

Zbulime të reja në Kalanë e Grazhdanit

(Vijon nga faqja 3)

kanike, atë Lissus-Naissus në veri. Në këtë periudhë pranë këtij degëzimi rrugor, në territorin e kalasë së Grazhdanit duket se krijohet një qendërbanim me fizionomi qytetare. Arkeologjikisht kësaj periudhe i takojnë disa fragmente enësh të tipit terrasigilata të kuqe, një monedhë bronzi e Filipit Arab (244-249), një numër i madh blloqesh kuadratik, një pilastër guri, si dhe i ashtuquajturi "***stadium*** "i qytetit.

Në sistemin fortifikues të kalasë së Grazhdanit, gjenden të ripërdorur një numër i madh blloqesh kuadratikë të periudhës helenistike. Gjetja për herë të parë e tyre në vitin 1982 *(fig.5-6-blloqe të ripërdorur)*, u pasua në vitet e mëvonshme si dhe në gërmimet e këtij viti me zbulimin e blloqeve të tjerë kuadratikë, të ripërdorur kryesisht në hyrjet e kalasë ose pranë tyre, në murin lindor e atë jugor të kalasë si dhe në kullat gjegjëse e kontrafortet. Këto blloqe janë gdhendur prej guri të pastër gëlqeror, me ngjyrë të bardhë të mbyllur. Ato kanë përmasa të përafërta 0.60 x 0.70 x 0.80 m dhe zakonisht janë të gdhendura mirë në 5-6 faqe. Ata janë marrë nga ndërtimet e mëhershme në qytetin e Grazhdanit, në kohën e ndërtimit të castrumit të tij. Gurë të tillë gëlqerorë nuk gjenden në zonën përreth kalasë së Grazdanit. Ato duhet të jenë sjellë këtu nga ndonjë qendër helenistike ose antike e pellgut të Dibrës, e ndoshta nga vetë trualli i qytetit të Dibrës, ku në shekujt e parë të erës sonë, ka të dhëna për ekzistencën e një qendre qytetare (Dobëri ?)[11], apo drejtpërdrejtë nga gurorja e Banishtit pranë qytetit të sotëm të Dibrës[12]. E njëjta dukuri ndeshet edhe në castrumin Skampis, në themelet e tri hyrjeve të të cilit, janë zbuluar shumë blloqe kuadratikë të ripërdorur të periudhave më të hershme.

Këtyre u duhet shtuar një pilastër guri me prerje gjysëmcilindrike e zbuluar në gërmimet e këtij viti, me gjatësi 0.55m, gjërësi 0.30m dhe trashësi 0.20m. Pilastrat janë gjysëmkollona guri, me trajtim monumental, që formonin kornizën e hyrjes së tempujve apo godinave të rëndësishme publike. Pjesa e dukshme gjysëmrrethore e saj zbukurohet me kanelyra të tipit korrinthik. Baza e sipërme e pilastrës, ruan dy vrimat e derdhjes së plumbit, që shërbenin për bashkimin me pilastrën e radhës. (*fig.7-pilastra)*. Megjithëse të ripërdorur në ndërtimet e mëvonshme, dëshmojnë njohjen e arrkitekturës antike në këtë qytet.

Një indikacion interesant në mbështetje të ekzistencës së një qyteti më të hershëm se kalaja në Grazhdan është edhe toponimi ***"stadium***" i ruajtur deri më sot në memorien popullore. Ai i referohet një parcele me formë te regullt gjysëmeliptike, me sipërfaqe rreth 0.3 ha, me aks veri-jug dhe hapje të orientuar nga perëndimi. Ajo gjendet jashtë murit jugor të kalasë, i cili në këtë segment pëson një harkim mjaft të rregullt e intrigues, dhe ndjek linjën e lakuar të tarracës lindore mbi këtë parcelë, e cila ka të ngjarë të ketë



Fig. 4-pitosi



Fig. 5. Foto e murit kuadratik



Fig. 6. Blloqe kuadratik të ripërdorur

shërbyer si bazë e shkallares së ndonjë stadiumi apo teatri romak të shek. II-III pas Kr. "Stadiumi" ndodhet në anën e jashtme të murit jugor të kalasë, tek kthesa e fortë dhe e rregullt që pëson muri midis kullës nr. 11 dhe 12 dhe në njëfarë mënyre "plotëson" urbanistikën e qytetit të shek. II-III pas Kr. të supozuar në këtë kala. Konfigurimi i terrenit i ngjan në të vërtetë një teatri romak. "Skena" ka formë eliptike me diametër 80m dhe reze 50m. Skarpati ku duhet të ketë qenë "cavea" ka formë të harkuar, lartësi 15-16m dhe pjerrësi mbi 60º, të përshtatshme për vendosjen e "shkallares". Në se ky supozim rezulton i vërtetë nga gërmimet arkeologjke, konfirmohet ekzistenca këtu e një qyteti të periudhës romake. Parcela ku gjendet "stadiumi" thiret me emrin "Jedeli", toponim i lidhur me nënshtresën osmane. *(fig. 8 -pamje e "stadiumit")*

Këto pak të dhëna, na shtyjnë të mendojmë se në hapësirën e kalasë së Grazhdanit, në periudhën e hershme perandorake(shek.II-III pas Kr.) duhet të ketë ekzistuar një vendbanim i hapur qytetar duke filluar të paktën që nga shek. II mb. Kr,. Kjo qendër me karakter tregtaro-zejtar, gradualisht u shndërrua në qytet të mirëfilltë të kësaj periudhe, falë edhe pozitës së shkëlqyer gjeostrategjike në trafikun rrugor ballkanik. Kjo do të thotë se rrethimi me mure nuk është bërë ***ex-novo***, por mbi bazën e një qendre më të hershme urbane.

3. PERIUDHA E VONË PERANDORAKE (SHEK.III-IV PAS KR)

Sistemi fortifikues

Sistemi fortifikues i kalasë së Grazhdanit kryhet gjatë një faze që i referohet fundit të shek. III - fillimit të shek. IV. Ky përfundim rrjedh nga teknika e ndërtimit të mureve mbrojtëse dhe analogjitë e sistemit të saj fortifikues me atë të castrumeve të Skampinit, Vigut, Bushatit e Paleokastrës**.** Në pikpamje planimetrike castrumi i Grazhdanit ka trajtën e një drejtkëndëshi, dy brinjët e ngushta të të cilit, ajo lindore dhe perëndimore janë të drejta, ndërsa brinjët e gjata jugore dhe veriore, i përshtaten terrenit duke ju shmangur linjave rreptësisht të drejta. Megjithëse i shmanget formës klasike të castrumit romak, të gjithë elementët e tjerë, e cilësojnë këtë fortifikim si një castrum të mirëfilltë. *(fig. 2-planimetria e përgjithshme e kalasë)*. Sipas A. Baçes, muret rrethuese me perimetër 2760m, rrethojnë një sipërfaqe prej 34 ha[13]. Shënojmë se sipërfaqja prej 34 ha përputhet me të dhënat e marra nga zyra kadastrale e Peshkopisë, për 8 parcelat e përfshira brenda mureve të kësaj kalaje, që sipas radhës janë: 1. Ograde – 6 ha, 2. Kukale – 4 ha, 3. Ceste – 4 ha, 4. Livanivi – 4 ha, 5. Skuçillë – 2 ha, 6. Bejze – 4 ha, 7. Rankovicë – 4 ha, 8. Çelebicë – 6 ha.

Muret ruhen gati në të gjithë gjatësinë e tyre, përveç disa trakteve të murit verior, të shembura mbi përroin e Kamenicës. Lartësia e ruajtjes së mureve lëviz nga 1-1.50-2.00 m, ndërsa gjerësia e tyre është 2.80-3.20m. Themelet e mureve janë thelluar deri në tabanin e fortë argjilor, që varësisht terrenit shfaqet në thellësitë 0.70-1.50 m. Mbi këtë taban natyror është hedhur një shtresë llaçi gëlqeror, me trashësi 0.08-0.10 m, që ka shërbyer si baza fillestare e murit. Muret janë ndërtuar me gurë lumorë të madhësive mesatare, të lidhura me llaç të bollshëm gëlqeror. Përveç teknikës ***opus incertum***, që mbizotëron, ndeshet edhe teknika ***opus mixtum,*** kjo e fundit kryesisht tek tri hyrjet e castrumit. Llaçi përveç gëlqeres është i përzier me rërë lumi e guralecë, gjë që ka rritur fortësinë e tij. Muri përbëhet nga dy faqet anësore dhe bërthama ose emplektoni midis tyre, gjerësia e të cilit ndryshon varësisht nga gjerësia e mureve rrethuese. Emplektoni tek muret rrethuese është 1.80 - 2.20 m, ndërsa tek kullat arrin në 1.00-1.20 m. Gurët më të mëdhenj janë zgjedhur për në dy faqet anësore të murit, kurse bërthama e tij është mbushur me gurë më të vegjël të hedhur në llaç të bollshëm gëlqeror. Llaçi është hedhur me bollëk edhe në fasadën e jashtme të murit, duke e mbuluar jo vetëm fugat, por dhe një pjesë të faqes së gurëve. Në pjesë të veçanta të murit, lexohen qartë edhe rreshtat horizontal të gurëve, të ndara nga fuga llaçi me gjerësinë 2 - 3 cm. Teknika e ndërtimit të tyre është tipike për shek. III – IV pas Kr. Mbi themel lihet nën të dy anët një xokol me gjerësi 0.12-0.30 m *(fig.9-muri lindor)*. Kjo normë teknike ndeshet edhe në fortifikime të tjera bashkëkohëse si në kalanë e Elbasanit, Pogradecit, Beratit, Durrësit, Bushatit, qytetit të periudhës së vonë antike të Shkodrës[14]etj dhe jashtë vendit tonë edhe në Abritus apo kala të tjera romake të kësaj periudhe[15].

Muret rrethuese përforcohen nga 44 kulla në të gjithë gjatësinë e tyre. Sistemi fortifikues i tij kombinon 4 tipe kullash: kullat në formë "U "-je, ato katrore dhe drejtëkëndore midis tyre si dhe kullat në trajtë freskoreje në këndet dhe kthesat e forta. Në këtë castrum mbizotërojnë kullat në formë "U"-je, që përbëjnë një veçori të sistemit fortifikues të tij. Bashkëjetesa e këtyre 4 tipe kullash, ndeshet në kala të tipit castrum në Shqipëri (Vig, Skampin, Paleokastër, Bushat) , dhe jashtë saj në një hapësirë të gjërë të perandorisë, që nga Lindja e Afërt, në Arabi (el-Leggun, Odruh), në Siri (ed-Dumer), në Bullgari (Abritus), në Rumani (Ulmetum, Troesmis, Capidava) dhe deri në Angli (Porchester). Përdorimin e 4 tipeve të kullave në të njëjtin fortifikim, studiuesit e konsiderojnë si një fazë të re dhe më të avancuar të fortifikimeve romake, të përdorur në intervalin e shek. III – IV pas Kr.*(fig. 10-12-kulla nr. 2, fig. 13-muri fundor i kullës 2)*.



Fig. 7. Pilastër e ripërdorur në ndërtimin e kishës

Largësia midis kullave, e ashtuquajtura kurtinë, nuk është e njëjtë dhe duket se ka qenë kushtëzuar nga faktorë topografik e ushtarakë, të rëndësishëm për kohën (rezja e veprimit të shigjetës, forca goditëse e balistave, thyerja e terrenit, kthesat e murit si dhe nevoja e një mbrojtjeje më të fuqishme në hyrjet). Kështu, largësia maksimale e kullave në terren të sheshtë për murin verior është 40-58 m dhe për murin jugor 40 - 43 m, ndërsa tek këndet e mureve dhe thyerjet e relievit ajo ulet deri në 35 - 40 m.

Kalaja ka patur tri hyrje, dy në një aks veri-jug dhe një në faqen lindore të saj. Vendosja e dy hyrjeve kryesore të kalasë në të njëjtin aks, sipas stilit të ashtuquajtur *via principalis,* përbën një tipar dallues të fortifikimeve romake të tipit të castrumit. Secila nga hyrjet mbrohej nga dy kulla në formë " U" -je të vendosura në të dy anët e hyrjes. Kjo mënyrë e mbrojtjes së hyrjeve është karakteristike për castrumet e gjysmës së parë të shek. IV pas Kr., siç dëshmohet në hyrjet lindore e perëndimore të Skampinit dhe të Vigut. Hyrja jugore e kalasë së Grazhdanit përfaqëson një model klasik të hyrjeve me dy porta. Midis tyre krijohet një oborr i brendshëm katërkëndesh i fortifikuar i tipit ***propognaculum,*** që shërbente si qendra e fundit e asgjësimit të sulmuesve.

Hyrja lindore e kalasë, me sipërfaqe rreth 1000m^2 gjendet ngjitur me rrugën e sotme nacionale, tek vendi i quajtur *„kisha „*. Ajo u zbulua pjesërisht gjatë fushatës së fundit të korrikut 2009. Kjo hyrje me gjerësi 28m mbrohet nga dy kulla në formë „U"-je me gjatësi 21.5 dhe 23 m. dhe hapësirë të brendshme 9 m, midis të cilave krijohet oborri i fortifikuar i dyfishtë, i jashtëm dhe i brendshëm, i tipit ***propognaculum***.

(fig. 14- hyrja lindore). Përfaqëson hyrjen më monumentale jo vetëm të kalasë së Grazhdanit, por të të gjithë fortifikimeve të antikitetit të vonë në Shqipëri. Hyrjet e kalasë së Grazhdanit janë krejt identike me portën lindore të Skampinit (Elbasan) dhe atë perëndimore të Vigut (Shkodër), me njërën nga hyrjet e Ulpianës (Justiniana Secunda), si dhe me portën veriore të Abritusit (Bullgari). Studiuesit kanë konstatuar se ky tip hyrjesh i kështjellave, që fillon të përdoret që me perandorin Vespasian (69-79 pas Kr), nis të zhduket në vazhdim të shek. IV pas Kr.[16]. Studiuesit kanë konstatuar se ky tip hyrjesh i kështjellave, që fillon të përdoret që me perandorin Vespasian (69-79 pas Kr), nis të zhduket në vazhdim të shek. IV pas Kr.

Kronologjia

Kalaja e Grazhdanit është një fortifikim i tipit të castrumit romak. Në pikëpamje kronologjike ajo i referohet fazës së parë të veprimtarisë fortifikuese perandorake në provincat ballkanike, e lidhur me fundin e shek.III dhe fillimin e shek.IV pas Kr, ose me harkun kohor që fillon me Dioklecianin (284-305) dhe vazhdon me Licinin (308-324) dhe Konstandinin (324-337). Ky përfundim rrjedh nga teknika e ndërtimit të mureve mbrojtëse dhe analogjitë e sistemit të saj fortifikues me atë të castrumeve të Skampinit, Vigut, Bushatit e Paleokastrës. Por gjithsesi, mungesa e të dhënave më të plota arkeologjike, numizmatike apo epigrafike, për të argumentuar plotësisht mendimin e mësipërm, e lenë të hapur mundësinë e një datimi më të ngushtë.

Castrumi i Grazhdanit, për përmasat shumë të mëdha të tij, mund të konsiderohet si një ***grand castrum***, me funksione kryesisht ushtarake. Ajo ka sipërfaqe 34 ha ose 3.2 herë më të madhe se Skampini (10.178 ha), 37 herë më të madhe se Paleokastra (0.915 ha), 48.6 herë më të madhe se Bushati (0.7 ha), 56.6 herë më të madhe se Vigu (0.615 ha), dhe 2.27 herë më të madhe se Abritusi (15 ha) etj. Një ndërtim i tillë gjigant është konceptuar nga ekspertët ushtarak të Romës, si një bazë e fuqishme ushtarake në brendësinë kontinentale të provincave ballkanike. Krahasuar me kështjella të tjera legjionare, duke u mbështetur vetëm në sipërfaqen e madhe të kësaj kalaje, rezulton se aty mund të sistemohej një garnizon i madh romak, i përbërë nga 2 legjione ose rreth 10.000-12.000 trupa ushtarake. Ato janë mbajtur aty të gatshëm për çdo emergjencë përballë rezikut të sulmeve gote. Një ndërtim i përmasave të tilla, tregon rëndësinë e madhe që kishte për perandorinë romake rruga e Drinit të Zi dhe rajoni i Dibrës në përgjithësi, në kontekst me provincat tjera ballkanike të perandorisë romake

.

4. PERIUDHA E VONË ANTIKE (shek. V-VI pas Kr)

Kjo është periudha e jetës më intensive të qytetit të Grazhdanit. Në pikëpamje arkeologjike ajo konfirmohet nga fragmentet e shumta të enëve të gjetura në sipërfaqen e tij, përgjatë murit rethues si dhe në kullat dhe hyrjet e gërmuara. Qeramika e ndërtimit përfaqësohet nganjë numër i madh tullash (44 x 28 x 4.5 cm) me sipërfaqe të dekoruar me kanelyra në trajtë kryqi, tufa vijash valore dhe tjegullash me buzë gjithashtu të zbukuruara me vija të thelluara paralele.


Fig. 8

Fig. 9


Fig. 10


Fig. 11


Fig. 12


Fig. 13


Fig. 14

Në foto: Fig. 8 - Stadiumi; Fig. 9 - Muri lindor; Fig. 10 - Fasada e jashtme e murit të kullës; Fig. 11 - Kulla nr. 2 e hyrjes lindore; Fig. 12 - Kulla nr. 2; Fig. 13. Muri fundor i kullës 2; Fig. 14 (Shih faqen e parë) - Pamje e përgjithshme e hyrjes lindore; Fig. 15 - Pamje e pjesshme e varrezës së Grazhdanit.

Në pjesën qendrore të hapësirës së brendshme të castrumit të Grazhdanit ruhen gjurmë të godinave shoqërore apo ushtarake të periudhës së vonë antike, si të godinave civile të banimit, kapanoneve të ushtarëve, termave publike, të çesmave (fontanave), pusit etj. Ato janë të orientuara sipas një plani ortogonal, gjë që është përcaktuar nga kryqëzimi në kënd të drejtë i dy rrugëve kryesore të tij. Rruga I , e quajtur ***"Livanivi" (cardo maximus)*** bashkonte dy hyrjet kryesore të kalasë, atë jugore dhe atë veriore ndërsa rruga II (***decumanus maximus),*** e quajtur ***"Çelebia"*** përshkon qytetin mespërmes nga hyrja lindore e kalasë, deri në parcelën fundore brenda murit perëndimor.

Për mungesë të gërmimeve arkeologjike, studiuesit nuk janë të një mendimi lidhur me gjenezën e këtij qyteti. Kështu D. Komata e përfshin Grazhdanin në grupin e qendrave të reja të fortifikuara, që lindin në brendësi të vendit në shek. IV-VI pas Kr., krahas Skupit, Ulpianës, Justiniana Primës dhe të një numri qendrash më të vogla të fortifikuara, me funksione kryesisht ushtarake[17]. Ndryshe prej tij, Gj. Karaiskaj e mendon atë si një qytet të lindur në periudhën romake dhe të rrethuar për herë të parë me mure në shek. e IV pas Kr.[18] . Sipas A. Baçes, qyteti i Grazhdanit është krijuar që në shek. I pas Kr. si një qendër buzë rrugore tregtare e zejtare, që dora dorës u zhvillua si qytet[19]. Ndërsa prof. S. Anamali, e përfshin Grazhdanin në grupin e kështjellave të lashta ilire të rifortifikuara, të tipit të castrave ushtarake, krahas Skampinit, Vigut, Bushatit e Paleokastrës [20].

Në shekujt V-VI pas Kr., castrumi i Grazhdanit, ruan pozitën e tij strategjike në kontroll të rrugës tregtaro-ushtarake të Drinit që lidhte provincën *Epirus Nova* me provincat e Macedonia secunda, atë të Prevalitanisë dhe të Dardanisë. Në këtë periudhë, Grazhdani ishte qendra e një sistemi të plotë fortifikimesh, që e rrethojnë luginën e Drinit të Zi në trajtë kurore. Në të dy anë të luginës numërohen 14 fortifikime të kësaj periudhe, që siguronin mbrojtjen e këtij rajoni dhe rrugës së rëndësishme që e përshkonte atë

Kjo kala, duket se e humbi funksionin e saj mbrojtës rreth mesit të shek. VI pas Kr. Afërsisht kësaj kohe i takojnë fragmentet e enëve të gjetura në shtresën e zezë dhe dheun e djegur me gjatësi 5m e trashësi nga 0.10-1.00m, të zbuluar në profilin pranë hyrjes lindore të kalasë. Kjo djegie e ky shkatërrim i vendbanimit në gjysmën e shek. VI pas Kr., ndoshta duhet lidhur me valën e parë të sulmeve plaçkitëse skllavene të vitit 548 ose 551, për të cilat në burimet historike ka të dhëna indirekte. Prokopi i Cezaresë na tregon se *"afërsisht në këtë kohë, një ushtri skllavenësh, duke kaluar lumin Istër, bëri shkatërrime të tmerrshme në të gjithë Ilirinë deri në Epidamn" (547 – 548)* dhe se *" në këtë kohë (551-552) një turmë e madhe skllavenësh u derdh në Iliri dhe bëri atje tmerre të papërshkruara..."*[21].

Lidhur me emrin antik të këtij fortifikimi, është shprehur mendimi se ai do të mund të identifikohej me fortesën ***Deyfrakos***[22], prej emrit të së cilës duhet të rrjedh edhe etimiologjia e emrit të sotëm të krahinës Dibër. Lidhur me këtë problem ekzistojnë disa pikpamje të ndryshme. Njëra prej tyre është ajo e H. Sadikajt, K. Frashërit dhe A. Baçes që shikojnë në këtë kala rrënojat e qytetit antik të Dobërit, prej të cilit rrjedh sipas tyre edhe etimiologjia e emrit të krahinës.

Shkruesi i këtyre radhëve është i mendimit se emri antik i

PIKËPAMJE E RE e Prof. asoc. dr. Adem Bunguri

Ja nga vjen emri "Dibër"

Lidhur me këtë problem mendojmë se jemi afër të vërtetës, në se i referohemi emrit të qytetit ***Dioboros*** të guidës së Hieroklit[23]. Ky qytet i provincës së parë maqedonase, i lokalizuar në ***Doirani*** të Maqedonisë egjeane, mendojmë se mund të identifikohet në rrënojat e kalasë së Grazhdanit. Nga emri ***Dioboros*** i këtij qyteti, rrjedh lirisht në pikëpamje fonetike trajta e sotme e emrit ***Dibër.*** Në bazë të rregullave të zhvillimit fonetik të gjuhës shqipe rezulton i pranueshëm shëndrimi i diftongut **"io" - "i"**, i zanores **"o" - "ë"** si dhe rënja e mbaresës greke **"os"** për të pranuar barazimin fonetik ***Dioboros = Dibër*** . Për këtë supozim përveç ngjashmërisë fonetike mbështetemi edhe në supozimin e njohur se në periudhën romake *"Grazhdani duhet të ketë qenë qendra e të dy Dibrave"* [24].

këtij qyteti duhet kërkuar në guidën e Hieroklit të periudhës së Justinianit(shek. VI pas Kr.). të hartuar për t'u përdorë nga nëpunësit shtetëror që shkonin me shërbim në provincat e ndryshme të perandorisë.

Lidhur me këtë problem mendojmë se jemi afër të vërtetës, në se i referohemi emrit të qytetit ***Dioboros*** të guidës së Hieroklit[23]. Ky qytet i provincës së parë maqedonase, i lokalizuar në ***Doirani*** të Maqedonisë egjeane, mendojmë se mund të identifikohet në rrënojat e kalasë së Grazhdanit. Nga emri ***Dioboros*** i këtij qyteti, rrjedh lirisht në pikëpamje fonetike trajta e sotme e emrit ***Dibër.*** Në bazë të rregullave të zhvillimit fonetik të gjuhës shqipe rezulton i pranueshëm shëndrimi i diftongut **" io '! i "**, i zanores **"o" '! "ë"** si dhe rënja e mbaresës greke **"os"** për të pranuar barazimin fonetik ***Dioboros = Dibër*** . Për këtë supozim përveç ngjashmërisë fonetike mbështetemi edhe në supozimin e njohur se në periudhën romake *"Grazhdani duhet të ketë qenë qendra e të dy Dibrave"* [24].

5. GRAZHDANI MESJETAR - QENDËR E KULTURËS ARBËRORE

Gjatë periudhës së mesjetës së hershme (shek. VII-XI pas Kr.), vendbanimi tkurret mjaft dhe kthehet në një qendër fshatare. Karakteristikë për këtë periudhë është varfëria dhe thjeshtësia e qeramikës. Duke filluar nga shek. XI vendbanimi zvogëlohet në mënyrë të ndjeshme dhe një pjesë e tij kthehet në varrezë. Siç treguan gërmimet e këtij viti, pikërisht në këtë kohë, shëndrohet në kishë kulla nr. 1 e hyrjes lindore të kalasë dhe e gjithë hyrja e dikurshme me rreth 1000 m^2 kthehet në nekropol. Varret janë të ndërtuara me rasa në formë arke (të tipit çist), me orientim lindje-perëndim, riti i varrimit me trupvënje me duar të kryqëzuara në gjoks. *(fig. 15-nekropoli mesjetar i Grazhdanit)*. Nekropole të tillë karakteristikë janë për kulturën

(Vijon në faqen 15)

portret



INXHINIERI PA DIPLOMË

ZABIT MUDA...

Nga: **ABDURAHIM ASHIKU**

Ishim ulur në ballkon e shtëpisë time dhe të fëmijëve të mi, në katin e tretë të godinës së parë të kompleksit të ri të Zabit Mudës, trekatërqind metra poshtë Malit të Robit. "Thikat" e arta të diellit, prerë nga "gjilpërat"e pishave ndaleshin në sytë e mi duke ma turbulluar paksa pamjen e kaltër të detit nën ngjyrat e perëndimit.

Bisedonim me nga një gotë lëngu të freskët frutash. Nuk pranoi të merrte një uiski çka më befasoi për faktin se në vendet ku kishte shkuar dhe kishte punuar binomi kafe – konjak apo kafe – fërnet, ishte i pashmangshëm në tavolinë me shokë apo në banakët para punës së mëngjesit. Më tej, ndërsa do të zhytesha në vitet e vegjëlisë, të rinisë dhe të pjekurisë, do ta kuptoja pse-në.

Kam zhvilluar shumë biseda me njerëz të punës, në Dibër e në emigracion, por biseda me Zabit Mudën ishte më emocionuesja e jetës sime.

Nga dera e Islam Mudës së vjetër ka dalë nuse gjyshja ime, Aishe Zhuzhi.

Biseda me Zabitin do të më kthente në kohë, shumë vite më parë, gjashtëdhjetë vjet të shkuara. Do të ulesha në odën përdhese të shtëpisë dykatëshe për të dëgjuar rrëfimet e Islamit ulur në krye të vendit nën atë ndriçim të pa kapshëm nga penela piktorësh që i jep fytyrës së njeriut zjarri i këndellur në oxhak...

Do të kthehesha në festën e Nevruzit, ditë që në Pilafe festohej dymbëdhjetë ditë pas ditës së verës kurse në Brezhdan nëntë ditë pas saj, ditë që në vitet e vegjëlisë nuk mungonim kurrë të shkonim ose në Pilafe tek "Dajat e nënës" ose në Tomin tek "Tezja e gjyshes", nëna e Xhavit Kalecit...

Edhe sot më vijnë në vesh, si një melodi simfonike, këngët që shënonin mbrëmjet në Natën e Nevruzit, dialogë tipikë paganë me thirrjet:

A ta pres?
Me kalë e me thes.
Ata pres or Gegë?
Me kalë e me shegë.
Ata pres or Toskë?
Me kalë e me plloskë.
A ta pres?
Preje...

Dhe atje ku tuni i sëpatës godiste, "plagën" e lidhnim me kashtë thekëri...

Më vonë, kur do të vazhdoja shtatëvjeçaren jo një herë jam ulur në dhomën poshtë, përballë Xhetanit të zhytur në defterë të kohës, me vulën e kryetarit të këshillit në dorë...

Ymerin e mbaj mend tërë jetën midis farërave, në degën e farërave, shumë vite në Peshkopi dhe shumë të tjerë në përroin e Pilafe. Njeri i punës, një njeri i ndershëm...

Ymer Mudën e njohin si njeri shpërndante farëra që gjelbërojnë fushat, kodrat e malet...

Të birin, Zabitin, e njohin si njeri të ndërtimeve, si një inxhinier pa diplomë, si një njeri që u ul në auditorin e Universitetit të Madh të Punës, në Hidrocentralin e Fierzës ku mori diplomën shkëlqyeshëm.

Dikush, një sekretar organizate, nuk ia dha karakteristikën për të vazhduar Universitetin, kur atë ia kishin dhënë profesorët e mëdhenj të "Universitetit të Fierzës"...

Kohë të çuditshme...

* * *

***Zabit Muda...Një njeri dhe një emër që flet nëpërmjet ndërtimeve...Jemi në kompleksin AGZA-DIBRA, në ballkonin e katit të dytë të njërës prej tri ndërtesave të bukura, ndërtesa që dallojnë midis gjithë të tjerave në këtë pjesë të bregdetit në zonën e Malit të Robit. Si lindi ideja e ndërtimit të këtij kompleksi*?**

Ideja?...Profesioni im është ai i ndërtuesit. Zbatova normat teknike të kohës dhe arrita të ndërtoj këtë kompleks, tri ndërtesa me nga tre kate plus papafingon. Nuk renda pas fitimit. Fare mirë mund të shtoja edhe një apo dy kate. Në këtë rast nuk do të kishte parking për të gjithë, ndërsa me këtë lartësi ndërtimi ka për çdo apartament parking në mjediset e kompleksit, mjedise ku përveç parkingut të makinave ka, siç e sheh edhe hapësirën e gjelbër, barin që sapo ka nis të jeshilojë dhe pemët dekorative...

Kur keni filluar punën si ndërtues dhe ku?

Si ndërtues kam filluar më 7 korrik të vitit 1972. E kam filluar në hidrocentralin e Fierzës.

Çfarë kujtimesh keni atje në fushën e profesionit?

Në fushën e profesionit kam pasur shansin e madh që të punoj me elitën e ndërtuesve shqiptarë të asaj kohe. Të punoje krah një inxhinieri të madh shqiptar të hidroteknikës si Farudin Hoxha është një shkollë, një universitet më vete. Atje kishte inxhinierë topografë më të mirët e Shqipërisë si Vasillaq Spaho e Nexhat Turkeshi. Këta ishin më të mirët e asaj kohe dhe vazhdojnë të jenë. Unë kam pas shansin të punoj në krah të tyre dhe kam përfituar shumë nga ata.

Konkretisht...

Kam përfituar të gjitha, të gjitha proceset e ndërtimit. Unë kam shkuar atje kur lumi Drin ishte në shtratin e tij shekullor. Kam jetuar aktivisht çastin kur Drini është devijuar. Kam qenë kur janë hedhur themelet e godinës së hidrocentralit dhe të sallës së turbinave. Atje ishin të gjitha proceset e punës që lidhen me ndërtimin.

Jam përballë një talenti në fushën e ndërtimeve. Me sa nga sa e njoh unë familjen tuaj, njohje që në vogli, as Islami i vjetër, as Xhetani, as Haliti, as Sabriu dhe as babai juaj – Ymeri, nuk janë marrë me ndërtimet. Nuk e di se nga çfarë geni erdhi dhe u vendos në trupin dhe shpirtin tuaj geni i talentit në ndërtim?

Nuk e di, ndoshta punë fati, ndoshta edhe pse me ndërtimin u mora që i vogël. Sapo mbarova klasën e tetë unë nisa punën në një objekt të madh, një universitet të punës. Meritë ka babai im, i cili ndoshta me dhimbje më largoi larg, shumë larg për kohën dhe shumë të vështirë për punën në moshën time. Mendova se po të vazhdoja gjimnazin nuk do të ngjitesha më lart, siç edhe nuk u ngjita. Gjimnazi është shkollë shumë e mirë por po nuk u ngjite pas tij, nuk i vlen kujë.

Në Fierzë vazhduat shkollën?

Sigurisht. Punoja ditën kurse natën vazhdoja shkollën e ndërtimit. Tre ditët e tjera të javës nuk kam lënë kurs pa e mbaruar, kurse të asaj kohe si hekurkthyes, karpentier, murator...Në të gjitha kapa kategoritë maksimale.

Në Fierzë kanë shkuar shumë njerëz...

Dhjetëmijë veta punonim atje...

Po, por një njeri që ta ketë kaq për zemër ndërtimin si ju është diçka e veçantë...

Fillimisht e kam filluar punën duke zëvendësuar një person që shpërndante gazetat. Ai mori lejen e zakonshme dhe me ndërhyrjen e dajës tim tek shefi i kuadrit, isha shumë i vogël, shpërndava për pesëmbëdhjetë ditë gazetat. Për fat atje ishte një inxhinier që sot e kam mik të ngushtë, Burhan Turkeshi i cili më ka dhënë mësim, më ka dhënë edhe zanat. Burhani ishte tip sportiv, kishte qenë futbollist me "Partizanin"por kishte dëmtuar gjurin dhe ishte shmangur nga loja. Ishte tifoz sporti, sikurse edhe unë. Ai abonohej në të gjitha gazetat dhe revistat e asaj kohe. Gjigant, dy metër burrë, patrioti jonë nga Dibra e Madhe. Unë, me korrektesën më të madhe, ia çoja gazetat si askujt tjetër çka i bëri shumë përshtypje. Me tu kthyer personi nga leja e zakonshme Burhani insistoi që të më merrte pranë. Ai ishte inxhinier hidroteknik por për momentin ushtronte profesionin e inxhinierit topograf. E kishte si të



> Zabitin e njohin si njeri të ndërtimeve, si një njeri që u ul në auditorin e Universitetit të Madh të Punës, në Hidrocentralin e Fierzës ku mori diplomën shkëlqyeshëm.

thuash në gen familjar. Edhe dy vëllezërit e tij ishin inxhinierë topografë. Vëllai i mesit, Nexhat Turkeshi që siç e thashë më përpara është një nga inxhinierët topografë më të mirë në Shqipëri.

Nga Fierza u kthyet në...

Nga Fierza kalova në disa rrugë të errëta të kohës. Shoku im, Burhani insistonte që të vazhdoja studimet universitare. Ndërhyri tek drejtori i asaj kohe në hidrocentral, tek Emin Musliu, edhe ky një ndër figurat më të mëdha të ndërtimit të asaj dhe të kësaj kohe. Ai si drejtor ndërmarrje kishte shumë relata me sekretarin e parë të asaj kohe Hysen Papa. Me ndërhyrjen e tij arriti që të vendosej që unë të shkoja në shkollë. Shkova tek shefi i arsimit, i dorëzova të gjitha dokumentet që kërkoheshin, dokumente të cilat i pranoi. Por... dokumentet duheshin plotësuar edhe me një karakteristikë nga organizata bazë e partisë në fshat, dokument të cilin sekretari i organizatës, të cilin nuk dua t'ia përmend emrin, nuk ma dha....

Kështu kapitulli i shkollës u mbyll. Shkova ushtar, xhenier nga derdhja e lumit të Matit deri në Kep të Rodonit, ku për dy vjet u mora me ndërtimin e bunkerëve të kohës.

Pas ushtrisë shkova në Peshkopi ku fillova punën në ndërtimin e ujësjellësit nga Kalaja e Dodës në Peshkopi. Sektori ku punoja unë ishte Sllovë – Kala e Dodës, burimet e Preshit.

Edhe këtu shansi më dha mundësinë të punoj me një inxhinier shumë të talentuar, i cili sot nuk ndodhet mes nesh, me Sakip Zebin...

Më tej kam punuar në NSHN, kam punuar në degën e planit, në zbatim, në degën teknike, në zbatim... Tre vjetët e punës në degën teknike më shërbyen shumë në profesionin tim.

Kam ndërtuar frigoriferin, një objekt shumë i madh për kohën në Peshkopi. Kam ndërtuar shumë banesa. Kam filluar ndërtimin e pallatit të kulturës...

Ju kam bërë disa fotografi atje...

Po. Ju më keni fotografuar. Ca mi ke dhënë ti kurse ca i kam pas. Ke shkruar edhe në gazetë me sa mbaj mend unë. Fatkeqësisht atë shkrim nuk e kam.

Do ta gjejmë...

Mirë do të ishte... Më pas erdhën vitet nëntëdhjetë. U mbyll ndërmarrja... Jam i pari që kam kaluar privat. Më janë ofruar, pavarësisht se arsimin e lartë nuk e kisha, drejtor ndërmarrje, post që zgjidhej me votim. Megjithëse u votova unanimisht nuk pranova.

(Vijon numrin e ardhshëm)

kulturë

"Të gjithë mendojnë se kanë diçka për të thënë, ndërsa në rastin e Gëzimit, ai ka diçka për të thënë që ja vlen të dëgjohet"
Damian O'Louighlin – The Birmingham News

"Sikur të vdekurit të dëgjonin"

Në mjediset e sallës 'Abreti' në Tirana International Hotel në Tiranë, Qendrës Ndërkombëtare e Kulturës "Arbnori" bëri prezantimi e dramës "If only the dead could listen" i autorit shqiptaro-britanik Gëzim Alpion



Gëzim Ismaili Alpion



Shkrimtari dhe akademiku i njohur shqiptaro-britanik, Gëzim Ismaili Alpion, rikthehet në Tiranë me shfaqjen e tij "If only the dead could listen" (Sikur të vdekurit të dëgjonin).

Qendra Ndërkombëtare e Kulturës "Arbnori", organizoi në mjediset e sallës "Abreti", në Tirana International Hotel, të Premten më datë 14 gusht 2009, në orën 11:00, prezantimin e kësaj drame.

"If only the dead could listen" është një ripunim i dramës "Vouchers", që u botua në Angli në vitin 2001. Për herë të parë "Vouchers" u vu në skenë me regji të dramaturges serbe Dr. Duska Radosavljevic në Festivalin e Teatrit Bashkëkohor Evropian në Huddersfield të Anglisë, në mars 2002.

Në qendër të dramës, ngjarjet e së cilës zhvillohen në Londër në vitin 2001, janë Leka, një azilant politik nga Kosova, dhe Alma, një studiuese nga Tirana. Drama shtjellon disa tema delikate. Alpion është shprehur se nuk shkruan për ta argëtuar publikun por për ta shqetësuar atë. "Për mua arti është terapi. Drama trajton kryesisht tragjedinë e kombit tonë, por tragjedia jonë është pjesë e pandarë e tragjedisë njerëzore që kalon kufijtë tokësor, etnik, fetar dhe kohor", është shprehur Alpion. Në këtë kuptim, qëllimi i tij nuk ka qenë thjesht të shkruajë një dramë shqiptare por të përdorë karakteristika shqiptare për të trajtuar një dramë me temë mbarë njerëzore.

E sponsorizuar nga Arts Council England, dhe me regji të Marcus Fernando, "If only the dead could listen" ka pasur premierën në Angli në shkurt të vitit 2006 nga trupa teatrale Dreamscape në Teatrin MAC në Birmingham. Suksesi i shfaqjeve u pasqyrua gjerë në mediat britanike dhe ballkanike (Shqipëri, Kosovë, Maqedoni dhe Serbi). Kritikët dhe spektatorët kanë vlerësuar veçanërisht interpretimin e aktorit të njohur anglez Richard Attlee (nipi i ish kryeministri britanik Clement Attlee) në rolin e azilantit politik nga Kosova, Leka Trimi.

Pas suksesit të shfaqjeve në Angli, Alpion dhe regjisori Fernando morën ftesa nga Teatri Kombëtar në Tiranë dhe Teatri Kombëtar i Kosovës. Regjisorë dhe dashamirës të artit dramatik në Maqedoni, Serbi dhe Kroaci po ashtu u interesuan që Dreamscape të bëjë një turne në këto tre vende.

Në mars të vitit 2008, po me sponsorizimin e Arts Council England, Kompania e Teatrit Dreamscape shfaqi me sukses dramën në dy qytete angleze: në Birmingham (në Teatrin MAC) dhe në Wolverhampton (në Teatrin Arena). Në rolin e Lekës këtë radhë ishte aktori i talentuar anglez Andrew Cullum, i cili ka marrë pjesë në dramën seriale televizive angleze EastEnders.

"If only the dead could listen" u botua nga "Globic Press" në SHBA në vitin 2008.

Në fillim të prezantimit me 14 gusht u shfaq e filmuar premiera angleze e dramës, ndërsa pas shfaqjes së premierës, Dr Alpion zhvilloi bisedën me temë "Identiteti Kombëtar Shqiptar: Kohezion në Individualizëm dhe Fragmentim", në të cilën u shtjellojë se përse në "Voushers" dhe "If only the dead could listen", ai përqendrohet në trajtimin e refugjatëve dhe azilantëve shqiptarë në Perëndim, si dhe në raportet që bashkatdhetarët vendosin me njëri tjetrin në mërgim.

Alpion u përqendrua kryesisht në kompleksin e inferioritetit që vihet re tek disa shqiptarë në Perëndim, dhe argumentojë se drama është një art i fuqishëm dhe mjet efikas për të trajtuar aspekte të rëndësishme dhe tabu që kanë të bëjnë me identitetin tonë kombëtar. Sipas Alpion, arti dhe artistët mund dhe duhet të kontribuojnë më shumë për të sjellë më pranë njëri tjetrit popujt e Ballkanit, dhe kjo bëhet më mirë kur gjejmë dhe vlerësojmë vlera të përbashkëta.

Pas prezantimit të dramës, Gëzim Ismaili Alpion iu përgjigj pyetjeve të pjesmarrësve të shumtë në takim si dhe zhvilloi biseda të lira me ta, mes të cilëve edhe shumë miqve të tij nga vendlindja.

VLERËSIME PËR DRAMAT E ALPIONIT

"Fatmirësisht "If only the dead could listen" është e çliruar nga vargonjtë e komercializmit; asaj i japin jetë idetë, personazhet dhe tensioni dramatik. Kjo dramë përbën një sfidë si për aktorët ashtu edhe për regjisorët." *(Marcos Fernando – Regjisori i dramës "If only the dead could listen" në Angli në vitet 2006 dhe 2008)*

"Në këtë dramë, Dr Alpion më tepër u drejtohet 'të vdekurve të gjallë' të cilët akoma nuk i kuptojnë dhe nuk përmbushin detyrimet që kanë ndaj njerëzve të pambrojtur". *(Profesor Gaston Roberge – Indi)*

"Kjo është një dramë e fuqishme e shkruar me plotë besim, gjë që dëshmon se shkrimtari ka një ndjesi të fuqishme teatri, dhe aftësinë për të gërshetuar dialogun eksplozivi me një vlerësim sensitiv të dilemave që hasin të 'përjashtuarit' social-politik". *(Profesor J. T Boulton – Anëtar i Akademisë Britanike)*

"Dr Alpion nuk ka frikë që të trajtojë temën sensitive të azilantëve në Britani në dramën e tij të fuqishme 'Voushers'". *(Tony Collins – The Evening Mail)*

"Të gjithë mendojnë se kanë diçka për të thënë, ndërsa në rastin e Gëzimit, ai ka diçka për të thënë që ja vlen të dëgjohet". *(Damian O'Louighlin – The Birmingham News)*





NË KOXHAXHIK SHTËPI MUZE PËR QEMAL ATATURKUN

Kryeministri maqedonas Nikolla Gruevski, i shoqëruar nga Z/v kryeministri Abdulaqim Ademi, Ministrja për Kulturë, Elizabeta Kamçevska, ministri për kulturë i Turqisë, Nihat Gjul dhe drejtori i Qendrës nacionale për restaurim të monumenteve kulturore historike, Behixhudin Shehapi, të dielën më datë 16 gusht 2009, vuri gurthemelin e shtëpisë muze në fshatin Koxhaxhik të komunës Qendra e Zhupës, prej ku e kanë prejardhjen prindërit e Mustafa Qemal Ataturkut, themeluesit të Turqisë moderne. Ky projekt i Qeverisë së Maqedonisë kap vlerën prej 300 mijë euro ndërsa sëbashku me rrugën gjer te shtëpia muze do të kushtojë 650 mijë euro. Një pjesë të këtij projekti do ta financojë edhe Republika e Turqisë.


"Ky projekt është në frymën e kultivimit të respektimit dhe afirmimit të veçorive nacionale të popullatës turke në Maqedoni, por edhe rezultat i bashkëpunimit të frytshëm dhe intensiv të Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Turqisë", tha Gruevski.

Ndërsa Nihat Gjul, ministër për kulturë i Turqisë, theksoi se kjo është edhe një konfirmim i marrëdhënieve të mira e miqësore dhe i bashkëpunimit të frytshëm kulturor mes dy vendeve".

Kjo shtëpi muze do të prezantojë eksponate historike, do të ketë rol multinacional dhe do të ndikojë në zhvillimin e turizmit në këtë zonë.

"101 LISAT E DIBRËS"

Më datë 10 gusht ora 11 në një nga sallat e Shtëpisë Qendrore të Ushtrisë u bë promovimi i librit të Garip Trocit "101 lisat e Dibrës" Ky promovim kishte të veçantën e tij.Ishin mbledhur miq e shokë të Garipit, koleg e ish koleg, njerëz të familjes. Kishin ardhur në këtë sallë jo vetëm për të promovuar këtë libër me vlera të pakontestuara për Dibrën dhe dibranët por dhe për të festuar 60 vjetorin e Garipit, Vërtet një ditë e shënuar. Një takim i paharruar mes shokëve e miqve, të rinj por dhe të vjetër. Takimi nuk kishte protokoll. Pas fjalës së shkrimtarit Albert Zholi, biseda më pas nisi rrjedhshëm. Folën të gjithë jo vetëm për librin por treguan dhe kujtimet e bukura që kishin përjetuar me Garipin. Foli Shpend Topollaj, Nuri Dragoi, Defrim Methasani, Mevlud Buci, Avni Agolli. Në fund një urim i përbashkët, një fotografi si dhe një koktej ku gotat u ngritën për dy gëzimet e Garip Trocit që shumë bukur i kishte llogaritur të na mblidhte në të njëjtën ditë.



Me guxim te pashoq, këmbëngulje të jashtëzakonshme, me netë të shumta të pagjum ndërmori, zbulimin e anës tjetër të medaljes, kolonizatoret e shekullit të tetë para erës son, morën nga popullsia autoktone (Pellazgët), kulturën fetare, heroit legjendar, shkrimin, mënyrën e oraganizimit të jetës ekonomike, shoqërore, mjeshtrinë e perpunimit të metaleve etj



Dr. Ramiz Zekaj, në emër të Institutit Shqiptar të Mendimit dhe të Qytetërimit Islam (AIITC), përcjell urimet me rastin e muajit të Ramazanit për mbarë besimtarët muslimanë.

URIM ME RASTIN E MUAJIT TË BEKUAR TË RAMAZANIT

Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam (AIITC), me rastin e muajit të madhëreshëm të Ramazanit, ju uron të gjithë besimtarëve muslimanë: Agjërim të lehtë e të pranuar dhe përfitim nga të gjithë mirësitë që sjell ky muaj!

Urojmë që nëpërmjet agjërimit të sinqertë, të lutjeve dhe kryerjes me përkushtim të riteve fetare, besimtarët të ndodhen sa më afër Zotit të Lavdëruar.

Nga dashuria dhe besimi për Krijuesin e gjithësisë burojnë të gjitha ndjenjat e pastra dhe virtytet e larta njerëzore. Ndjenja e madhëruar dhe fisnike e besimit është gurrë e pashtershme nga ku buron humanizmi i thellë, dashuria dhe respekti për njeriun si qenia më e ndershme, më e përkryer dhe më e bukur e krijuar për të adhuruar Zotin. Ramazani është muaji që i kështillon njerëzit të jetojnë në paqe, në miqësi, në harmoni e të mirëkuptohen me njëri-tjetrin. Është muaj sprove, muaj i angazhimit në luftë kundër çdo të keqeje dhe rreziku që kërcënon shoqërinë njerëzore.

Në këtë muaj të bekuar besimtari lartësohet shpirtërisht, bëhet më paqësor, më i sinqertë, më i thjeshtë, më i durueshëm, më zemërgjerë, më dashamirës dhe fiton shumë tipare e cilësi të shëndosha, për të cilat ka nevojë shoqëria shqiptare. Ky muaj reflekton mirësi në plan shumëdimensional për shkak se afërsia me Zotin është ndjenja që e bën njeriun më të mirë, më të moralshëm, më të virtytshëm, më të ndershëm, më bujar dhe e orienton atë në rrugën drejt së mirës, përsosmërisë dhe vlerave shpirtërore.

Shqiptarët pavarësisht besimeve që u përkasin, duan të jetojnë në paqe e harmoni midis tyre dhe kanë nevojë për mesazhe mirëkuptimi, të cilat përcillen fuqishëm në muajin e shenjtë të Ramazanit.

Dritë diturie në shekujt e errët

Nga: Dr. SELMAN MEZIU

***Të hedhësh dritë për ti'u dhënë shkëlqim vërtetësie katërqind vjetëve(1800-800 para erës sonë) është nje sipërmarrje sa e guximshme aq edhe mundimshme. Të zbulosh rrënjët e stërgjyshërve të tu, të përhumbura në mugëtirën e mijëra e mijëra vjeteve, e në hapsira toksore të pa perceptuehme deri më sot, me anë te analizave, përqasjeve të qindra librave e miliona fjalëve dhjetra gjuhëve të autorëve të lashtë modern, miteve e legjendave, mbishkrimeve, është një heroizëm i pashoq e një mençuri tejskajshme. Por kjo ishte ë vetmia rrugë për zbulimin e gjeneologjisë së* Pellazgëve.**

Ky është* Mathieu Aref. *Studimin e tij e ka shprehur në njëmijë e dyqind e dhjet faqe, të ndara në dy libra,* Shqipëria(Historia dhe Gjuha). Odiseja e pa besueshme e një populli parahelen. *Botuar ne vitin 2007.* Mikenët = Pellazgët. Greqia ose zgjidhjae një enigma. *Tiranë, Plejad 2008.

KUSH ËSHTË MATHIEU AREF?


Lufta e përgjakshme Ballkanike, varfëria e tmerrshme që kishte pllakosur krahinën e Matit e detyroi babain e tij të braktis fshatin Rremull, në vitin 1910 dhe të emigroi në Egjypt, ndërsa ai bashkohet me të dashurën e tij, njëzet e gjashtë vjet më vonë.

Më 1 Mars 1938 lindi Arefi ne Kajro. Shkollohet në qytetin e lindjes. Zotron që në moshën e adoleshencës Arabishten, Frëngjishten dhe gjuhën e mëmës. Në vitin njëmijë e nëntëqid e gjashtëdhjetë e një ai udhëton për në Paris. Por përse vallë ky njeri me origjinë shqiptare ndërrmerr këtë udhëtim? Ndoshta si turist, si ambasador apo këshilltar.

Udhëtar të shumtë francez, ambasador si Ami Boue, Pouqueville F. C. H. L. , A. Degrand, Hyacinthe Hecquard, Victor Berard etj, etj, kanë vizituar e shkruar shum për atdheun e tijë. Atëhere ai shkon të kshillohet e të njohë veprat e tyre! Por adhe kjo nuk është e vërtet. Atëhere cili është vallë misioni i tijë?

Me shkoqur na e rrëfen ai vetë kur shkruan: ''Kur nisa hulmutimet e mia dhe fillova të shkruaj veprën që keni në dorë, në fillim të viteve 1996(ngjizja e saj ka zgjatur tridhjetë vjet), kam qenë plotësisht i bindur se PELLAZGET ishin populli më i vjetër në Europë, por kisha vetëm një ide të turbullt për zanafillën e vërtet të Grekërve*...,, ,*

Shkëndinë e ndezjes së pishtarit të idesë për të ndërmarr këtë studim të stërmadh ia dha vepra e Amerikanit Martin Bernal ''Athina ë zezë,, (Fabrikimi I GreqiseAntike (1785-



1985) *ku zbulohet borxhi që i kanë* HELENET *qytetërimit Egjyptian. E lexoi këtë vepër me vëmendjen e kureshtjen e një studiozi. Në qelizat e trurit filluan të krijohen vatra frymëzimi për të gërmuar mbi të kaluarën shum të largët të origjinës së popullit të origjinës së tij.*

Me guxim te pashoq, këmbëngulje të jashtëzakonshme, me netë të shumta të pagjum ndërmori, zbulimin e anës tjetër të medaljes, kolonizatoret e shekullit të tetë para erës son, morën nga popullsia autoktone (Pellazgët), kulturën fetare, heroit legjendar, shkrimin, mënyrën e oraganizimit të jetës ekonomike, shoqërore, mjeshtrinë e perpunimit të metaleve etj. Këto u zbuluan ''ndër rrjeshta apo në mes tyre,, duke lexuar e rilexuar krijimet e Homerit rapsod që i këndonte rrugëve këngët e tijë, por të përpunuara me mjeshtri tinzare, nga shkrues të shumt grek të epokave të Solonit*(640-561p. e. s.),* Pisistratit*(561-527 p. e. s.)* e Aleksandriane*(336-323 p. e. s.)*

Mathieu është i ndergjegjshëm në punën tijë, i sinçert e serioz''.... në mungesë të një dokumentazioni të plotë e seroz,, -shprehet ai. , , apo ''prirem të mendoj...,, etj. etj. në kërkim të degëve ekstremo –lindore të pellazgjishtes së lashtë.

Ai nuk është kategorik, i prerë në gjykimet e tija për këtë apo atë çështje ''. . ka të ngjarë një shkrim.... , Dorianët, , apo ''sipas mendimit tim.... ,, Është i shtruar, dorë lëshuar, sepse nuk kërkon tiu imponoi lexuesëve për atë që ai s'ka prova të qënsishme për të bindur vetëveten.

Këtij mëmdhetari të flaktë i dhimbset gjer në palcë të shpirtit fatëlumsia e këtijë popullì

Ja çfar shprehje lapidar i gurgullon nga thellësia e zemrës ''Vendi i tyre është katandisur në një pëllëmbë tokë nëse kemi parasysh territorin e madh që ata(pellazgët S. M.) zotëronin në brigjet e Danubit deri në Epir dhe nga Adriatiku deri në Thrakë. ,,

Ky historian i fund shekullit të njëzete e i fillimit të njëzetë e njëtë nuk është aspak nihilist apo mohues mos mirënjohës por as ksenofob për historinë e kulturën shumëplanshe të Greqisë *të të gjitha kohërave. Ai shprehet:. . ''qytetërimi i tyre, kultura e tyre dhe mbi të gjitha gjenia e tyre,, te cilat duke filluar nga shekulli i VI para krishtit deri në pushtimin e Greqisë nga romakët, kanë ndriçuar botën tone të lashtë me dritën e tyre kulturore, artistike, filozofike dhe shkencore.,,*

Objektiva të reja i ka vënë vetes në fushën ë historisë së lashtë, mbi Iberët e Baskët për të zgjidhur enigmën e tyre, mbi origjinën, kulturën, etninë, emigrimin e historia e tyre të fshehur në mantelin e zi të shekujve do të shkruhet në një libër.

MËNYRA E NDËRTIMIT TË VEPRËS

Librat e shumta të marra për tu kshilluar e konsultuar fillojnë që ne vitet shtatëqind e pesëdhjetë para erës sonë e deri ne ditët tona pra shekulli i njëzetë e njëtë. Eshte sistemuar ndër kapituj e nën kapituj, me përfundime në fund të tyre, të cilat nëpermjet ghuhës së thjesht e të komunikueshme, larg shprehjeve akadameike i bën dy librat të kuptohen lehtë, e të mësosh mjaft nyje kyqe të kësaj epoke të fshehur nën mantelin roze të delirit të madhështisë HELENE, gjer më sot. .

Kronologjitë e Greqisë arkaike, klasike e helenike, të Azisë së Vogël, Italisë, Egjyptit të lashtë etj jane një formë e re për të paraqitur materialin, shkurt, qartë, e të përdorshëm lehtësisht për shkrues e studies të fushava të ndryshme të dijes.

Përdorimi i shkronjave kapitale apo normale me ngjyrë të zezë, korsive, thonjëzave i shprehjeve latine si''stricto sensu,, *etj, e tabelave të fiseve e popujve të ndryshëm apo i fjalëve të tyre të krahasuara me gjuhën shqipe përbëjnë një gjetje të zgjuar që i shkon për shtat llojit të vepres, stilit histori rrëfenjës e rëndësisë shumëplanshe të sajë.*

Zgjedhja me kujdes e fotografive, ndertimi i hartave mbi shtrirjen e popullsive të ndryshme të këtyre kohërave shumë të largeta, për Azinë ë Vogël, Afrikën Veriore, Shtetve Europine etj përben një ilustrim bindës, konkret të prekshëm për kategori të ndryshme lexuesish studiuesish. Ndërsa cilësia e shtypëshkrimit është rrokullisur një shekull prapa nga Shtepia Botuese PLEJAD, e cila i ç'vlerëson përmbajtjen, kuptimin e përdorimin kësaj vepre.

Ndërsa përkthyesja Iliriana Angoni *ka derdhur me gjithë forcën njohuritë gjuhësor, dialektikore, ë fjalëforrmuese në përkthimin e veprës nga* Frëngjishtia . *Por kanë mbetur jo pak fjale me origjinë të huaj si: stratigrafike, konvergjencë, divergjencë, rebus, manikeizmi, aborigjene, portuale magmën,* ambiguite, dekriptuar, autokton, spektri, rezonancë, epilog, heterogjen, etj, të clave me lehtësi mund t'iu gjëndesh barazvlerat e tyre në gjuhën tonë të begatshme.

Autorit në të dy volumet nuk i kanë shpëtuar përsëritjet e natyrave, të legjendave, fjalive, shprehjeve, për të cilat ne nuk po japim shifra, apo përsëritje të tyre, këto kanë një motiv: dëshirën, pasionin e një studiuesi për popullin e atdheun tijë të origjinës, e odisenë fatkeqe për dymijë e pesëqind vjet me rradhë.

Eshtë për të ardhur keq që një vepre të tille, i mungon treguesi i emrave, nuk mund të shkruajm se kush nuk e ka kryer, sepse nuk njohim origjinalin e sajë, por kjo do të lehtësonte studimin e shfrytëzimin efikas të sajë.

(Vijon numrin e ardhshëm me çështjet:)
- Shtjellimi i së vërtetës mbi Pellazgët
- Në hullinë e hulmutimeve

AKSION HUMANITAR NË DIBËR TË MADHE

Paketa me ushqime për të varfërit

Me nismën e një grupi të të rinjve dhe me përkrahje të Shoqatave "Drita" dhe "One dollar for Dibra", u arrit që në Dibër,për nder të Ramazanit të madhërishëm brenda disa ditëve nga qytetarët dibranë u grumbulluan sasi të konsiderueshme artikujsh ushqimor miell, vaj,sheqer,oriz, krip, fasule, jufka, etj. Këta të rinj entuziastë këtyre ditëve nëpër familjet e skamnorëve shpërndanë afër 60 pako ushqimore. Ky gjest human është shprehje e devotshmërisë dhe solidaritetit në këtë muaj të shenjtë të agjërimit që edhe sofrat e skamnorëve të jenë më të begatshme. ***/ R.T.***



Xhamia e Inqarit, një nga më të vjetrat në rajon.

opinion

"Po t'i shohësh në mënyrë diakronike rrjedhat e proceseve reformuese në vendin tonë, duken qartë ritmet tepër të ngadalta të zhvillimit, thyrjet e shpeshta të procesit, rënie të papritura në hone e kurthe, të cilat na kanë marrë shumë kohe dhe na krijojnë ndjesinë dëshpëruese, sikur jemi të dënuar të bëjmë punën e Sizifit"

Studim me vlera për gjuhën e tregimeve alegorike

Rreth librit "Shëmbëlltyra në folklor dhe letërsi" i autorit Hajri Mandri

Nga: **Dr.FEJZULLA GJABRI**

STUDIM PËR SHEMBËLLTYRËN

Ka pak kohë që bibliotekave të studiuesve të folklorit dhe letërsisë i është shtuar studimi "Shembëlltyra në folklore dhe letërsi" të autorit Hajri Mandri, në fillim si tezë për shkallëm "master". Por, studimi i botuar i kalon caqet e synimit të parë të autorit: për të mbrojtur tezë. Veç folklorit, më saktë analizës shkencore, aty lexuesi gjen etnografi dhe sociolinguistikë, mitologji, depërtime në rrefimet teologjike (kur'anor e ungjillor) , në tekste autorësh, si dhe shembuj e përkufizime nga literatura bashkëkohore. Studimi jep një tabllo të gjallë jetës së shembëlltyrës, duke treguar se ajo prap jeton. Jeton në vise me traditë në ketë lloj komunikimi, duke u përqëndruar në Dibër, Kosovë e më tej. Autori thotë se ajo jeton edhe në letërsinë e kultivuar, dhënë me mjeshtëri nga shkrimtarë të traditës dhe deri në ditët e sotme.

DIMENSIONE MË SHUMË SE GJUHËSORE

Merita e autorit qëndron në shkoqitjen e shembëlltyrës, parë në disa drejtime, të cilat janë renditur me kujdes sipas një metode bashkëkohore. Për këtë, duket se është dhe dora e studiuesit Shaban Sinani, reçensent i librit. E them ketë, pasi Shaban Sinani njihet për thellësinë e mendimeve, saktësinë shkencore dhe, ajo që është më e rëndësishmja, i pakursyer te kolegët. Me një hyrje dhe mbyllje, Profesor Sinani jep kodin e materialit të autorit, çelësin për të kuptuar atë që ka arritur të thotë monografia, duke i shtuar më tej vlerat shkencore.


Ç'na thotë studiuesi Mandri në analizën e tij për shembëlltyrën, alias, bisedë alegorike? Së pari, analizat e tregimeve me shembëlltyrë të përdorura në ketë monografi, japin njoftime për pasurinë e informacionit të ligjërimit gjuhësor, etnografik (përfshi të dhënit e së drejtës), njoftime mësimi e formimi për jetën e deri tek kodet e komunikimit midis njerëzve, veças në odat e miqve. Odat në shumë vise kanë qenë institucione komunikimi dhe "shkolla" mësimi dhe edukimi, kur shkolla e vërtetë mungonte..

Gjithashtu autori fillimisht na jep përkufizimin e të folurit me alegori, na bën të njohur me pak dukuri që kanë arritur nga tradita, si dhe me gjendjen e saj në ligjërimet e sotme, format më të përhapura të tregimit alegorik, shembëlltyrës teologjike dhe laike, duke arritur të bëjë dhe seleksionimin parë nga origjina. Pra, tregon se sa është ajo vendëse dhe ndikimet nga lëvzja e njerëzve apo ndikime të tjera.

Autori tregon se gjuha alegorike përmban "të fshehur" kuptimin e mendimit që përcjell. Ajo ka një hapësirë gjeografike, një truall ku kultivohet, duke formuar një areal të qenësishëm, mbase unikal, nëpërmjet transmetimit që ky të folur mbart në vetvete. Duhen kuptuar e vlerësuar faktorët gjuhësorë, me kombinimet e tyre sintaksore e leksikore, se ato janë kripa e lëndës që përdoret gjatë të folurit alegorik.

STILI I LIGJËRIMIT POPULLOR

Ato ndërtohen me një stil të veçantë e të figurshëm të gjuhës popullore. Ky është një vlerësim i dhënë në ketë monografi, i konstatuar nga shtjellime, që autori i ka bërë materialit të mbledhur në terren, nga botimet dhe literatura teorike bashkëkohore. Gjithashtu gjykimet dhe vlerësimet të dala nga tregimet popullore, tërthorazi, përmes frazeologjish e shprehjesh të shkurtra, autori vlerëson rolin e tyre në transmetimin e një mesazhi, një ideje, përçimin një zgjidhje. Të folurit me nënkuptime ka në bazë thënie të moçme apo tregim të sajuar nga njerëz të caktuar, aty për aty, duke thirrur në ndimë edhe ndonjë anekdotë të ndryshuar, që përmban në vetvete edhe figura artistike



Këtë lloj ligjërimi e kanë mbledhur e shkruar (e më pak trajtuar) edhe studiues të tjerë të mirënjohur si Anton Çeta, Gjovalin Shkurtaj, Mehmet Halimi, Xhafer Martini, Haziz Ndreu, Hilmi Kolgjegja dhe kohet e fundit Shaqir Skarra, i cili mblodhi e botoi vëllimin me titull "Malet e Dibrës". Duhet thënë se as mbledhja e tyre e më pak studimi nuk janë shterues. Përkundrazi, sa herë t'i kthehesh materialit shembëlltyrë", do vesh re mendime të tjera, vlera të pakapshme, synime të padukshme etj. Mbështetur në mbledhjet e mëparshme, Hajri Mandri deri tani na jep më shkoqur, të analizuar tashmë alegorinë, jo vetëm siç jemi mësuar të cilësojmë si fjalë "të mençur" apo si figurë artistike e gjuhë alegorike e të të fshehurit, por si filozofi, si art, si veprimtari shoqërore nga shekuj, të argumentuar me një literaturë të pasur.

SI GJUHË SHENJASH

Jo gjithkush e kupton bisedën alegorike, gjuhën e shenjave. Gjuha me nëntekst është jo e lehtë. Ajo do kodin, do përvojën, përgatitjen për të bërë analogji. Siç e ka cilësuar edhe autori i monografisë që po flasim, nëntekësti i shprehur me këtë mënyrë të komunikuari është i ndërvarur nga rrethana të caktuara. Për të shtuar shembujt e shumtë të dhëna në ketë vëllim, po shënoj një bisedë shenjimesh (tjetër për tjetër), ndërvarur nga koha dhe mjedisi:

"Në vitet '50-të të shekullit kaluar, u takuan dy burra mbi të dyzetat në një lokal. Njani ishte ulë para dhe i dyti, kur pa se s'kishte vend me u ul diku tjetër, drejtohet burrit që ishte vetëm: Njatjeta, or Shaban! Ky s'e kishte emnin Shaban, po e kuptoi se ai që i foli, e kishte ketë emën. i thotë dhe ky emnin e vet dhe gjatë bisedës e pyet njani tjetrin: -Sa shkollë ke? Dy vjet shkollë dite e tre shkollë nate. Tjetri i thotë: Ta kalokem ty se kam katër vjet shkollë nate e vazhdoj shkollën e ditës. Po folim lirshëm se paskemi të njëjtën shkollë...". U morën vesh se të dy kishin qenë të burgosur e kulakë. Kodi: shkolla e natës-burgu, shkolla e ditës-kulakllëku. Kjo se asnjëri s'ishin në moshë shkollore e në rininë e tyre shkolla ishte e rrallë. U desh ky kod komunikimi që ata të flisnin me njëri tjetrin, e tjerët përrreth të mos e merrnin vesh. Komunikim me shifër.

Thamë më sipër se studimi i Hajri Manrit nuk është thjeshtë për gjuhën, por edhe për shkenca të tjera shoqëror e deri te kanunet. Fundja është gjuhë me shenja, të cilat i studion Semiotika, shkenca e përgjithshme mbi

(Vijon në faqen 15)

Koha si kosto e lartë e reformave integruese

Nga: **HYSEN UKA**

Tejzgjatja e tranzicionit me ka nxitur men dimin për t'i pare në një kuadër më të gjërë, në relacione ndërvarësie e me thellë proceset e reformimit e te integrimit ekonomik të vendit tonë. Në përceprimin qytetar konceptet tranzicion, reformim, integrim etj, përkapen si terma zhvillimi dhe rritje ekonomike. Një qasje e tillë ndaj këtyre koncepteve është e pritëshme të jetë zhgënjyese për qytetarët tonë, pasi ritmet e zhvillimt tonë ekonomik ende nuk janë të tilla që të mendosh ndryshe. Për hirë të së vërtetrëtës duhet thënë se këto procese janë zhvarritur e rrekur më shumë se normalja, për të dalë në ritmet e duhura, duke u shtyrë me shumë mundim përpara, aq sa qytetarët ndjehen te lodhur dhe ju krijonë bezdi fjalët "reformë" e "tranzicione".

Po t'i shohësh në mënyrë diakronike rrjedhat e proceseve reformuese në vendin tonë, duken qart ritmet tepër të ngadalta të zhvillimit, thyrjet e shpeshta të procesit, rënie të pa pritura në hone e kurthe, të cilat na kanë marrë shumë kohe dhe na krijojnë ndjesin dëshpëruese, sikur jemi të dënuar të bëjmë punën e Sizifit.

A QE I MIRË FILLIMI YNË...

Kur themi ritme zhvillimi, kuptojmë njësi zhvillimim për njësi kohe. Po a ka në faktë njësi matëse, standarte për të bërë këto llogaratije. A është i matshëm zhvillimi, apo mund te flitet për të vetëm në përgjithësi, duke spekulluar me shifra e shprehje të tillë si: "...ngjitja e rritjes në zbritje...; ...zbritja e rritjes në ngjitje...", shprehje që rëndom përdoren për konsum mediatik, me qëllimin e vetëm për të drobitur mendjen e njerzëve, për të krijuar pështjellim, shpërqëndrim të vëmëndjes së qytetarëve, në mënyrë që ata ta pranojnë zhvillimin e tyre ashtu siç u vjen, siç u gatuhet nga nga politikëbërësit, pa patur lirinë e publikut të mirëinformuar, që të mendojnë vetë për çfarë ka ndodhur dhe pa patur mundësi të kërkojnë llogari dhe të orjentojnë drejtë vullnetin e tyre politikë. Tashmë edhe qytetarët tanë, kanë kuptuar se ka kritere e standarte të përpikta, për matjen e progresit e të efektivitetit të çdo qeverisjes apo nisme politike. Por e dhimbshme këtu mbetet se një pjesë e politikës sonë, *gjatë kohë* është përpjekur ta vonojë sa më shumë të mund ndërgjegjsimin e qytetarëve, e jo të bëjë atë që ka për detyrë: të jetë e hapurë, të informojë pa rreshtur qytetarët e saj, me synim ngritjen e vetëdijës së tyre për të matur realishtë veprimtarinë qeverisëse dhe për të përcaktuar objektiva real në rrugën e zhvillimit. Ende sot shohim sa pështjellim e mjergull krijohet, për t'ia bërë të pa kapshme apo për t'ia fshehur publikut "fakte jo të këdëshme", që përmbajnë raportet e monitoruese, të hartuar me qëllimin e mirë nga instrumentat e specializuara të monitorimit të BE.

Shohim me dëshprim se kemi shpenzuar shume kohë për fare pak hapa përparim e zhvillim, thuajse jemi zvarritur. Këtu mund të justifikohemi, gjë që është bërë e bëhet shpesh nga politikanët e "ananliste të programur", (*të cilët rreken që me çdo kusht të nxjerrin të "shëndetëshme" politikën e qeveritë tona, duke shkelur mbi të vërtetën, falsifikuar analizat e krijuar iluzion, por që manipulimi nuk shëron sëmundjen),* duke përdorur e keqpërdorur referencën, pikën e nisjes, gjendjen në të cilën ishte Shqipëria, kur nisi tranzicionit, procesin e reformave politike e të ristrukturimimit të ekonomisë, duke e shnëdrruar në ekonomi të lirë të tregut. Një fillim i mirë është gjysma e punës. Por, a qe i mirë fillimi ynë, nëse qe i keq, pse qe i tillë, cilët kanë qenë efektet, pasojat e tij në mentalitetin e qytetarëve dhe ritmet e zhvillimit? Nisja e rrugës së reformave në vendin tonë, ka qenë nga më të këqijat e mundëshme, e bërë në atë mënyrë që të do të kishte dëshiruar dashakeqësi më i madh i shqiptarëve.... U tymos aq shumë në mëndjet e njerëzve, të atyre të kishin punuar me besim e idealizëm, duke vënë jetën e tyre në thememlet e ndërtimit të Shqipërisë, duke thënë se asgjë nuk kemi bërë, agjë nuk vlenë, se jemi fundi i botës, se ky vend është i pa ndreqshëm, se shkolla dhe njohurit tona nuk vlejnë, se Shqipëria është e dënuar të mbetet e varfër....; se ne vetëm na duhet të mallkojmë të shkuarën tonë, pa zhvillimin do të na e sjellin nga jashtë etj, etj. Kur i gjykojmë sot gjakftohtë ato çfarë me aq patos premtoheheshin nëpër tribuna në vite 1991-1992, të bëjën të qeshësh, por të bëjnë të qashë kur mendon efektin, çoroditjen e plotë të të gjithë jetës së vendit, paralizimin e të gjithë elememnteve të fuqisë kombëtare deri në armiqësimin e qytetarëve me çdo gjë të ndërtuar prej tyre. Të gjitha këto ngjallën dëshprimin e njerzve duke krijuar energji negative dhe duke e futur vendin ne një valë shkatrrimesh materiale e morale, duke shkatrruar rendin e të gjitha vlerave. Dhe kjo na ndodhte ne shqiptarëve që qartësishtë i dhamë vullnet politik rrugës së ndryshimit në zgjedhjet e vitit 1992. Forcat e reja që morën drejtimin e vendit në rrugën e reformave demokratike, edhe pse kishin mbështetje popullore, nxituan të hapnin "zarfin e parë", atë në të cilin këshilloheshin të shajnë parreshtur, vend e pa vend, të shkuarën, rregjimin e më parshëm, si mjeti më i mirë taktik, për të të justifikuar paaftësitë e paudhësit e veta. Kështu, hynë me vetëdije apo ranë në kurthin e paradoksit të "nihilizmit të dyfisht", që përmend Vojtek Lamantovic, i cili duke analizuar shëndrrimet dhe reformat në vendet e Europës Lindore, shkruan në analizën e tij: *"Sa më e sukseshme të jetë elita në pushtet në nxitjen e qëndrimeve relativiste dhe/ose nihiliste përkundrejt normave dhe vlerave të trashëguara....aq më pak sukses do të ketë ajo, përgjithsisht, në futjen e normave dhe vlerave që ajo i sheh si progrsive dhe më të përshtatëshme. Nihilizmi kundër vlerave të hedhura poshtë, i cili duhet të përgatisë rrugën për në modernizim, kthehet në nihilizëm kundër normave, parimeve dhe vlerave të dëshiruara. Sa më rigorozisht të shkatrrohen rregullat e vjetra aq më të pa aftë bëhen njerëzit për të vendosur dhe për të zbatuar të reja....."fq 65.* Ende i kemi të gjalla pamjet kur lider politik, atëkohë të ardhur në pushtet, manipulonin e frymëzonin grupe të caktuar, të kontrolluara prej tyre, "të dizinfentonin tokën nga çdo gjë komuniste". Nënë këtë frymëzim u sulëm me sopata në krah duke shkatrruar, pemtoret e famshme e brezaret në të gjitha anët e Shqipërisë. Nën këtë frymëzim të keq, kam parë vetë se si brenda disa ditëve, në dimrin e vitit 1993, u shkatrrua në komunën Muhurr (kodra e Gjarajcës, Dibër), një bllokë, me 18 mijë rrënjë arre, (unikal në llojnë e vetë në Ballkan), nga i cili ishte marr vetem viti i parë i prodhimit. Po të njëjtin fatë patën disa muaj më vonë blloqet e mollëve, qershive, vishnjeve etj. Si pasojë dolën nga funksioni dhe mbetën nënë kthetrat e korrezionit disa fabrika me teknologji bashkohore, të RFGJ, venë në punë vetëm dy vite më parë. Kumbulla e tharë e sheqerosur dhe lëngu i frutave i prodhuar në këto fabrika, ishte në radhët e para të produkteve që pranote dhe preferonte komuniteti europian nga vendi ynë. Tashme njerzit janë të qartë për çfarë kanë pësuar nga ajo frymë e keqe, ndaj i janë rikthyer punës për të ngritur atë që humbën, dhe mund ta ngerë, por ajo që nuk kthehet më është "koha". Nuk do të kthehet më ai brez njerzish, që ishin aftësuar deri në prefeksion në trajtimin e të gjitha llojeve të pemtarisë.

(Vijon numrin e ardhshëm)

Portreti i një njeriu të mirë që jeton në SHBA



Abdurahim-Duli Ramku pranë pllakatës së ABC, përuruar gjatë festimeve për 100 vjetorin e Kongresit të Dibrës

Bisedë me dibranoamerikanin Abdurahim-Duli Ramku, veteranin e sportit

Si ja dola anembanë Liqenit të Dibrës

Në Florida shpëtoi djaloshin nga dallgët e oqeanit

Nga: **REXHEP TORTE**

Abdurahim-Duli Ramku, është një njëri nga mërgimtarët dibranë, i cili çdo vit rregullisht vjen nga SHBA-të, për ta vizituar vendlindjen e tij, Dibrën e dashur, familjarët, farefisin dhe shokët. Të gjithë ata që e njohin, e shohin dhe e takojnë Abdurahimin-Dulin, habiten në vitalitetin dhe trupin e tij të fuqishëm, thuajse që nuk ka ndryshuar fare me dekada.

Saherë që e pyesin për këtë recetë të tij lidhur me trupin e mirëmbajtur Abdurahimi-Duli u përgjigjet, "Trupin tim kështu vital e mban noti, gjimnastika dhe malli për vendlindjen".

Në këto muaj të nxehtë verorë kur temperaturat e larta arrijnë afër 40 gradë celsius, dibranët dhe mërgimtarët që kanë ardhur për t'i kaluar pushimet verore në vendlindje dhe në mesin e të afërmve të tyre, gjejnë freskinë në plazhin e Liqenit "Spila" të Dibrës së Madhe, duke bërë plazh dhe duke u zbavitur nëpër kafeteritë që janë ndërtuar gjatë këtij bregu të liqenit.

Në mesin e këtyre pushuesve dibranë takuam edhe mërgimtarin tanë, dibranoamerikanin Abdurahim-Duli Ramku, i cili çdo ditë bën plazh me shokët e tij.

Duli liqenit të Dibrës i ka dalur mbanë dy herë.Vite më pare në moshën 65 vjeçare ndërsa ishte duke u rrezitur buzë liqenit ai për një çast u çua në këmbë dhe u tha shokëve, "kam vendosur që këtij momenti të provoj t'i dal anembanë liqenit, ta provoj veten edhe një herë t'i dalë anëembanë liqenit., sepse herën e parë e kalova me lehtësi".

Të gjithë u habitën për këtë vendim të menjëhershëm e të papritur të Abdurahim-Duli Ramkut, sepse kjo distancë prej 4 kilometra e gjysëm në vajtje dhe kthim, edhe për notuesit profesionistë kërkon njëfarë parapërgatitje.

Disa nga të pranishmit i ofruan që ta ndjekin e shoqërojnë me ndonjë varkë, por kishte edhe prej tyre që e kështillonin të heqë dorë nga ky vendim i tij. Mirëpo disa nga shokët e gjeneratës së tij, të cilët e njihnin mendjen Dulit sportist që në moshën e re rinore, e dinin se ai kur e bën mendjen dysh nuk kthehet prapa.

Duli Ramku u fut në ujë dhe filloi notin drejt kodrave të fshatit Ballhanzë, ndërsa të tjerët i dëshiruan sukses. Ishte ora 15 kur i nisi metrat e para të notit. Pas një kohe të gjatë kur ai thuajse u nuk dallohej nga valët e liqenit, disa shokë u nisën me një gomone për ta parë se ku ka arritur. Gomonja e kishte takuar afër cakut të dëshiruar dhe pasi Duli e kishte arritur cakun dhe ishte nisur drejt plazhit. Personat e gomones e kishin pyetur këtë maratonist të notit se mos ka nevojë për diçka, e me që ai u kishte thanë, se çdo gjë shkon në rregull, u kthyen sërish në bregun e plazhit për ta pritur.

Dhe Duli Ramku në plazhin nga ku kishte nisur maratonën e tij të notit u kthye në ora 17 e 50 minuta, i gëzuar se e kreu me sukses edhe këtë not maratonik.

Të gjithë duartrokitën dhe e përgëzuan për këtë sukses në këtë moshë që ka.

Mërgimtarët dibranë nga SHBA flasin me mburrje edhe për heroizmin që Duli e tregoi në në qytetin Ford Raddel në Florida, i cili me guximin dhe shpirtmadhësinë e tij shpëtoi nga vdekja djaloshin Hall që po mbytej nga valët e oqeanit.

Për lexuesit e gazetës "Rruga e Arbërit" zhvilluam një bisedë spontane me Abdurahim-Duli Ramkun, këtë sportist të devotshëm.

Si e vendosët ta bëni maratonën e notit në liqenin e Dibrës dhe a patët ndonjë vështirësi?

"Maratonën e parë e bëra prej plazhit deri te kodrat e fshatit Ballhanzë dhe që këtu deri te restoranti "Taverna Cami". Atëherë më shoqëronte një gomone dhe këtë relacion e realizova me sukses.

Herën e dytë e vendosa duke dëshiruar ta provoj veten edhe njëherë sërish pata sukses, edhe pse para se të arrij cakun, filloi të fryjë era, e cila shtoi valët e liqenit dhe më krijoi pak vështirësi, por megjithatë e arrita qëllimin".

Kur e shpëtove amerikanin nga valët e oqeanit?

Si familje ne jetojmë e punojmë në Nju Jork, por në Ford Raddel të Floridës kemi apartamentin tonë dhe atje si pensionistë kalojmë nga disa muaj gjatë vitit, ndërsa fëmijët me familjet vijnë kur gjejnë mundësi.

Në shkurt të vitit 2007 si zakonisht kah ora 10 e paraditës kisha dalë të bëj not, me që apartamenti ynë është afër bregut të oqeanit. Në oqean bënin sufrim me rekuizitat e tyre edhe një vajzë 9 vjeçare më vëllain e saj shtatëvjeçar. Valët e oqeanit janë të shpeshta dhe vijnë nga katër dallga të njëpasnjëshme drejt bregut dhe sërish nga bregu për në brendësi shkaktohen nga katër dallgë të tjera. Kjo bëri që motër e vëlla, Marija dhe Hall të rrezikohen dhe të futen në brendësi të oqeanit. Marija arriti që t'i afrohet bregut dhe të shpëtojë, ndërsa Hall-in dallgët e morën me vete afër 200 metra dhe e kishte vështirë të kthehej. Unë e ndjeva rrezikun dhe u nisa ta ndihmoj. Arrita afër, i dola nga prapa dhe i thashë se kam ardhur të të ndihmoj dhe e këshillova që t'i ndjekë këshillat e mia. Duke e udhëzuar tu shmangemi dallgëve që vinin njëherë nga e majta dhe njëherë nga e djathta, arritëm që të dalim në breg një kilometër më poshtë nga vendi ku djaloshin e kapën dallgët.

Shpëtimi i djaloshit ishte gëzim i madh për prindërit, motrën e tij, por edhe për të pranishmit, të cilët më përgëzuan përzemërsisht për këtë gjest sakrifikues. Për këtë rast shkruajti edhe shtypi në këtë qytet, kam marrë mirënjohje, prindërit më dhuruan një orë dhe unazë ari dhe tani jam bërë mik i ngushtë i kësaj familje. Ndërtesa ku jetojmë ka 17 kate ka salla sporti, merkato dhe ambiente tjera. Te gjithë më nderojnë dhe respektojnë si shqiptar dhe për shpëtimin e këtij djalosh".

Si e keni fituar këtë përgatitje fizike shembullore?

> Të rinjve do tu rekomandoja që sa më shumë kohë të kalojnë në natyrë, në ajër të pastër dhe me sport... Liqeni i Dibrës ofron mundësi të mëdha për organizimin e aktiviteteve të ndryshme sportive në ujë, me not apo me varka, dhe kjo duhet të shfrytëzohet maksimalisht.

"Unë që në shkollën fillore në Dibër kam filluar të merrem me not dhe gjimnastikë. Në Dibër asokohe kishim palestrën dhe Shoqërinë sportive "Partizani", ku ushtronin rregullisht në të gjitha rekuizitet sportive që i kishte palestra.

Mua më pëlqente më shumë të ushtroj në unaza dhe paralelet, ku edhe arrita rezultate të shkëlqyera në garat që zhvillonim në Dibër, Ohër, Tetovë e Shkup, dhe gjithnjë isha ndër më të mirët, për çka edhe shpërbleheshim me ndonjë dhuratë simbolike dhe me mirënjohje, ndërsa çdo vit rregullisht në muajin maj, shkathtësitë tona si gjimnastikanë i demonstronim para publikut dibran, po në sallën tonë që shërbente edhe si sallë spektatorësh.

Kjo zgjati deri në vitin 1968, kur për arsye përndjekjesh dhe ekonomike si shumë shokë të mi, u detyrova ta lëshoj vendlindjen dhe familjarisht të emigroj në SHBA".

Ku i zhvilloni aktivitetet tuaja sportive në SHBA?

"Unë jetoj edhe në Nju Jork edhe në Floridë. Përveç aktiviteteve në "Shoqatën Atdhetare Dibrane", rregullisht merrem me sport. Gjatë stinës së dimrit nëpër palestrat dhe pishinat sportive ekzistuese atje, që disponojnë me rekuizitat e nevojshme, por edhe në shtëpinë time, ndërsa verës në natyrë, në lumenjt dhe në ujin e oqeanit .Ushtrimet e mia të përditshme nuk i bëj shkel e shko, por me një përkushtim disa orësh.

Në SHBA kemi edhe ekipet futbollistike "Korabi" dhe "Adriatiku", atje luajnë futboll edhe dy djemtë e mi, Shpëtimi dhe Gëzimi, të cilët gjithashtu e preferojnë sportin dhe në ekipet e tyre edhe si nxënës gjatë garave zenin vendet e para.

Cili do të ishte mesazhi i juaj për rininë dibrane?

"Të rinjtë dibranë në plan të parë duhet ta kenë sportin, që kalit trupin dhe shpirtin. Më vjen keq që palestra sportive e "Partizanit' ku ushtronim ne asokohe, tani është në gjendje shumë të vështirë, dhe për qytetin është më se i nevojshëm ndërtimi i një palestre sportive.

Megjithatë unë të rinjve dibranë do tu rekomandoja që sa më shumë kohë të kalojnë në natyrë, në ajër të pastër dhe me sport, se sa nëpër kafeteri apo duke shëtitur kot rrugëve. Liqeni i Dibrës ofron mundësi të mëdha për organizimin e aktiviteteve të ndryshme sportive në ujë, me not apo me varka, dhe kjo duhet të shfrytëzohet maksimalisht. Në këtë liqen ka kushte ideale edhe për organizimin dhe mbajtjen e shumë garave sportive nga më të ndryshmet.

Pajtohuni në gazetën "Rruga e Arbërit"

www.dibra.org

BËHUNI PJESË E GAZETËS!

Pajtimi në gazetë kushton 600 lekë në vit
*dhe gazeta ju vjen me postë në shtëpinë tuaj**

Gazeta "Rruga e Arbërit" është e hapur për të pritur letrat e lexuesve për problemet dhe shqetësimet e tyre.
Redaksia mbetet e hapur për çdo lloj bashkëpunimi, me synimin e vetëm: përhapjen e së vërtetës dhe mendimit progresist.
Redaksia kujton bashkëpunëtorët se dorëshkrimet janë të pakthyeshme dhe jo çdo shkrim mund të botohet.

Tel. (04) 22 33 283. E-mail: rrugaearberit@gmail.com.
Numri i radhës së gazetës do të dalë çdo të diel të fundit të muajit.
* Për ata që duan që gazeta t'ju shkojë me postë në shtëpi, ju lutem konfirmoni në redaksi adresën e saktë

homazh

U nda nga jeta artisti, Xhelal Çerpja



Në foto: Xhelal Çerpja, i pari majtas, duke marrë medaljen e Mirënjohjes gjatë një veprimtarie folklorike në Burrel vitin e kaluar

Këto ditë u nda nga jeta artisti dhe drejtuesi i Ansamblit "Kuvendi, Zall-Dardhë për disa vite, Xhelal Çerpja. Xhelali ka lindur në vitin 1943 në Zall-Dardhë të Dibrës. Që në rini ishte i dhënë pas këngës, të cilën e ushtroi vazhdimisht, deri sa në vitin 1951 doli para publikut me daulle në fshatin e tij të lindjes. Më pas përdori çiftelinë, pasi kjo vegël muzikore ishte instrument familjar i Çerpajve. Në vitin 1970 mbaron një kurs për regjizurë dhe në vitin 1977 ka kryer një kurs tjetër për koreografi. Është kualifiukuar disa herë në seminare kombëtare, duke u aftësuar në drejtimin e grupeve artistike të vendlindjes dhe për disa muaj edhe në Shtëpinë Qendrore të Ushtrisë. Vendlindja e tij, Zallë-Dardha, traditat folklorike të saj e bënë edhe më kërkues në terren dhe në Shtëpinë e Kulturës të dallohet për vlera artistike dhe drejtuese. Në vitin 1969 e deri tani vazhdon të drejtojë me sukses grupin e Zallë-Dardhës, duke dhënë kontribut në këngën e vallen popullore. Grupi i Zallë-Dardhës dhe vetë Xhelali është dekoruar me urdhëra e diploma të ndryshme. Të dy mbajnë urdhërin "Naim Frashëri" të klasit parë.

Xhelal Cerpja ka dhënë kontributin e tij në mbledhjen e materialeve folklorike burimore të zonës, në interpretimin me art të këngëve dhe valleve, si dhe derjtimin me sukses të veprimtarive artistike në Zallë-Dadhë. Vlera e tij është se diti të punojë me moshat e reja për t'i përcjellë vlerat folklorike deri në ditët e sotme.

Duke qenë prej një visi me tradita e të hershme dhe vlera të pasura trashëgimore, ai nuk u kufizua vetëm te kënga e vallja, por edhe në gjurmimin e vlerave gojore e letrare, si në mbledhjen e tregimeve popullore, të fabulave, përrallave etj.

Xhelali nuk ishte vetëm. Në Zallë-Dardhë kanë dalë figura të spikatura të interpretimit të vlerave folklorike. Të kësaj treve janë Lirie Rasha e Haziz Ndreu, Sajhe Poleshi e etj. Ka bashkëpunuar me sukses me të afërm e bashkëmoshatarë, me më të rinj e më të moshuar.

Grupi i Zallë-Dardhës mori pjesë në Festivalin e Këngës Burimore Lirike që u zhvillua në Burrel, ku Xhelal Çerpja u nderua nga Qendra Kombëtare e Veprimtarive Folklorike me "Mirënjohje" me motivacionin "Për kontribut të madh në Folklorin e Zallë-Dardhës". Motivacioni në Festivalin e Këngës Burimore Lirike në Burrel ndikoi në mobilizimin e Xhelal Çerpes edhe në organizimin e festimit të 60-Vjetorit të Ansamblit të Zall-Dardhës, ku kontributi i tij ishte i madh. Në ketë aktivitet që u zhvillua më 12 Maj 2009, Xhelali ishte në krye të punëve, duke nderuar jo vetëm artistët e kësaj treve, por edhe gjithë pjesëmarrësit.

Ndarja para kohe nga jeta e Xhelal Çerpes është një humbje jo vetëm për familjen e tij, por edhe për artistët e Zall-Dardhës, me të cilët ndërtoi jetën artistike të kësaj treve. Nga ana tjetër, Xhelal Çerpja ka lënë gjurmë për t'u kujtuar gjatë nga kolegët e gjithë ata që e kanë njohur e dëgjuar emrin e tij. / ***G.Bara***

Zbulime të reja në Kalanë e Grazhdanit

(Vijon nga faqja 9)

e hershme shqiptare, të njohur me emrin kultura e Komanit, datojnë në shek. XI-XII pas Kr. Dëshmi arkeologjike të kulturës së Komanit janë zbuluar në të gjithë territorin shqipfolës të Ballkanit perëndimor, duke filluar nga Korfuzi në jug deri në Vuçiternë në veri. Varre me objekte të kulturës së Komanit janë zbuluar në varrezën e kalasë së Dalmaces (Koman), në Lezhë, në Krujë, në Durrës (kalaja e Turrës), në Tiranë (Tujan), në rrethinat e Elbasanit, në Pogradec, në Korçë (Symyzë), në Kolonjë (Rehovë), në Përmet (Piskovë, Rapckë), në Vlorë (Dukat), në Mat (Laç-Bruç, Shkopet, Petralbë, Klos, Arbër, Derjan, Urzallë, Rremull, Dukagjin), në Mirditë (Bukël, Prosek), në Dibër (Peshkopi, Grazhdan, Trenë, Blliçe, Çidhën e Poshtme), në Kukës (Çinamak, Domaj, Golaj), në Rrafshin e Dukagjinit (Prizren-Vërnicë) në Fushën e Kosovës, Badovac (Graçanicë), Çeçan (Vuçitern), Matiçan (Prishtinë), në Mal të Zi (Mijele pranë Vir Pazarit), në FYROM (Shën Erazëm- Ohër), Radolisht-Strugë), në Korfuz (Afionë) etj. Për këtë datim mbështetemi jo vetëm në parimin e përgjithshëm logjik, sipas të cilit varreza është kronologjikisht më e vonë se pjesa e vendbanimit mbi të cilën ngrihet, por dhe në disa objekte metalike, kryesisht unaza me fushë të zbukuruar me gërricje dhe byzylykë bronzi me skaje të zbukuruara në trajtë koke gjarpëri të stilizuar, të zbuluara pranë hyrjes lindore të kalasë së Grazhdanit, nga dëmtimi i shtresës së parë të varreve nga zgjerimi i rrugës nacionale. Objekte të tilla, të njohura si prodhime të punishteve të bizhuterisë bizantine të shek. XI-XII[25], kanë ardhur në Dibër nëpërmjet tregëtisë direkte me Bizantin ose me punishtet e tij provinciale. Gjetja kronologjikisht më e vonë i referohet një monedhe bronzi të perandorit Androniku III Paleolog (1330-1337), që shërben edhe si një ***terminus post quem*** i jetës së këtij vendbanimi. Kthimi në varrezë i një pjese të vendbanimit dhe vendosja e saj brenda murit lindor të kalasë, do të thotë se në këtë periudhë, vendbanimi është zvogëluar në mënyrë të ndjeshme dhe se muri rrethues e kishte humbur funksionin e tij mbrojtës.

Kërkimet arkeologjike që po zhvillohen në këtë kala, shpresojmë se do të sjellin të dhëna të reja, dhe do të ndriçojnë më tej aspekte të ndryshme të jetës së këtij monumenti të rëndësishëm të brendësisë kontinentale të Shqipërisë lindore për ta kthyer atë në një qendër tërheqëse të turizmit arkeologjik në këtë rajon. Një impakt mjaft pozitiv për këtë do të sjellë edhe ndërtimi i ***Rrugës së Arbërit,*** që e afron Grazhdanin dhe Dibrën një orë larg kryqytetit dhe u kthen atyre cilësorin e merituar si lagje periferike të Tiranës.

Email: **bunguria@yahoo.com**

[1] J.G. Hahn, *Reise durch Drin und Wardar Gebiechte*, Wiena 1867, f. 163-165 .

[2] *I.S. Jastrebov*, Staraja Srbija i Albania, *Spomenik SK XLI, Beograd 1904, f. 135-136.*

[3] *H. Stërmilli*, *Dibra në prak të historisë*, Tiranë 1940, f. 8 *(ruhet në Muzeun Historik të Peshkopisë. Më tej : MHP).*

[4] *H. Ceka – J. Adami*, Raport mbi ekspeditën në Peshkopi, Mat e rrethe, *Tiranë, 6.12. 1950, Arkivi i Isntitutit Arkeologjik Tiranë (më tej: AIA).*

[5] A. Baçe, *Fortifikimet e antikitetit të vonë në vendin tonë*, Monumentet 1976, 11, f.49, tab. III.

[6] *Punimet u kryen nga ATL-ja e Peshkopisë. U punua me nga 6-10 punëtorë në vit. Autori i punimeve pastruese të pambaruara nga Instituti i Monumentëve ka qenë A. Baçe. Ato janë ndjekur në terren nga autori i këtij punimi.*

[7] Gërmimet u drejtuan nga L. Përzhita dhe G. Hoxha.

[8] *H. Sadiku*, Përpjekje për lokalizimin e disa kështjellave dhe qyteteve peneste, *Ilirët dhe gjeneza e shqiptarëve, Tiranë 1969, f. 255.*

[9] *K. Frashëri,* Në gjurmë të qyteteve peneste, Studime Historike 1975, 4, f.144; *I. Kaca*, Kontribut për lokalizimin e disa qyteteve peneste sipas të dhënave burimore e arkeologjike, *"Dibra dhe Dibranët" Peshkopi 1981, f.74-77.*

[10] *K. Frashëri*, Në gjurmë… f. 151; *A. Baçe*, Fortifikimet… f.49-50*; Po ai,* Doberi një qytet i vjetër, Ylli, 1982, 3 f. 15*; I. Kaca*, Herbeli venbanim ilir, *Ylli , 1983, 7 f. 31.*

[11] Është fjala për gjetjen në truallin e këtij qyteti në vitin 1953 të bustit të një nëpunësi romak, si një element i qendrave urbane, sot të ekspozuar në Muzeun Popullor të Ohrit, Shih: V. Bitrakova – Grozdonova në: "*Prilog kod antičkata Istorja na Debarskijot kraj*, Spisanje na Sojuzot na druzvata na istoriçarite na Republika Makedonija, Scopje 1966, f. 200; V. Sokolovska, *"Antičkata Skulptura vo SR Makedonija*", Skopje 1987, f. 126-127, tab. 23 (1-3).

[12] Për këtë mendim mbështetemi në përbërjen e njëjtë gëlqerore të tyre me gëlqeroret e gurores së Banishtit, 3 km në veri të qytetit të Dibrës.

[13] *A. Baçe, Fortifikimet …* f. 49. tab. III.

[14] Y. Cerova, *Castrum Skampis*, Iliria 1997, 1-2, f. 289 dhe shënimi nr. 23-24 i kësaj faqeje ; S. Anamali, *Kështjella e Pogradecit,* Iliria IX-X, 1979-1980, f. 222; H. Spahiu, *Gërmimet arkeologjike të vitit 1973 në kalanë e Beratit,* Iliria III, 1974, f. 483-487, A. Baçe, *Kalaja e Durrësit dhe fortifikimet përreth në antikitetin e vonë*, Monumentet 9, 1975, f. 91-103; L. Përzhita, *Kështjella e Bushatit*, Iliria 1986, 2, f. 191; G. Hoxha, *Muri rrethues e periudhës së vonë antike në qytetin e Shkodrës,* Iliria 1994, 1-2, f. 233.

[15] T. Ivanov, *Abritus,* Sofie 1980, f. 242.

[16] Gj. Karaiskaj, *Disa të dhëna…* f.169; Y. Cerova, *Castrum Skampis*, Iliria 1997, 1-2, f. 295 dhe citimi nr. 56 i kësaj faqeje.

[17] D. Komata, *Të dhëna arkeologjike për qytetin arbëror (shek. VII-XI),* Iliria, 1983, 1, f. 210.

[18] Gj. Karaiskaj, *5000 vjet fortikime...* f. 113.

[19] A. Baçe, *Dobëri...* f. 18.

[20] S. Anamali, *Proçese shndërrimi në trevën jugore ilire në shek. IV e.j.*, Iliria 1986, 1, f.22-23.

[21] Proc. Caes. *De Bella gottica*, VII, 29, VIII, 25.

[22] Proc. Caes. *De Aedificis,* IV, 25. V. Popoviç, *L'Albanie pendant la basse Antique,* " Les Illyriens et les Albanais ", Beograd 1988, f. 255; L. Përzhita, *Të dhëna të reja për fortifikime të shek. IV – VI në luginën e Drinit të Zi*, Candavia, 1, 2004, f. 60.

[23] Hieroclis *Synecdemus*, 639, 4.

[24] *I. S. Jastrebov,* Staraja Srbija i Albania, *Spomenik SK XLI, Beograd 1904, f. 135-136.*

[25] *P. Gatev*, Nakiti ot progrebinja ot XI-XII vek, *Archaeologia, 1977, 1, f. 42, tab. II, 4.*

Studim me vlera për gjuhën e tregimeve alegorike

(Vijon nga faqja 13)

shenjat, dmth në aspektin pragmatik të gjuhës. Teoria e Çarl Morisit për shenjat ndoshta do të vlente për ta parë "meselen" edhe në drejtimin pragmatik, në kuptimin jo vend e pa vend, por sipas nevojës. Dy personazhet e dhëna në shembullin më sipër, po t'i biem në kohën tonë, s'kishin nevojë të përdornin shkollën e natës për burg e të ditës për kulakllëk.

Shembëlltyra nuk jepet vetëm me gjuhë, por edhe me një veprim konktet me synim shënjimin. Për ta ilustruar ketë mendim, po jap një zgjidhje "pleqsh":

"Njani i kishte kërkue kalin komshisë për një punë. Ndodhi që kali ngordhi në dorën e nevojarit. I zoti i kalit kërkoi që kalin t'ia paguante ai që ia mori për një punë. Shkuan në pleqni. Secila palë mori "plakun" e vet. Dy "pleqtë" hynë brenda në shpinë e të zotit të kalit dhe po pinin kafen. "Plaku" i atij që mori kalin e i ngordhi në dorë, lëshoi filxhanin e kafes në tokë (në dukje padashje, por ishte krejt e qëllimshme) dhe filxhani u thye. Nxori shpejt e shpejt lekët nga xhepi për të pague filxhanin, po i zoti i shpisë i u betua se nuk ia merrte. "Plaku" i dytë (ai që e kishte marrë i zoti i kalit për të gjykuar se kali duhej paguar), thotë: "Me leje, burra!. Jo, thotë i zoti i kalit, se s'u morëm vesh. Pse nuk ia more paret e kafes?! Kjo punë u mor vesh". Shembëlltyra ishte e qartë. Kali-filxhani; ngordhja-thymja, pastaj zgjidhja.

PIKAT E FORTA TË ARGUMENTIT

A duhet gjykuar për përdorimin e shembëlltyrave ose më saktë a duhen përdorur alegoritë? Fundja çdo studim që bëhet, ka një synim. Dhe autori e ka dhënë mesazhin në ketë studim. Nuk është fjala thjeshtë për studimet, por për përdorimin e alegorisë në ligjërimin e përditshëm. Duhet thënë se gjithë studiuesit e kanë quajtur gjuhë të fshehtë, me emërtimin "mesele", të folur *me "shifër" apo "rrotulla", llaf nën mutaf etj. Gjithashtu ata kanë konstatuar se kjo* mënyrë të komunikuari është i ndërvarur nga rrethana të caktuara. Nga ana tjetër duhet thënë se ky punim trajton shumë çështje, duke i analizuar e duke dhënë shumë argumente që në studimet shqiptare nuk janë trajtuar me ketë thellësi më parë.

Alegoria ose shembëltyra ka pikat e saj të forta, të cilat janë dhënë në monografi dhe ndoshta vlen vetëm ndonjë përforcim Ajo vjen nga hershmëria dhe si nevojë komunikimi në rrethana të caktuara historike e shoqërore. Gjithashtu rrethanat kanë përcaktuar që brenda një nëndialekti (jo vetëm në Dibër, por edhe në vise tjera) të kemi edhe sot këto visare. Në pamje gjuhësore ato janë si shprehje të bilinguizmit dialektor, me vlera të shumta për pasurinë e fjalëve të rralla shqipe, sintaksën popullore, begatinë artistike etj. Nga ana tjetër, autori e ka parë si një dukuri e etnicitetit i pastër shqiptar, si shprehje etnolinguistike, me shtrirje gjeografike të ndryshme në trevat shqiptare. Aty jeton në simbiozë kultura shpirtërore dhe materiale, të lidhura natyrshëm midis tyre. Këto e të tjera vlera janë pika të forta të shembëlltyrës, të folurit me shifër.

A KA PIKA TË DOBËTA PËRDORIMI I MESELEVE?

Mendoj se këtu ka vend për diskutim. Nëpër studimin e Hajri Mandrit është folur për rrethanat e përdorimit të komunikimit me shifër. Ky komunikim ka faktorët e brendshëm si dhe mjedisin e saj, që mund t'i marrim si faktorë të jashtëm. Faktorët e brendshëm, zakonisht ose të paktën pjesërisht, janë në kontrollin e drejtpërdrejtë të aktorëve kryesorë. Po mjedisi, si reagon? Duhet parë më thellë, sidomos në rrethanat e sotme. Në vise shqiptare ka edhe një aforizëm: Miku është si shishja e llamës".

Anëtarët e një komuniteti e njohin njëri tjetrin dhe gjuha "me bente" nuk merr vlera mesazhi për ta. Me një fjalë, me të afërmit nuk flitet me shifër. Faktorët e jashtëm zakonisht nuk janë nën kontrollin e drejtpërdrejtë të aktorëve kryesorë. Kur vjen një mik nga visi tjetër, që nuk e njeh ketë lloj komunikimi, zakonisht dibranët e provojnë njëherë "muhabetin hollë" dhe, kur shohin se nuk e njeh ketë shenjë, ketë lloj muhabet, heshtin. Ky veprim ka qenë në karakterin jo vetëm të një komuniteti, por edhe në vise që e përdorin ligjërimin me "shifër". Nga ana tjetër, gjuha alegorike ndonjëherë kthehet në bumerang, kur ngacmimi është ofendues. "Shkuan dy vetë te miku në Dibër. Ishin lodhë nga rruga e njëri gjatë kohës së muhabetit, u ul në krah. Njani, nga të fisit të zotit të shpisë, i thotë shoqit: "A lërove nopak sot? Tjetri i përgjigjet: Pak, se kau i zi u ul në hulli disa herë..." Miku i lodhun nuk e mori vesh e as lëvizi nga vendi. Tjetri (prej miqve), e kuptoi se "kau i zi ishte shoku i vet dhe përgjigjet: "Te ardhë udhës pashë do gra te shi groshë. U binin në hu groshëve, po thojniu të kenë kujdes se kokat e groshëve u kcejshin kah ftyra e do i çorrojnë sytë! E, pa sy s'ua merr kush se ishin ene të reja". Njani nga të fisit, thotë: Nuk e patëm me gra, o mik, po ti s'qanke miku". U prish muhabeti e miqtë u ngritën e dolën natën nga shtëpia. Përdorimi vend e pavend ose me synim ofesën, synimi për të goditur të paaftin, duhet të jetë një nga pikat e dobëta të meseleve. Pikat e forta, dobësitë, shanset dhe rreziqet duhen parë edhe në përdorimin e gjuhës, se: "gjuha kockë s'asht e kocka thyen". Ose, në farë mënyre mund të themi se alegoria është edhe: Hidh gurin e fsheh dorën". Analiza në ketë drejtim do ta identifikonte më qartë fenomenin "shembëlltyrë" në shqyrtimin e skenarëve të mundshëm në përdorimin aktual. Skenari për të dhënë vetëm "bardhësinë", sikur ngushton mundësitë.

Por vlera mbetet vlerë. Të gjithë ata që kanë kontribuar në mbledhjen e botimin e alegorive duhen përgëzuar. Libri i Hajri Mandrit i kapërcen kufijtë e një vëzhguesi, vlerën e të cilit e ka përcaktuar më së miri Prof. Shaban Sinani: "Autori ka zgjedhur procedimin më të dobishëm për lexuesin, me qëllim që ky libër t'i shërbejë atij (lexuesit), si një udhërrëfyes për të hyrë me lehtësi në botën e ligjërimit me shembëlltyra".

Rruga Arbërit nr. 40
botime

Shkrimtari **Viron Kona** boton librin e ri për fëmijë me aventurat e personazhit të dashur të fëmijëve, Bubulinos... Bashkë me të edhe aventurat e Dardit, Këmbëgjatit, Mjekërverdhit, të cilat ndërthuren me personazhet e rinj, me sfond Matin dhe Bulqizën.... **Një libër që nuk duhet humbur...**

"Bubulinoja në Rrugën e Arbërit"

GURËT E SKËNDERBEUT

-Po "Gurët e Skënderbeut" ku gjenden dhe pse quhen të tillë? - pyeti përsëri Këmbëgjati, duke e shfaqur hapur zemërimin, ngaqë dështoi propozimi i tij për t`i ndryshuar emrin "Qafës së Buallit".

-Nëse më lejon, këtë po e shpjegoj unë, - tha Dardi.

Fëmijët bulqizakë duartrokitën. - Në Bulqizë, - nisi Dardi,- ushtria osmane po vinte nga Dibra. Skënderbeu e priti këtu në fushën e Davollit, në Vajkal. Kur ushtria osmane po pushonte rrëzë malit, atëherë Skënderbeu me luftëtarët e tij që kishin zënë pritë, nisën të rrëzojnë gurë e shkëmbinj nga mali duke e shkatërruar një pjesë të saj. Këta shkëmbinj janë edhe sot dhe populli u thotë "Gurët e Skënderbeut".

-Po ky qyteti i Valikardhës dhe kulla e Skënderbeut? - vazhdoi të pyes Këmbëgjati dhe, duke dashur që "me një gur të vrasë dy zogj", iu kthye Bubulinos: - Mund të ma japësh ti këtë përgjigje vogëlush? Se, të gjithë fëmijët këtu po të brohorasin dhe po të duartrokasin, prandaj le të shohim sesa i meriton këto duartrokitje.

U vendos një heshtje e shkurtër.

-Ne mendojmë se, Bubulinoja, edhe pa i ditur këto hollësi, është një fëmijë me të cilin ne moshatarët e tij krenohemi, - tha Lura, kryeministrja e shkollës dhe, ndërkohë, vogëlushja i hodhi një vështrim buzagaz Bubulinos.

-Të falënderoj për respektin, - iu përgjigj Bubulinoja Lurës dhe shtoi: - Me qenë se zoti Shkencëtar Këmbëgjatë, do që të më vërë në provë, unë e falënderoj dhe dëshiroj t'i përgjigjem interesimit të tij për qytezën e Valikardhës dhe kullën e Skënderbeut. Veçse, po të gaboj diku, do të isha i lumtur në se do të më ndihmoni.

-Lëri fjalët e tepërta dhe më jep përgjigje për pyetjen që të bëra, - ndërhyri Këmbëgjati.

-Po, zoti Këmbëgjatë, po ju përgjigjem, - iu kthye Bubulinoja me buzagazin e tij të njohur nga fëmijët dhe vijoi:

-Kur qyteza e Valikardhës dhe kulla e Skënderbeut, ishte rrethuar nga ushtria osmane, Skënderbeu dha urdhër që të ushqehej mirë një mushkë me grurë, të cilën e hodhën nga shkëmbi i kullës. Kur mushka ra poshtë në lumë, turqit morën vesh se Skënderbeu paskej aq shumë grurë, sa që mund të ushqente jo vetëm ushtarët mbrojtës të kalasë, por edhe mushkat. Dhe, nga ky shkak ata e ngritën rrethimin e Valikardhës, duke menduar se nuk do të arrinin ta pushtonin dot me anë të urisë.

Nga të gjitha anët u duartrokitje të zgjatura.

LUGINA E FAMSHME

-Kemi dëgjuar, - tha Bubulinoja, se gjatë hapjes së Rrugës së Arbrit, këtu janë zbuluar disa objekte arkeologjike, që janë vlerësuar nga arkeologët si shumë të rëndësishme.

Shkrimtari për fëmijë Viron Kona, boton aventurat e Bubulinos dhe miqve të tij gjatë udhëtimit në Mat dhe Bulqizë. Historia e këtyre trevave, e kaluara dhe e sotmja përshkruhen plot fantazi dhe humor në vëllimin e ri të aventurave të Bubulinos, Dardit, Mjekërverdhit, Këmbëgjatit...

-Po, - u përgjigj Lura, - gjatë gërmimeve të rrugës, në fshatin Sofraçan, u gjendën dy përkrenare bronzi ilire.

-Këto përkrenare, - vijoi Arbri, - i mbanin ushtarakët madhorë, gjë që tregon për organizimin e lartë të ushtrisë ilire me gjeneralë, oficerë, kalorës dhe këmbësorë, të gjithë të armatosur me armët më moderne të asaj kohe. [1)]

-Në hapësirën ilire ka pasur punishte për prodhimin e përkrenareve. - u hodh e tha Taulanti, një vogëlush trupvogël, me sytë që i ndrisnin nga kënaqësia që ndiente se ndodhej mes Bubulinos, Dardit dhe miqve të tyre.

-E çfarë rëndësie kanë këto që thoni ju? - ndërhyri Mjekërverdhi dhe nisi të lëmojë e të krehë për merak mjekrën e tij. Ai, edhe ndërhyrjen e bëri që fëmijët bulqizakë të përqendronin vëmendjen te mjekra e tij e rrallë dhe e ndritshme, e cila deri në ato çaste as që ishte përmendur.


-Kanë rëndësi, - u përgjigj Enea, - sepse dëshmojnë kulturën e lartë ilire, por plotësojnë edhe njohuritë tona për armët mbrojtëse që përdornin ilirët.

-Unë e dëshiroj shumë të kem një përkrenare, - tha Këmbëgjati duke iu drejtuar Arbrit dhe shtoi: -Shpresoj se ti, Arbër, si president i nxënësve të shkollës, dhe Lura, si kryeministre, do të nxirrni një vendim special dhe të veçantë të Qeverisë tuaj që, unë, të pajisem me një përkrenare të tipit ilir, mundësisht një nga këto të zbuluara në Sofraçan.

Fëmijët bënë buzën në gaz.

-Më vjen keq, zoti Këmbëgjatë, - tha Arbri, - por përkrenaret janë pasuri kombëtare dhe ato ruhen në muzeun arkeologjik të Tiranës. Po të doni t'i shikoni, mund të shkoni atje menjëherë pas kthimit nga Korabi.

-Unë, - tha Dardi, - kam lexuar një shkrim në gazetën "Rruga e Arbrit" se një banor i zonës dorëzoi në Institutin e Monumenteve, përkrenaren ilire që ai e kishte gjetur gjatë punimeve të rrugës. U fol shumë për këtë në televizion e gazeta.



-Me zbulimet që janë bërë dhe po bëhen gjatë gërmimeve për ndërtimin e Rrugës së Arbrit, unë mendoj se këtu në Bulqizë duhet të vijë një ekip kërkimor arkeologjik, - tha Bubulinoja dhe vijoi: -Toka e vendit tonë është e pasur dhe këtu, me siguri, gjatë gërmimeve arkeologjike kanë për t'u nxjerrë nga dheu edhe shumë objekte të tjera të kulturës ilire dhe arbërore.

Fjalët e Bubulinos u pasuan nga duartrokitje të gjata.

Anëtarët e ekspeditës mësuan se me Rrugën e re të Arbrit, qyteti i Bulqizës do të ishte vetëm 50 km larg Tiranës, se Rruga e Arbrit përshkonte Luginën e bukur të Vajkalit, luginën e disa betejave të Skënderbeut, atë të Torviollit**,** dy betejat e Vajkalit**.** etj.

Humor dhe të qeshura shkaktoi tek të gjithë fëmijët tregimi i Eneas për një grua të një prej fshatrave të Bulqizës, e cila arriti të vriste komandantin e ushtrisë osmane, duke e goditur në kokë me një kungull të madh.

Pastaj biseda shkoi natyrshëm te vendbanimet e hershme ilire të Zerqanit, Fushë - Bulqizës, Gjoricës, Okshtunit, Ostrenit... dhe legjendat rreth tyre, te Golloborda dhe mjeshtrit e saj mjaft të njohur të ndërtimit brenda dhe jashtë vendit, te liqenet e mrekullueshëm malorë...

*
* *

Pushimi i rrebesheve të shiut u shoqërua me duartrokitje. Anëtarët e ekspeditës dhe fëmijët mikpritës u shpërndanë për disa minuta nëpër qytet grupe – grupe. Një pjesë u tregonin miqve relievin e thyer të maleve në dy anët e luginës. Bubulinoja, Dardi dhe të tjerët shihnin të entuziazmuar peizazhin përreth dhe, duke u shkëputur për disa çaste, nisën të ngjiteshin në vende disi të lartë dhe zunë të fotografonin pareshtur pamjet e rralla e befasuese që i rrethonin. Më pas, duke treguar puset e minierës, Enea, tha se vendburimi i mineralit të çmuar të kromit u diktua nga një gërmues popullor më 1940. Miniera u krijua në vitin 1948 kur filloi nxjerrja e kromit,[1)] - tha gjithë kompetencë vogëlushi.

Arbri shpjegoi se dikur zona e Bulqizës kishte qenë mjaft e ftohtë dhe në male binte shumë borë. Madje, pak më shumë se gjysmë shekulli përpara, në vitet kur u hap miniera e Bulqizës, inxhinierët dhe specialistët e huaj që vinin për minierën, mbanin me vete edhe pajisje të rrëshqitjes në akull, sepse uji i gjolit (kënetës) përpara qytetit të Bulqizës ngrinte dhe shndërrohej në një pistë të madhe natyrale patinazhi. [1)]

-Po të rrini pakëz më gjatë, këtu do të dëgjoni plot legjenda, fjalë të urta, tregime popullore të rralla dhe të mrekullueshme, - tha Enea. - Ju, - vijoi ai, - do të mund të vizitonit liqenet akullnajorë të malit të Lopës, por, në veri të Zallit të Bulqizës ju do të mrekulloheshin me malin e Homeshit, që është i mbuluar me pyje ahu, me malin e Balgjajt (mbi 2100 m) i pasur me liqene të mrekullueshëm akullnajorë...

-Shpresojmë që përpara se të largoheni, të ndiqni edhe programin artistik të grupit tonë. - Ne do të jemi të gëzuar, nëse e gjeni kohën për këtë, - tha Rajmondi.

-Kemi agjendë të ngjeshur, nuk kemi kohë, - ia bëri Këmbëgjati, duke dashur të tregojë edhe një herë rëndësinë e madhe që kishte ai në drejtimin e ekspeditës.

-Sigurisht që do të qëndrojmë, - tha kapiten Liku, me të drejtën e kryetarit.

Pak çaste më vonë, të gjithë po ndiqnin programin artistik me të cilin fëmijët bulqizakë do të konkurronin në festivalin e Fushë - Arrësit. Këngët ishin të mrekullueshme. Ato flisnin për jetën e fëmijëve, për lashtësinë e asaj treve, për bukurinë e vendit dhe bujarinë e mikpritjen e banorëve, në këngë shprehej besimi në një të ardhme më të bukur.

Koncerti u duartrokit fort dhe në sallë dëgjoheshin fjalë përshëndetëse: Bravo! Ju lumtë! Na kënaqët! Ishte një koncert i mrekullueshëm! Kostumet e këngëtarëve, valltarëve e recituesve rrezatonin dhe shkëlqenin nga bukuria dhe llojshmëria e ngjyrave...

(Marrë nga libri "Një udhëtim i çuditshëm" i shkrimtarit Viron Kona)

